



MONITORIMI I REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

SHQIPËRI

2019/2020

MONITORIMI I REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

SHQIPËRI

2019/2020

TIRANË, 2021

Botimi:

MONITORIMI I REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE PËR SHQIPËRINË
2019/2020

Botuar nga:

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Autori:

Alban Dafa

Ekipi kërkimor:

Iliada Korçari

Diori Angjeli

Ina Majko

Përkthimi nga anglishtja:

Ergys Bezhani

Grafika nga:

Eduart Cani

TABELA E PËRMBAJTJES

MIRËNJOHJE	7
RRETH WeBER2.0	8
PËRMBLEDHJE	10
LISTA	15
E SHKURTIMEVE	15
I. HYRJE	17
I.1 REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE INTEGRIMI I BALLKANIT PERËNDIMOR NË BE - PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM MONITORIMI?	18
I.2 QASJA METODOLOGJIKE E MONITORIMIT	19
I.3 STRUKTURA E RAPORTIT	24
II. KORNIZA STRATEGJIKE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE	25
II.1 TREGUESIT WEBER TË PËRDORUR PËR KUADRI STRATEGJIK TË REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE VLERAT PËR SHQIPËRINË	26
II.2 GJENDJA E KUADRI STRATEGJIK TË RAP (KSRAP)	26
II.3 ÇFARË MONITORON WEBER-I DHE SI?	28
II.4 REZULTATET E MONITORIMIT TË WEBER	29
II.5 PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE: KUADRI STRATEGJIK I RAP	33
II.8 REKOMANDIMET PËR KORNIZËN STRATEGJIKE TË RAP	34
GJURMIMI I REKOMANDIMEVE NGA MONITORIMI I RAP 2017/2108	34
III. ZHVILLIMI	
DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE	35
III.1 TREGUESIT WEBER TË PËRDORUR PËR ZHVILLIMIN DHE KOORDINIMIN E POLITIKAVE DHE VLERAT PËR SHQIPËRINË	36
III.2 ÇFARË MONITORON WEBER DHE SI?	37
III.3 REZULTATET E MONITORIMIT TË WEBER-IT	39
III.4 PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE: ZHVILLIMI DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE	53
III.5 REKOMANDIME PËR ZHVILLIMIN DHE KOORDINIMIN E POLITIKAVE	54
GJURMIMI I REKOMANDIMEVE NGA MONITORIMI I RAP 2017/2108	54

IV. SHËRBIMI PUBLIK DHE MIRADMINISTRIMI	
I BURIMEVE NJERËZORE	57
IV.1 TREGUESIT WEBER TË PËRDORUR PËR SHËRBIMIN PUBLIK DHE MIRADMINISTRIMIN E BURIMEVE NJERËZORE DHE VLERAT PËR SHQIPËRINË	58
IV.2 REZULTATET E MONITORIMIT TË WEBER-IT	61
IV.3 PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE: SHËRBIMI PUBLIK DHE MIRADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE	79
IV.4 REKOMANDIME PËR SHËRBIMIN PUBLIK DHE MIRADMINISTRIMIN E BURIMEVE NJERËZORE	80
GJURMIMI I REKOMANDIMEVE NGA MONITORIMI I RAP 2017/2108	80
V.LLOGARIDHËNIA	83
V.1 TREGUESIT WEBER TË PËRDORUR PËR LLOGARIDHËNIEN DHE VLERAT PËR SHQIPËRINË	84
V.2 ÇFARË MONITORON WEBER-I DHE SI?	85
V.3 REZULTATET E MONITORIMIT TË WEBER-IT	86
V.4 PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE: LLOGARIDHËNIA.....	92
V.5 REKOMANDIME PËR LLOGARIDHËNIEN	92
GJURMIMI I REKOMANDIMEVE NGA MONITORIMI RAP 2017/2108	92
VI.OFRIMI I SHËRBIMEVE	95
VI.1 TREGUESIT WEBER TË PËRDORUR NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE DHE VLERAT PËR SHQIPËRINË	96
VI.2 ÇFARË MONITORON WEBER-I DHE SI?	97
VI.3 REZULTATET E MONITORIMIT TË WEBER-IT.....	98
VI.4 PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE: OFRIMI I SHËRBIMEVE.....	107
VI.5 REKOMANDIME PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT	108
GJURMIMI I REKOMANDIMEVE NGA MONITORIMI I RAP 2017/2108	108
VII.MIRADMINISTRIMI I FINANCVE PUBLIKE	111
VII.1 TREGUESIT WEBER TË PËRDORUR NË MIRADMINISTRIMIN E FINANCVE PUBLIKE DHE VLERAT PËR SHQIPËRINË	112
VII.2 ÇFARË MONITORON WEBER-I DHE SI?	113
VII.3 REZULTATET E MONITORIMIT TË WEBER	114
VII.4 REZULTATET PËRMBLEDHËSE: MIRADMINISTRIMI I FINANCVE PUBLIKE.....	121
VII.5 REKOMANDIME PËR MIRADMINISTRIMIN E FINANCVE PUBLIKT	122
GJURMIMI I REKOMANDIMEVE NGA MONITORIMI I RAP 2017/2108	122
PËRFUNDIM: VENDOSJA E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE NË KRYE TË AGJENDËS SË REFORMAVE	125
SHTOJCË	127
PËR METODOLOGJINË.....	127
LISTA E BURIMEVE TË REFERUARA NË RAPORT	135

MIRËNJOHJE

Mbledhja e të dhënave dhe shkrimi i këtij raporti ishte një proces mjaft sfidues, i cili u bë edhe më shumë i tillë nga pandemia e paparashikuar nga COVID-19. Ekipi rajonal u përshtat mirë me situatën në ndryshim dhe bashkëpunimi me kolegët tanë nga European Policy Centre (CEP-Beograd), Foreign Policy Initiative (FPI-Sarajevë), Institute Alternativa (IA-Podgoricë), Group for Legal and Political Studies (GLPS-Prishtinë) dhe European Policy Institute (EPI-Shkup) ishte i shkëlqyeshëm.

Jemi të vetëdijshëm që kërkesat tona të përsëritura drejtuar institucioneve shqiptare ishin një sfidë shtesë gjatë mbylljes dhe kushteve të punës në distancë. Dëshirojmë t'i falënderojmë të gjithë dhe në veçanti Departamentin e Administratës Publike për angazhimin e tyre të palëkundur për të siguruar që ekipi i IDM-së të merrte informacion të saktë dhe në kohë.

Departamenti i Administratës Publike, së bashku me Zyrën e Kryeministrit, Agjencinë për Ofrimin e Shërbimeve Publike të Integruara, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjen e të Dhënave Personale dhanë komente dhe sqarime të çmuara për përgatitjen e këtij raporti.

Do të dëshironim të falënderonim gjithashtu ekipin kombëtar të SIGMA-s për angazhimin e tyre të vazhdueshëm, interesin e singertë në procesin e monitorimit dhe në gjetjet tona, si dhe për inkurajimin e tyre. Po ashtu, falënderojmë Delegacionin e BE-së në Shqipëri për interesin e tyre për të diskutuar raportin, komentet mbi versionin paraprak dhe bashkëpunimin e tyre të shkëlqyer.

Një falenderim i veçantë shkon edhe për anëtarët e Grupit Kombëtar të Punës të cilët kanë kontribuar përmes diskutimeve dhe konsultimeve të ndryshme mbi çështjet kryesore në lidhje me ofrimin e shërbimeve, konsultimet publike, dhe zhvillimin dhe koordinimin e politikave. Kontributet e tyre kanë qenë të vazhdueshme dhe po çojnë përpara projektin WeBER 2.0.

Jemi gjithashtu mirënjohës ndaj Komisionit të BE-së, Rrjetit të Zhvillimit të Shoqërisë Civile të Ballkanit (BCSDN) dhe Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze të Bashkëpunimit për Zhvillim (SIDA) për mbështetjen e tyre bujare për projektin WeBER 2.0.

RRETH WeBER2.0

Fuqizimi i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për një Administratë Publike të Reformuar (WeBER 2.0) është një projekt tre-vjeçar i financuar kryesisht nga Bashkimi Evropian (BE). Për aktivitetet lidhur me përgatitjen dhe shtypjen e Monitorimit të RAP 2019/2020 dhe organizimin e konferencës së dytë rajonale “Qytetarët të Parët” në shkurt 2021, bashkëfinancimi u siguroi nga projekti “Mbrotja e Hapësirës Qytetare - Qendra Rajonale e Zhvillimit të Shoqërisë Civile”, financuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA) dhe zbatuar nga Rrjeti i Zhvillimit të Shoqërisë Civile të Ballkanit (BCSDN). WeBER 2.0 përfaqëson një vazhdim të projektit të mëparshëm nën të njëjtin emër, i cili u zbatua nga 2015 në 2018 dhe u financua nga Bashkimi Evropian, me bashkëfinancim nga Mbretëria e Vendeve të Ulëta.

Projekti i parë WeBER ka kontribuar për rritjen e rëndësisë, pjesëmarrjes dhe kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe medias në Ballkanin Perëndimor (BP) për të mbështetur dhe ndikuar në hartimin dhe zbatimin e reformës në administratën publike (RAP). WeBER 2.0 mbështetet në arritjet e mëparshme të projektit të parë WeBER dhe rrit më tej angazhimin e OSHC-ve në RAP duke bërë një monitorim të bazuar në të dhëna studimore në përputhje me kërkesat e BE-së. Ai synon gjithashtu të promovojë dialogun midis OSHC-ve dhe qeverisë në nivel rajonal, kombëtar dhe vendor, duke forcuar demokracinë pjesëmarrëse dhe duke ushtruar presion mbi qeveritë për të vazhduar zbatimin reformave administrative dhe për t'i sjellë administratat më pranë qytetarëve.

Në WeBER 2.0 kryhet një ndërthurje e aktiviteteve, duke kontribuar për arritjen e synimit të projektit, përkatësisht:

- Përmes Platformës Rajonale WeBER dhe Grupeve të saj Kombëtare të Punës të RAP-it, të cilat mbledhin më shumë se 130 OSHC. WeBER 2.0 po lehtëson dialogun për RAP-in për krijimin dhe zbatimin e një politike gjithëpërfshirëse dhe transparente, si dhe duke kontribuar në qëndrueshmërinë e reformave administrative në të mirë të qytetarëve.
- Përmes punës kërkimore dhe monitoruese dhe prodhimit të raporteve të monitorimit RAP, WeBER 2.0 ka krijuar dhe mbledhur të dhëna për një dialog kuptimplotë.
- Përmes Qendrës së Njohurive të OSHC-ve mbi RAP-in, WeBER 2.0 ofron një bazë të dhënash të hulumtueshme të analizave dhe raporteve mbi RAP-in, të prodhuara nga shoqëria civile në rajon.
- Përmes fushatës online «(Vë)Mendjen tek Reforma Jonë!» të qytetarëve të rajonit dhe platformës për mbledhjen dhe shfaqjen e pikëpamjeve të qytetarëve për RAP-in dhe përvojën e tyre me administratat (<https://citizens.par-monitor.org/>), WeBER 2.0 po mbledh kontributin e qytetarëve për të ndikuar tek autoritetet, duke kontribuar kështu në krijimin e administratave publike më të orientuara drejt qytetarëve.
- Duke pilotuar qasjen e monitorimit për integrimin e RAP-it në politikat sektoriale dhe pajisjen e OSHC-ve me kapacitetet për ta bërë atë, WeBER 2.0 synon të përmirësojë gdhendjen e RAP-it në të gjitha sistemet administrative të rajonit, duke rritur kështu qëndrueshmërinë e këtyre reformave.
- Përmes një skeme të granteve të vogla, WeBER 2.0 punon për përmirësimin e kapacitetit të OSHC-ve në Ballkanin Perëndimor për të marrë pjesë në RAP.

Produktet e WeBER 2.0 dhe informacionet e mëtejshme rreth tyre janë në dispozicion në faqen e internetit të projektit, në www.par-monitor.org.

WeBER 2.0 zbatohet nga Think for Europe Network (TEN), i përbërë nga gjashtë qendra studimore të orientuara drejt politikave të BE-së në Ballkanin Perëndimor:



institut alternativa



Duke bashkëpunuar me European Policy Centre (EPC) nga Brukseli, WeBER 2.0 ka siguruar vizibilitet në nivelin e BE-së.



ME KË BASHKËPUNOJMË?

Sipas projektit të mëparshëm WeBER, është vendosur bashkëpunim me një mori aktorësh në rajon dhe më gjerë në përpjekje për të siguruar një kurs të qëndrueshëm të reformave administrative në BP. Ky bashkëpunim ka vazhduar edhe për WeBER 2.0. Në nivel kombëtar, në secilin prej vendeve të BP-së, kemi koordinuar punën me ministritë e RAP-it dhe/ose me zyrat të cilat kanë pasur një rol partneriteti në projekt. Në nivel rajonal, WeBER 2.0 po bashkëpunon me Shkollën Rajonale të Administratës Publike (ReSPA), rrjetin SELDI - Southeast Europe Leadership for Development and Integrity (Udhëheqja e Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet) dhe nismën e Mbështetjes për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Miradministrimit (SIGMA), një nismë e përbashkët e BE-së dhe OECD-së.

Për më tepër, brenda Platformës Rajonale WeBER dhe Grupeve Kombëtare të Punës së RAP-it (GKP), kemi vazhduar të bashkëpunojmë me mbi 130 OSHC që veprojnë në nivel vendor dhe rajonal.

PËRMBLEDHJE

Raporti i Monitorimit të Reformës në Administratën Publike 2019/2020 është pjesë e një përpjekjeje rajonale për të monitoruar zbatimin e RAP-it. Qasja rajonale synon të ushtrojë presion pozitiv të ndërsjellë midis shteteve të Ballkanit Perëndimor për të ndërtuar kapacitete rajonale të monitorimit dhe për të ndarë njohuritë dhe përvojën brenda sektorit të shoqërisë civile dhe midis qeverive dhe shoqërisë civile.

Raporti paraqet rezultatet e punës së monitorimit të kryer nga shkurti deri në dhjetor të vitit 2020 nga ekipi kërkimor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Kuadri metodologjik i hartuar nga ekipi kërkimor i WeBER-it gjatë ciklit të mëparshëm të monitorimit (2017/2018), ndërthur burime të dhënash sasiore dhe cilësore. Duke përdorur parimet e SIGMA-së si themele metodologjike që drejtuan punën tonë të monitorimit, ky raport – si dhe raportet e tjera vendore të prodhuara nga kolegët tanë në rajon – janë plotësuese të punëve të ngjashme të kryera nga SIGMA/OECD dhe Komisioni Evropian. Një pikë thelbësore ndryshimi është se ky raport synon të nxjerrë në pah perspektivën e shoqërisë civile mbi zbatimin e RAP-it, duke vlerësuar kryesisht parimet dhe treguesit e SIGMA-së që matin perceptimet e shoqërisë civile dhe të publikut të gjerë mbi çështje kryesore të tilla si transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja në politikëbërje.

Janë përdorur 23 tregues për të matur zhvillimet e RAP-it në gjashtë fusha: (1) kornizën strategjike për RAP-in, (2) zhvillimin dhe koordinimin e politikave, (3) shërbimin publik dhe miradministrimin e burimeve njerëzore, (4) llogaridhënien, (5) ofrimin e shërbimeve dhe (6) miradministrimin e financave publike. Për çdo fushë, raporti ofron një vlerësim për secilin tregues, një përmbledhje të gjetjeve, dhe rekomandime për veprime në të ardhmen. Të gjitha gjetjet e këtij raport dhe nga ato të raportit të monitorimit 2017/2018 mund të përftohen dhe të krahasohen në Tabelat e Rezultateve Rajonale të RAP-it në www.par-monitor.org.

KUADRI STRATEGJIK PËR RAP

WeBER monitoron përfshirjen e shoqërisë civile si në zhvillimin ashtu edhe në monitorimin e zbatimit të kuadrit strategjik për RAP-in. Treguesit për këtë fushë përqendrohen posaçërisht në pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në nivelet politike dhe teknike të hartimit dhe monitorimit të dokumenteve kryesore strategjike të RAP-it.

Qasja e qeverisë ndaj hartimit dhe diskutimit të strategjisë së RAP-it është mjaft e cunguar. Ndërsa OSHC-të nuk janë të përfshira gjatë fazës së hartimit të dokumenteve, përfshirja e tyre në forume të tjera të koordinimit të politikave të RAP-it është jashtëzakonisht e kufizuar. Urdhri i Kryeministrit përshkruan detyrat e grupeve të integruara të menaxhimit të politikave dhe komiteteve drejtuese sektoriale, por nuk parashikon një pjesëmarrje nga OSHC-të gjatë hartimit të dokumenteve të politikave strategjike ose në konsultime në nivel administrativ. Kjo qasje ka përjashtuar OSHC-të nga procesi i vendimmarrjes dhe – duke mos publikuar procesverbale ose përmbledhje të vendimeve të marra në takimet e GMIP (Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave) dhe KDS (Komitet Drejtuese Sektoriale) për mirëqeverisjen dhe reformën në administratë – ka vënë në pikëpyetje efektivitetin e planifikimit dhe zbatimit të reformave të mirëqeverisjes dhe administratës publike.

OSHC-të mund të japin një mori informacionesh, veçanërisht mbi ofrimin e shërbimeve, antikorrupsionin dhe reformën për sundimin e ligjit. Angazhimi më i madh qeveri-OSHC pasuron debatin për RAP-in, duke mundësuar kështu dokumente të politikave të bazuara në të dhëna. Anasjelltas, nëse shoqëria civile vazhdon të mos jetë e përfshirë në këtë proces, agjenda e reformave do të perceptohet si një proces i drejtuar ekskluzivisht nga qeveria dhe e mbështetur nga donatorët e jashtëm.

ZHVILLIMI DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE

Në fushën e Zhvillimit dhe Koordinimit të Politikave, WeBER monitoron transparencën e raportimit dhe vendimmarrjes së qeverisë, përdorimin e analizave të shoqërisë civile dhe të dhënave në politikëbërje dhe gjithëpërfshirjen e praktikave të politikëbërjes përmes konsultimeve publike.

Dokumentet për të cilat u kërkua nëse kishte raporte të zbatimit të publikuara, përfshijnë Programin e Qeverisë (PQ) për 2017-2021, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2018-2020 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm (PBM) 2018-2020. Me përjashtim të PBM, nuk kishte asnjë raportim të qeverisë për pjesën tjetër të tyre. Shqyrtimi i bashkëpunimit qeveri-OSHC për zhvillimin dhe koordinimin e politikave zbuloi mangësi të konsiderueshme në transparencën, llogaridhënien, hapjen ndaj publikut dhe angazhimin e mirëfilltë të tij, që janë të nevojshme për të hartuar dhe zbatuar politika të suksesshme.

Gjetjet e bazuara në të dhëna të prodhuara nga OSHC-të mund të konsiderohen se referohen rregullisht në strategjitë e miratuara nga qeveria, të shqyrtuara nga ekipi kërkimor, duke qenë se 69% (9 nga 13) e strategjive të shqyrtuara përmbajnë referenca për gjetjet e OSHC-ve. Lidhur me vlerësimet e ndikimit të legjislacionit ex-ante (para miratimit) dhe analizat ex-post (pas zbatimit) për fushat e politikave të shqyrtuara, situata është përmirësuar disi në krahasim me ciklin e fundit të monitorimit, por mbetet në nivel të ulët. Për të njëjtën periudhë matjeje, 18% (4 nga 22) të vlerësimeve të ndikimit ex-ante të shqyrtuara dhe 41% (5 nga 12) të vlerësimit të ndikimit të politikave publike pas zbatimit të tyre (ex-post) përmbajnë referenca nga gjetjet e OSHC-ve.

Sa i takon procesit të konsultimit publik, karakteristika e tij kryesore është natyra e çrregullt. Megjithatë janë vendosur detyrime ligjore bazë për të siguruar një proces të efektshëm, institucionet e qeverisë qendrore nuk i përmbahen vazhdimisht kornizës së vendosur dhe nuk përipiqen të angazhojnë në mënyrë proaktive organizatat e shoqërisë civile në procesin e konsultimit. Ndërsa konsultimi publik u mbajt për afërsisht 64% (18 nga 28) të ligjeve të miratuara gjatë periudhës së matjes, vetëm 40% (6 nga 15) e strategjive dhe planeve të veprimit iu nënshtruan procesit të konsultimit publik gjatë të njëjtës periudhe. Për asnjë nga projektaktet që iu nënshtruan konsultimit publik, institucionet përgjegjëse të qeverisjes qendrore nuk kanë publikuar raportet përkatëse të këtij procesi, çka është detyrim ligjor.

SHËRBIMI PUBLIK DHE MIRADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Në fushën e Shërbimit Publik dhe Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, WeBER përqendrohet në disponueshmërinë publike të informacionit në lidhje me shërbimin publik, punësimin e personelit të përkohshëm, transparencën dhe karakterin meritokratik të rekrutimit në shërbimin civil, përzgjedhjen dhe emërimin e nëpunësve në nivel drejtues, si dhe masat për integritetin e shërbimit civil.

Departamenti i Administratës Publike (DAP) harton dhe publikon rregullisht raporte vjetore mbi shërbimin civil në faqen e tij të internetit. Raporti i DAP-it për vitin 2019 përfshin informacion mbi (i) miradministrimin e burimeve njerëzore, (ii) reformën strukturore, (iii) sistemin e shpërbimit, (iv) trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve dhe (v) zhvillimin e zgjerimin e sistemit të informacionit të miradministrimit të burimeve njerëzore (HRMIS), duke synuar rritjen e shkallës së përdorimit të sistemit në administratën publike. Raportet vjetore përqendrohen vetëm në shërbimin civil dhe nuk japin të dhëna për punonjësit e administratës shtetërore qendrore me kontrata të përkohshme apo për punonjësit e tjerë në administratën qendrore të cilët kryejnë shërbime mbështetëse. Kjo ndodh pasi DAP-it nuk i kërkohet ligjërisht të administrojë të dhëna për punonjës të tjerë, përveç nëpunësve civilë.

Legjislacioni shqiptar nuk e kufizon numrin e të punësuarve të përkohshëm në raport me numrin e përgjithshëm të nëpunësve civilë në administratën qendrore. Megjithëse vendimet e Këshillit të Ministrave përcaktojnë kufijtë vjetorë të numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, kufiri vjetor nuk është i pandryshueshëm dhe në fakt ndryshon shpesh përgjatë një viti. Ndërkohë, kriteret e punësimit për punësime të përkohshme përcaktohen nëpërmjet urdhrave të përbashkët midis ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucioneve përkatëse të qeverisë qendrore.

Shpalljet për konkurs në shërbimin civil publikohen kryesisht në portalin e Departamentit të Administratës Publike. Njoftimet janë përgjithësisht të qarta dhe pjesa e përshkrimit të punës rendit përgjegjësitë për pozicionin e shpallur. Vendet e lira të punës plotësohen së pari përmes konkurseve të brendshme (transferim paralel ose ngritje në detyrë) brenda shërbimit civil për pozicionet ekzekutive, të nivelit të ulët dhe të mesëm. Që nga miratimi i Ligjit për Nëpunësin Civil, nëpunësit civilë pranohen në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues (TND) përmes rrugës së pranimit të drejtpërdrejtë, jo përmes rrugës së trajnimit të thelluar pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Edhe pse atyre që pranohen në TND përmes linjës direkte u kërkohet ligjërisht t'i nënshtrohen programit të thelluar të trajnimit të ASPA-s, kjo kërkesë mbetet për t'u përmbushur pasi programi është ende në fazën e tij të pilotimit.

Kuadri ligjor është i përshtatshëm për të siguruar një proces konkurrues të bazuar në meritë dhe jo diskriminues për vendet e lira të nëpunësve civilë në nivel të lartë drejtues. Kriteret e rekrutimit për shërbimin e lartë civil janë të bazuara në meritë dhe nuk janë diskriminuese. Shqipëria përdor një proces rekrutimi të përbashkët për nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues. Kjo do të thotë që kandidatët për pozicionet TND nuk aplikojnë për një vend të lirë specifik, por për të gjitha vendet e lira të parashikuara në thirrjen për aplikim. Në fund të procesit të përzgjedhjes, kandidatët renditen dhe emërohen në përputhje me renditjen e tyre. Vlen të nënvizohet se ndonëse lista e kandidatëve të suksesshëm publikohet, pikët dhe renditja e tyre nuk publikohen. Lista e kandidatëve të suksesshëm u dërgohet institucioneve të qeverisë qendrore në mënyrë që ata të mund të zgjedhin kandidatin e preferuar për secilin prej vendeve të lira përkatëse të punës. Megjithëse procesi i rekrutimit të përbashkët është më i lehtë për t'u administruar, ai nuk merr parasysh ekspertizën e nevojshme në politikëbërje për pozicionet drejtuese për të cilat kryhet konkurrimi. Për më tepër, nuk publikohen institucionet në të cilat ndodhen vendet e lira.

Derisa një nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues të caktohet përfundimisht në një pozicion të lirë TND, Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore parashikon caktimin e përkohshëm të një nëpunësi tjetër civil: (i) një drejtor i përgjithshëm mund të caktohet përkohësisht në pozicionin e sekretarit të përgjithshëm dhe (ii) një drejtor drejtorie mund të caktohet përkohësisht në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme.

Legjislacioni shqiptar përmban garanci bazë për të siguruar integritetin në shërbimin civil përmes ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" (i ndryshuar). Akte të tjera ligjore përfshijnë ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" (i ndryshuar) dhe ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike". Pavarësisht dispozitave të legjislacionit në fuqi, nuk ka dispozita të qarta për parandalimin e situatave të "ndërrimit të xhaketa" (parandalimin e konflikteve të interesit që lindin si pasojë e punësimit të kaluar të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues në sektorin privat ose ndikimit të sektorit privat mbi këta nëpunës civilë duke u ofruar shpërblime në formë punësimi të ardhshëm në një subjekt privat mbi të cilin nëpunësi civil ushtron ndikim rregullator).

LLOGARIDHËNIA

Në fushën e Llogaridhënies, WeBER monitoron shkallën e zbatimit të vazhdueshëm në praktikë të së drejtës së informimit publik. Për këtë qëllim, WeBER shqyrton përvojat e OSHC-ve në përdorimin e legjislacionit për të drejtën e informimit dhe analizon informimin proaktiv të publikut përmes faqeve të internetit të autoriteteve publike të përzgjedhura, të cilat përfshijnë Zyrën e Kryeministrit (ZKM), ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrinë e Drejtësisë, ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë e Trajtimit të Pronave dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Institucionet e përzgjedhura për këtë tregues kishin publikuar përgjithësisht informacionet bazë për fushën e veprimtarisë së tyre, informacione për kontaktin e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe rast pas rasti edhe të atij për konsultimin publik. Mund të gjendej informacion i përgjithshëm mbi buxhetin e institucioneve, me përjashtim të ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ZKM-së dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Por informacioni buxhetor specifik që kërkohet sipas kriterëve të treguesit – përkatësisht, raporti financiar i vitit të shkuar dhe plani financiar i vitit aktual – nuk ishte i plotë. Për më tepër, këto institucione nuk ndjekin në mënyrë aktive një politikë për publikimin e të dhënave të përpunueshme (open data)¹.

Rezultatet e sondazhit të perceptimit të OSHC-ve tregojnë sfidat kryesore për disponueshmërinë dhe përfitim të informacionit, që konfirmohen më tej përmes shqyrtimit të faqeve në internet të institucioneve qeveritare të shqyrtuara.

Rezultatet e sondazhit nënvizojnë gjithashtu pabarazinë midis dispozitave të mjaftueshme ligjore për të siguruar përfitim të informacionit pa cenuar sigurinë kombëtare ose informacione të tjera të ndjeshme dhe – nga ana tjetër – zbatimin e tyre nga autoritetet publike, të cilat priren të parandalojnë përfitim të informacionit duke mos i zbatuar plotësisht këto dispozita.

Roli i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale konsiderohet se ka efekt pozitiv në vendosjen e standardeve mbi transparencën institucionale nga OSHC-të, por shumica e tyre nuk mendojnë se masat e buta apo sanksionet e vendosura nga Komisioneri ndaj institucioneve publike japin rezultat në nxitjen e një transparence më të madhe institucionale.

OFRIMI I SHËRBIMEVE

Qasja e WeBER-it për të monitoruar ofrimin e shërbimeve administrative është e orientuar drejt qytetarëve, duke u mbështetur në masë të madhe në perceptimet e publikut dhe shoqërisë civile rreth disponueshmërisë dhe marrjes së shërbimeve.

Si raportet e qeverisë ashtu edhe rezultatet e sondazhit të perceptimit publik konfirmojnë përpjekjet e qeverisë për rritjen e digjitalizimit të shërbimeve. Portali e-Albania dhe qendrat e ofrimit të shërbimeve të integruara kanë përmirësuar disponueshmërinë e shërbimeve për publikun dhe është bërë përparim i konsiderueshëm në ofrimin e tyre. Rezultatet e sondazhit të perceptimit publik konfirmojnë gjithashtu se marrja e shërbimeve është bërë më e lehtë dhe arrihet brenda një kohe më të shkurtër në dy vitet e fundit, ndërsa ndërgjegjësimi për disponueshmërinë e shërbimeve elektronike është dukshëm më i lartë se në ciklin e mëparshëm të monitorimit.

Pavarësisht këtyre arritjeve, rezultatet e sondazhit të perceptimit publik tregojnë një përdorim të ulët të shërbimeve elektronike, që është nën mesataren e rajonit. Edhe perceptimet pozitive mbi gatishmërinë e qeverisë për të kërkuar përshtypjet e qytetarëve mbi cilësinë e shërbimeve që ata marrin kanë pësuar rënie të ndjeshme në krahasim me ciklin e mëparshëm të monitorimit, shifra e të cilave është më e ulët se mesatarja rajonale. Vetëdijësimi i lartë i publikut për shërbimet elektronike, por përdorimi i ulët i tyre dhe pamjaftueshmëria e nxitjes, mbledhjes dhe përdorimit nga qeveria e përshtypjeve dhe rekomandimeve të qytetarëve tregojnë se politika e ofrimit të shërbimeve nuk është e orientuar sa duhet drejt lehtësisë së përfitim të shërbimeve.

Disa ofrues shërbimesh kanë përparuar më mirë se të tjerët. Kështu, institucionet përgjegjëse për regjistrimin e biznesit (Qendra Kombëtare e Biznesit) dhe të automjeteve (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) dhe – deri në një farë mase – institucioni përgjegjës për shërbimet për tatimin e vlerës së shtuar (TVSH) (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) publikojnë informacion të mjaftueshëm për shërbimet që ata ofrojnë, mënyrat për t'i marrë ato dhe të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve. Nga ana tjetër, institucioni përgjegjës për shërbimet e dokumenteve të identifikimit personal (ALEAT) dhe ai për regjistrimin e pasurisë së patundshme (Agjencia Shtetërore e Kadastrës) duhet të përmirësojnë informacionin që ofrojnë dhe të kenë qasje të efektshme për të marrë përshtypjet e qytetarëve për cilësinë e shërbimeve që ofrojnë.

¹ Formati open data nënkupton që të dhënat ruhen në një format që lejon përpunimin e tyre analitik nëpërmjet programeve të ndryshme kompjuterike. Shembuj të këtij formati përfshijnë, p.sh. .xls, .csv, .txt.

MIRADMINISTRIMI I FINANCIVE PUBLIKE

Në fushën e Miradministrimit të Financave Publike WeBER monitoron disponueshmërinë e të dhënave buxhetore së bashku me praktikatat e komunikimit me publikun. Faqet zyrtare të internetit shqyrtohen për të vlerësuar transparencën dhe përfitim të të dhënave vjetore të buxhetit; mënyrën se si qeveria u komunikon qytetarëve gjetjet e raporteve të kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP); disponueshmërinë e informacionit të prokurimit publik; si dhe shkallën e disponueshmërisë për publikun të informacionit rreth punës së institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH).

Raportimi mbi buxhetin është përgjithësisht tërësor dhe publikohet rregullisht. Ai i mundëson publikut informacionin bazë për të ardhurat dhe shpenzimet. Nga tre format e raportimit (mujore, gjashtëmujore dhe të fundvitit), raportimi i fundvitit është më i ploti; megjithatë, këto raporte nuk përfshijnë informacione të rëndësishme mbi performancën sektoriale të sektorëve strategjikë të tillë si energjia, minierat dhe infrastruktura. Këto raporte japin disa të dhëna mbi zbatimin e zërave specifike të buxhetit të ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo si pjesë e një vlerësimi sektorial të veçantë.

Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit dhe Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik publikon raportet e KBFP-së, të cilat përfshijnë 18 tregues të performancës, tre prej të cilëve lidhen me masat e kontrollit të brendshëm financiar. Këta tregues vlerësojnë efektshmërinë e mekanizmave të kontrollit financiar, cilësinë e raporteve të brendshme financiare të paraqitura pranë ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe nëse planet e tyre të veprimeve për krijimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar përmbushin nevojat për sigurimin e kontrollit të brendshëm financiar të tyre.

Ministritë japin informacion mbi zyrtarin përgjegjës për kontrollin e brendshëm financiar, por japin pak informacion mbi planet dhe aktivitetet e tyre për të përmirësuar KBFP, si p.sh. publikimin e regjistrit të risqeve financiare ose të rregullores së procedurave. Gjetjet e raporteve të KBFP-së nuk janë diskutuar në Kuvend.

Politikat e prokurimit publik rregullohen nga Agjencia e Prokurimit Publik. Raportet e Agjencisë janë burimi kryesor i informacionit mbi prokurimin publik, pasi ministritë e linjës zakonisht nuk publikojnë plane prokurimi dhe raportet e zbatimit të tyre. Raportet e prodhuara nga Agjencia kanë të dhëna të bollshme, por ato nuk ofrohen në një format të dhënash të përpunueshme (open data).

Prokurimi publik kryhet në mënyrë të qendëruar, përmes prokurimit elektronik. Procedurat (tenderat) e hapura dhe kërkesat për propozime janë procedurat kryesore të përdorura për prokurimin publik. Ndërsa procedurat e hapura të prokurimit janë krejtësisht të pakufizuara, kërkesat për propozime nuk janë të hapura, por teknikisht janë konkurruese.

Për të siguruar që paratë e taksapaguesve nuk shpërdorohen por shpenzohen në dobi të interesave publike, puna e KLSH-së është kritike. KLSH-ja bën publike punën e institucionit në mënyrë periodike përmes buletinëve mbi punën audituese dhe organizon një muaj me konferenca e leksione publike për të promovuar punën e saj. Ky angazhimi publik i institucionit është mjaft i rëndësishëm për njohjen e publikut me punën e tij, por vlen të theksohet se pjesa kryesore e punës së KLSH-së – raportet e auditimit – nuk janë lehtësisht të përdorshme e të lexueshme për shkak të gjuhës teknike dhe anonimizimit të operatorëve ekonomikë dhe zyrtarëve publikë përgjegjës për shkelje. Ndonëse raportet e auditimit zakonisht shoqërohen nga një përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve, KLSH-ja mund ta përmirësojë më tej komunikimin e rezultateve kryesore të raporteve me publikun, duke ofruar përmbledhje më të shkurtra dhe të qarta. Ndërkohë, KLSH-ja mund të përfitonte nga konsultimi me OSHC-të për të trajtuar risqet financiare në sektorin publik pasi do të përftonte më shumë të dhëna ndihmuese për të kryer detyrat institucionale.

LISTA E SHKURTIMEVE

AB	Auditi i Brendshëm
ADISA	Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara
AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
ALB	Shqipëri
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BCSDN	Rrjeti i Zhvillimit të Shoqërisë Civile të Ballkanit
BE	Bashkimi Evropian
BH	Bosnje-Hercegovinë
BP	Ballkani Perëndimor
CAF	Korniza e vlerësimit të përbashkët
CATI	Intervistë me telefon të ndihmuar nga kompjuteri
CAWI	Intervistim në internet të ndihmuar nga kompjuteri
COVID	Sëmundja e koronavirusit
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DZHM	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GMIP	Grup për Menaxhimin e Integruar të Politikave
HRMIS	Sistemi Informacionit të Miradministritit të Burimeve Njerëzore
IPA	Instrument i Para-Anëtarësimit
IPSI	Sistemi i Informacionit të Sistemit të Planifikimit të Integruar
ISSAI	International Standards of Supreme Audit Institution (Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Auditimit)
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KDS	Komitet Drejtues Sektorial
KE	Komisioni Evropian
KKSHC	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
KMSHC	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
KOS	Kosovë
KSRAP	Korniza Strategjike për Reformën në Administratën Publike
LL	Llogaridhënia
MBNJ	Miradministriti i Burimeve Njerëzore
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFP	Miradministriti i Financave Publike

MKD	Maqedoni e Veriut
MKF	Miradministriti dhe Kontrolli Financiar
MNE	Mali i Zi
NJQH	Njësia Qendrore e Harmonizimit
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
Open Data	Të dhëna të përpunueshme në formate si p.sh. .xls, .txt, .csv.
OSH	Ofrimi i Shërbimeve
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PPB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PPP	Partneritetit Publik-Privat
PQ	Programi i Qeverisë
RAP	Reforma në Administratën Publike
RIA	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (të legjislacionit)
SHPMBNJ	Shërbimi Publik dhe Miradministriti i Burimeve Njerëzore
SIGMA	Support in Improvement in Governance and Management (Mbështetja për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Miradministritit)
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SRB	Serbi
TND	Trupa e Nivelit të Lartë Drejtues
TVSH	Tatim i Vlerës së Shtuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WeBER	Projekti për Mundësimin e Monitorimit të Reformës në Administratën Publike nga Shoqëria Civile në Vendet e Ballkanit Perëndimor [Western Balkans Enabling Project for Civil Society Monitoring of Public Administration Reform]
WeBER 2.0	Fuqizimi i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për një Administratë Publike të Reformuar [Western Balkans Civil Society Empowerment for a Reformed Public Administration]
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZHKP	Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave

I. HYRJE

I.1 REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE INTEGRIMI I BALLKANIT PERËNDIMOR NË BE - PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM MONITORIMI?

Që prej botimit të parë Monitorimi i RAP në Ballkanin Perëndimor në 2018, rajoni i Ballkanit Perëndimor (BP) ka ecur ngadalë në rrugën drejt demokratizimit të mëtejshëm dhe modernizimit të shoqërive të tij, duke zbatuar reformat e nevojshme strukturore, ekonomike dhe sociale për të përmirësuar jetën e qytetarëve. Këto procese reformuese, që nga fillimi i tyre, u nxitën nga aspirata e vendeve për t'u bërë anëtare të BE-së dhe ato vazhdojnë të udhëhiqen nga procesi i integritimit në BE dhe kushtëzimet që janë pjesë e procesit. Mirëqeverisja qëndron në zemër të projektit të integritimit evropian, duke kërkuar që administratat publike të jenë profesionale, të besueshme dhe të parashikueshme, të hapura dhe transparente, efikase dhe të efektshme dhe të përgjegjshme para qytetarëve të tyre.

Me strategjinë e re të Komisionit Evropian (KE) të nxjerrë në fillim të vitit 2020, reforma e administratës publike (RAP) u riafirmua si një zonë reforme themelore në politikën e zgjerimit të BE-së. Prandaj, RAP u bashkua me fushat e sundimit të ligjit, qeverisjes ekonomike dhe funksionimit të institucioneve demokratike si shtyllat themelore të reformës që do të përbëjnë themelin për vlerësimin e përgjithshëm të progresit të vendeve aspiruese drejt BE-së.

Kuadri i BE-së për përcaktimin, udhëzimin dhe vlerësimin e reformave administrative në kontekstin e zgjerimit ka mbetur i lidhur ngushtësisht me grupin e Parimeve të Administratës Publike. Të vendosura në vitin 2014, këto parime, të njohura si "Parimet SIGMA" (pasi vlerësohen rregullisht nga programi SIGMA i OECD)² ofrojnë një udhërrëfyes për kandidatët e BE-së që të ndjekin dhe të respektojnë për kryerjen e RAP ndërsa punojnë për t'u bërë anëtare të BE-së. KE dhe SIGMA punuan së bashku për të përcaktuar fushën e këtyre parimeve të administratës publike³, të strukturuar rreth gjashtë fushave kryesore:

1. korniza strategjike për reformën në administratën publike
2. zhvillimi dhe koordinimi i politikave
3. shërbimi publik dhe miradministrimi i burimeve njerëzore
4. llogaridhënia
5. ofrimi i shërbimeve
6. miradministrimi i financave publike

Këto parime, pra, përbëjnë emëruesin e përbashkët të RAP për të gjitha vendet aspirante, duke udhëhequr rrjedhën e reformave të tyre në drejtim të anëtarësimit në BE.⁴

WeBER⁵ përdori Parimet e Administratës Publike si gur themeli të monitorit të saj të RAP për dy arsye kryesore. Nga njëra anë, si një emërues i përbashkët për reformat e RAP në rajon, parimet lejojnë krahasime dhe shkëmbime dijeshe e përvojash në të gjithë rajonin dhe mundësojnë konkurrencë pozitive midis administratave të vendeve të BP-së. Nga ana tjetër, parimet udhëheqin reformat në këto vende drejt përmbushjes së kushteve të anëtarësimit, duke i ndihmuar kështu transformimin e tyre në vende të ardhshme anëtare të BE-së.

Gjatë hartimit të qasjes së monitorimit të WeBER-it, ne morëm parasysh që deri në anëtarësimet e vendeve të rajonit në BE, SIGMA/OECD do të angazhohet në rajon si një forcë e jashtme nxitëse e reformave duke u

2 SIGMA (Support for Improvement in Governance and Management – Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Miradministrit) është një nismë e përbashkët e OECD-së dhe BE-së, e financuar kryesisht nga BE-ja. Objektivi i saj kryesor është të forcojë bazat për qeverisjen e përmirësuar publike, duke mbështetur kështu zhvillimin socio-ekonomik në rajonet afër BE-së duke ndërtuar kapacitete në sektorin publik, duke rritur qeverisjen horizontale dhe duke përmirësuar hartimin dhe zbatimin e reformave të administratës publike, duke përfshirë vendosjen e përparësive të duhura, renditjen dhe buxhetimin tyre. Mund të gjeni më shumë informacion në: <http://www.sigmaxweb.org/>.

3 Parimet e Administratës Publike për vendet kandidatë dhe potenciale për anëtarësim në BE gjenden në: <https://bit.ly/395diWq>. Një dokument që titullohet "Parimet e Administratës Publike: Një Kornizë për Vendet Fqinje të BE-së" është hartuar për vendet që janë pjesë e politikës së BE-së për vendet fqinje të saj: <http://bit.ly/2fsCaZM>.

4 SIGMA kryen vlerësime të rregullta të përparimit të bërë nga qeveritë e BP në përmbushjen e parimeve të tyre. Vlerësimet për të gjithë kapitujt e RAP-it kryhen një herë në dy-tre vjet dhe vlerësime në shkallë më të vogël kryhen në mes të kësaj hapësire kohore për kapituj të veçantë që vlerësohen si kritikë nga SIGMA. Për më shumë informacion mbi vlerësimet e SIGMA, vizitoni www.sigmaxweb.org.

5 Duke filluar nga dhjetori 2019, WeBER po zbatohet nën titullin "WeBER 2.0 - Fuqizimi i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për një Administratë Publike të Reformuar".

mbështetur gjithashtu në kushtëzimet e BE. Deri atëherë, shoqëria civile në secilin vend mund të prodhojë rezultate plotësuese bazuar në fushat e tyre të ekspertizës. Gjithashtu, shoqëria civile duhet të zgjerojë gradualisht fushën e monitorimit të saj dhe të kërkojë mënyra për të vazhduar me këtë proces në një mënyrë më gjithëpërfshirëse në periudhën pas anëtarësimit, kur SIGMA nuk do të ketë më mandatin për të kryer vlerësime të jashtme të RAP. Në atë kohë, aktorët lokalë të shoqërisë civile duhet të kenë një qasje të zhvilluar në identifikimin e fushave kritike të ndërhyrjes, në të cilat të përqendrojnë përpjekjet e tyre të monitorimit.

Për më tepër, megjithëse kushtëzimi i BE-së është duke siguruar monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të jashtëm të progresit të reformave, zgjerimet e mëparshme të BE-së kanë treguar se arritjet e reformave të para-anëtarësimit u zhbënë pas anëtarësimit, duke u larguar efektivisht nga standardet e qeverisjes së mirë. Në disa vende, qeveritë kanë zvogëluar standardet e tyre të transparencës; administratat janë politizuar dhe përpjekjet anti-korrupsion janë zbehur. Parimi kyç i projektit WeBER është se vetëm duke fuqizuar aktorët joqeveritarë lokalë dhe qeveritë mund të mbahen nën presion për të zbatuar reforma administrative, shpeshherë të dhimbshme dhe të padëshirueshme, duke forcuar demokracinë pjesëmarrëse në nivelin kombëtar dhe vendor.

Në mënyrë që të kontribuojë në fuqizimin e aktorëve lokalë të shoqërisë civile, WeBER ka filluar nisma të shumta për ngritjen e vetëdijes dhe ngritjen e kapaciteteve që nga viti 2015. Përveç përfshirjes dhe mbledhjes së njohurive të OSHC-ve në procesin e monitorimit të RAP dhe krijimin e raporteve të monitorimit, një numër i OSHC-ve rajonale u trajnuan për monitorimin dhe avokimin e RAP-it. Për më tepër, OSHC-të lokale që monitorojnë fusha specifike të RAP-it në nivelin lokal u këshilluan rreth qasjes së tyre monitoruese. Përveç kësaj, në kuadrin e platformës rajonale WeBER u kryen konsultime të vazhdueshme mbi zbatimin e monitorimit të RAP-it dhe parimet e SIGMA-s u prezantuan në një grup më të gjerë të OSHC-ve në rajon. WeBER vazhdon të nxisë qasje të reja të shoqërisë civile ndaj RAP duke pilotuar ushtrime monitorimi të përfshirjes së RAP në sektorë të ndryshëm të politikave dhe krijimin e gjashtë portaleve paralele online përmes të cilave qytetarët ftohen të ndajnë përvojat e tyre në bashkëveprimin me administratat publike.⁶

Së fundmi, shpërthimi i pandemisë COVID-19 nxjerr në pah më shumë rëndësinë e administratave publike që funksionojnë mirë, në gjendje të ushtrojnë funksionet kryesore në shërbim të nevojave të qytetarëve. Për më tepër, këto rrethana të jashtëzakonshme vënë në dukje çështjen e aftësisë së administratave publike për t'u përshtatur dhe për të shtuar përpjekjet e tyre për të ofruar shërbimet në mënyrë digjitale, duke mundësuar një komunikim virtual e të pandërprerë me qytetarët dhe sigurimin e mundësisë së telefonit për punonjësit e shërbimit civil.

Për shkak të ndikimit të pandemisë COVID-19, hulumtuesit e WeBER-it prodhuan ciklin e monitorimit të RAP 2019/2020 duke bashkëpunuar në mënyrë virtuale dhe duke e përshtatur qasjen e punës në terren (të tilla si intervista dhe fokus-grupe) në raste të caktuara me kushtet e reja. Rrethanat e lidhura me pandeminë, përgjithësisht, kanë pasur një ndikim të kufizuar në gjetjet e projektit, pasi shumica e praktikave të analizuar kishin ndodhur para pandemisë (2019). Sidoqoftë, deri në një farë mase pandemia ngadalësoi procesin e monitorimit, pasi për një kohë ishte më e vështirë për të marrë informacion nëpërmjet kërkesave për informacion. Megjithatë, nuk u hasën pengesa të tjera të mëdha.

1.2 QASJA METODOLOGJIKE E MONITORIMIT

■ Parimet e BE-së si pikënisje për një kornizë të përbashkët reference

Siç u përmend më lart, WeBER i qaset monitorimit të RAP në Ballkanin Perëndimor nga perspektiva e kërkesave uniforme të paraqitura nga procesi i pranimi në BE për të gjithë rajonin. Ndërsa BE dhe SIGMA/OECD kanë zhvilluar një numër parimesh gjithëpërfshirëse për të gjitha vendet për t'i shndërruar në shtete me administrata moderne, WeBER i ka përdorur këto parime si standardin e artë dhe një pikënisje, së pari për hartimin dhe më pas zbatimin e metodologjisë së monitorimit të vet. Për më tepër, në përputhje me qëllimin e tij të përgjithshëm,

⁶ Portali i qytetarëve për gjashtë administratat gjendet në: <https://citizens.par-monitor.org/>.

WeBER është mbështetur në metodat e SIGMA-s për të përcaktuar treguesit e vet, duke përdorur një strukturë të ngjashme të treguesit dhe të njëjtën mënyrë pikëzimi, me sasinë e elementeve (nën-treguesit) dhe rezultatet totale të caktuara për vlerat e treguesit në një shkallë nga 0 në 5.

Kjo qasje është zbatuar duke qenë të ndërgjegjshëm që qasja gjithëpërfshirëse e SIGMA-s nuk mund dhe nuk duhet të kopjohet nga aktorët lokalë, pasi ajo tashmë përfaqëson një burim monitorimi të pavarur për qeveritë e rajonit. Gjithsesi, WeBER nuk kërkon të paraqesë një vlerësim konkurrues mbi përmbushjen e këtyre parimeve, por për të dhënë një pamje plotësuese të sfidave të reformës bazuar në perspektivën e secilit vend dhe qasjet plotësuese kërkimore.

■ Qasja rajonale

Një aspekt i rëndësishëm i monitorimit të RAP nëpërmjet projektit WeBER është karakteri i tij rajonal. Qasja rajonale nënkupton që të gjithë treguesit janë përshtatur dhe përpiluar në një mënyrë që mundëson zbatimin në gjashtë sisteme të ndryshme që vlerësohen. Së dyti, qasja rajonale shërben të krahasohen rezultatet rajonalisht.

Një qasje e tillë pa dyshim që shkakton deri në njëfarë mase humbje të detajeve dhe specifikës kombëtare në punën e monitorimit. Sidoqoftë, krahasimi rajonal paraqet mjaft përfitime krahasuar me qasjet specifike për secilin vendi. Më e rëndësishmja e kësaj qasjeje, është potenciali për të krahasuar rezultate të ndryshme kombëtare, të cilat lejojnë krahasimin e vendeve dhe sistemeve të tyre, identifikimin e praktikave të mira, si dhe rritjen e konkurrencës pozitive midis qeverive. Gjithashtu, kjo qasje ushqen njohuritë dhe ekspertizën rajonale në lidhje me RAP midis OSHC-ve, e cila është veçanërisht e dobishme për nxitjen e nismave të reja dhe përpjekjeve të avancimit të përpjekjeve për përmirësim të administratës publike në nivel kombëtar.

■ Zgjedhje e parimeve “për dhe nga shoqëria civile”

Raporti i Monitorimit të RAP ka një strukturë bazë e cila ndjek gjashtë kapitujt e Parimeve të Administratës Publike. Ai nuk përpaket të monitorojë të gjitha parimet nën secilin kapitull, as nuk kërkon t'i monitorojë ato në një mënyrë të gjithanshme, por ndjek një qasje më të përqendruar dhe specifike. Kriteret për zgjedhjen e parimeve që do të monitorohen (dhe nën-parimet e tyre) u zhvilluan duke pasur parasysh tre ide kryesore:

- Gjenden disa parime në të cilat shoqëria civile është më aktive dhe si pasojë ka më shumë njohuri dhe përvojë;
- Në mënyrë që të ketë ndikim në publik, raporti i monitorimit të RAP do të duhet të jetë i rëndësishëm për interesat e publikut të gjerë në rajon;
- Qasja duhet të sigurojë një vlerë të shtuar në punën e SIGMA dhe jo ta kopjojë atë.

Qasja e monitorimit të WeBER-it përdor përvojën dhe ekspertizën e grumbulluar brenda sektorit të shoqërisë civile në rajon në maksimumin e mundshëm. Prandaj, një numër treguesish mbështeten te shoqëria civile si një burim thelbësor i njohurive.

■ Përqendrimi mbi aspekte të administratës që lidhen me përballjen direkte me qytetarët

Një kriter tjetër kryesor që ka udhëhequr zgjedhjen e parimeve (dhe nën-parimeve) të WeBER është lidhja e tyre me punën dhe interesat e publikut më të gjerë. Kjo do të thotë që si zgjedhja e parimeve ashtu edhe përcaktimi i treguesve përfshinin pyetje të tilla si: “A është e rëndësishme për publikun?” ose “A është i dukshëm nga qytetarët e zakonshëm ky aspekt i administratës publike?” Në përputhje me këtë qasje, metodologjia përqendrohet në pikat e ndërveprimit midis administratës dhe përdoruesve të saj (qytetarë dhe biznese), ndërsa lë jashtë çështje që përbëjnë procedurat e brendshme të funksionimit të administratës të padukshme për publikun.

■ Përpilimi i treguesve WeBER

Në vitin 2016, ekipi hulumtues i WeBER përpiloi një sërë treguesish të përbërë nga disa elementë (në thelb nën-tregues), duke shtjelluar aspekte të ndryshme të çështjes që shqyrton i gjithë treguesi. Vlerësimi i plotë i treguesve është sasior, duke marrë parasysh që të gjitha gjetjet – të bazuara në burime si sasiore ashtu edhe cilësore – u janë caktuar vlera numerike. Gjetjet e hulumtimit përdoren për të vlerësuar vlerat e elementeve individuale, duke i vlerësuar 0 ose 1 (për vlerësime më pak komplekse, të tilla si ato ku një përgjigje e thjeshtë ‘po’ ose ‘jo’ është e mundur) dhe 0 ose 2 (për vlerësime më komplekse). Vlerësimet paraqiten gjithnjë në vlera të plota.

Për më tepër, secilit element i përcaktohet një peshë specifike – (1) ose (2) – duke e shumëzuar rezultatin e vlerësimit bazë të elementit me 1 ose 2. Në parim, pasha specifike (2) u përket atyre elementëve që përmbajnë kërkesa themelore në lidhje me një praktikë të caktuar. Pasha specifike (1) u përket atyre elementëve që përmbajnë kërkesa ose standarde më të larta dhe më komplekse. Për shembull, një peshë specifike (2) do të caktohej për një element që vlerëson një praktikë bazë të raportimit të qeverisë, ndërsa një peshë specifike (1) do të caktohej për një element që vlerëson nëse të dhënat në një raport përfshijnë perspektivën gjinore ose nëse janë të disponueshme në një të format të të dhënave të përpunueshme (open data).⁷ Për më tepër, pasi shumica e indikatorëve ndërthurin qasje të ndryshme kërkimore dhe burime të dhënash, në rastet kur gjetjet e studimit të perceptimit dhe shqyrtimi i dokumenteve zyrtare përfshihen në një tregues, pasha specifike (1) i caktohet të parës dhe (2) të dytës.

Në fund, për secilin tregues ekziston një shkallë konvertimi për kthimin e rezultateve totale nga analizat e elementeve individuale në vlera në një shkallë të përbashkët nga 0 në 5. Vlerat përfundimtare të treguesit paraqiten vetëm si numra të plotë. Detajet e pikëzimit dhe metodologjisë për secilin tregues janë në dispozicion në pjesën e monitorimit RAP të faqes në internet të projektit WeBER.⁸

■ Ndryshimet kyçe metodologjike midis dy raporteve të monitorimit të RAP

Përvoja nga hartimi i metodologjisë së monitorimit dhe zbatimi i monitorit të parë të RAP-it rezultoi në tre ndryshime kryesore në lidhje me treguesit në këtë cikël monitorimi.

Së pari, në fushën e Zhvillimit dhe Koordinimit të Politikave (ZHKP), ekipi i WeBER-it ka përmirësuar treguesin që përqendrohet në vlerësimin e cilësisë së pjesëmarrjes së publikut (përmes formave të ndryshme të konsultimeve publike) në politikëbërje. Rezultateve të sondazhit të perceptimit të OSHC-ve iu shtuan shqyrtimi të procesit të konsultimeve publike për dokumentet e politikave dhe akteve ligjore për të vlerësuar cilësinë e përfshirjes së publikut në praktikë. Përmirësimi i këtij treguesi përfshin gjithashtu një vlerësim të portaleve qeveritare të konsultimit/pjesëmarrjes përmes dy elementeve të rinj (nën-tregues). Duke ndërthurur perceptimet e OSHC-ve me gjetjet për secilën temë të mbuluar (të cilat përfshijnë raportimin e performancës qeveritare, përdorimin e të dhënave dhe studimeve nga institucionet e nivelit qendror në zhvillimin e politikave, si dhe transparencën e vendimmarrjes qeveritare), vlerësimet e WeBER-it në këtë fushë të RAP-it u bënë më të plota.

Së dyti, disa tregues që ishin planifikuar fillimisht për ciklin e parë të monitorimit të RAP ishin lënë në atë kohë për shkak të kapaciteteve të kufizuara të stafit dhe ngarkesës sfiduese të punës. Pastaj u ra dakord që një tregues i lidhur me prokurimin publik do të prezantohej në ciklin e dytë të monitorimit. Kështu, një tregues i ri i është shtuar fushës së Miradministrimit të Financave Publike, që mbulon politikën e prokurimit publik. Matur për herë të parë, ky tregues mbi prokurimin publik përcakton vlerat fillestare në këtë cikël monitorimi.

Së fundmi, një tregues në fushën e Zhvillimit dhe Koordinimit të Politikave (duke u përqendruar në mundësinë e përfuturit të legjislacionit dhe materialeve shpjeguese për publikun) nuk u përfshi në këtë cikël monitorimi. Ky vendim erdhi pas diskutimeve të brendshme mbi reagimet e marra nga OSHC-të në rajon bazuar në sondazhin e kryer brenda ciklit të parë të monitorimit dhe mbi kapacitetet e brendshme të ekipit kërkimor

⁷ Format i open data nënkupton që të dhënat ruhen në një format që lejon përpunimin e tyre analitik nëpërmjet programeve të ndryshme kompjuterike. Shembuj të këtij formati përfshijnë, p.sh. .xls, .csv, .txt.

⁸ Faqja e projektit WeBER: <http://www.par-monitor.org>. Metodologjia dhe tabelat individuale të treguesve mund të merren nëpërmjet ‘PAR Monitor’.

për të trajtuar një numër të rritur të treguesve. Si pasojë, në lidhje me përparësinë dhe urgjencën e trajtimit të çështjeve të ndryshme të RAP, u vendos që treguesi mbi disponueshmërinë e legjislacionit t'i linte vendin treguesit mbi prokurimin publik.

■ Paketa e monitorimit të RAP

Monitorimi i RAP përbëhet nga një raport rajonal krahasues dhe gjashtë raporte kombëtare që përpunojnë gjetjet e monitorimit për secilën administratë në më shumë detaje. Në përputhje me këtë qasje, raporti rajonal përqendrohet në gjetjet krahasuese, prirjet rajonale dhe shembuj të praktikave të mira ose të këqija, por nuk ofron rekomandime. Raportet kombëtare, nga ana tjetër, përshkruajnë gjetjet specifike të vendit në mënyrë të detajuar dhe japin një sërë rekomandime për politikëbërësit kombëtarë për secilën fushë të RAP-it.

Vlera e shtuar e të gjithë ushtrimit të monitorimit është se vë në dukje ndryshimet midis vlerave të këtij monitorimi me ato të monitorimit të kryer në 2017/2018. Ai gjithashtu lejon palët e interesuara të reflektojnë mbi zhvillimet dhe prirjet më të rëndësishme në zbatimin e politikës dhe në perceptimet e grupeve kryesore të synuara. Në raste të caktuara, kjo lejon krahasime të rezultateve me kalimin e kohës, si p.sh. krahasimi i rezultateve të sondazheve të perceptimit të publikut mbi praktikën e ofrimit të shërbimeve administrative. Në rastet e sondazheve të nëpunësve civilë dhe OSHC-ve, ky raport na lejon të vëmë në dukje prirjet mbizotëruese në opinionet e këtyre grupeve të palëve të interesit në krahasim me sondazhet e mëparshme për llogari të monitorimit të RAP.⁹

Dokumenti “Master Methodology” dhe tabelat e detajuara të treguesve, të disponueshëm në faqen e internetit të projektit WeBER¹⁰, duhet të konsiderohen gjithashtu si pjesë e të gjithë paketës së monitorimit dhe mund të përdoren për të kuptuar plotësisht detajet e këtij hulumtimi atje ku është e nevojshme.

E gjithë paketa e raporteve shoqërohet gjithashtu nga një mjet – “Regional PAR Scoreboard” – për të parë dhe krahasuar gjetjet midis dy cikleve të ndryshëm të monitorimit. Bazë e të dhënave për të gjitha vlerat e treguesve dhe tabelat dhe grafikët që i paraqesin mund të gjenden në faqen e internetit të projektit www.par-monitor.org, nën titullin “PAR Monitor”. Tabela e rezultateve gjithashtu përfshin një pjesë për të parë dhe krahasuar rezultateve të monitorimit më të fundit të SIGMA-s për të gjithë rajonin.

■ Sigurimi i cilësisë përgjatë procesit të monitorimit

Ashtu si në ciklin e parë të monitorimit, edhe në të dytin u zbatua një procedurë me disa hapa për sigurimin e cilësisë për të garantuar që gjetjet e monitorimit bazohen në të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme në këndvështrim rajonal. Ky proces përfshiu kontrolle të ekspertëve të brendshëm dhe të jashtëm dhe rishikime të të dhënave. Procesi i brendshëm i kontrollit të cilësisë përbëhej nga dy elementë kryesorë:

1. një proces i vlerësimit nga kolegët, i cili përfshiu formate të ndryshme bashkëpunimi, të tilla si komente me shkrim, takime virtuale të ekipit dhe seminare;
2. me përfundimin e vlerësimeve për secilën administratë, hulumtuesi kryesor dhe udhëheqësi i ekipit të WeBER-it kryen një kontroll të kryqëzuar horizontal të gjetjeve për të siguruar krahasueshmërinë e tyre rajonale dhe uniformitetin e qasjeve të vlerësimit, duke e përgatitur kështu analizën për rishikimin e jashtëm.

Dy fazat e procesit të jashtëm të kontrollit të cilësisë përfshijnë:

- kontrolli i të dhënave nga institucionet qeveritare përgjegjëse për fushë përkatëse të vlerësuar;

⁹ Duke qenë se nuk ishte e mundur të përcaktoheshin kampione përfaqësuese e të rastësishëm për popullatat e OSHC-ve dhe nëpunësve civilë, këto dy sondazhe u shpërndanë në të dy këto popullata dhe u bë analiza mbi përgjigjet e plota të tyre. Duke marrë parasysh që kampionet për monitorimin bazë të 2017/2018 dhe në këtë cikël të dytë monitorimi nuk janë identike, rezultatet nuk janë plotësisht të krahasueshme. Megjithatë, nivelet e përgjithshme të përgjigjes janë mjaftueshëm të afërta për të na lejuar të krahasojmë prirjet midis dy sondazheve.

¹⁰ Faqja e projektit WeBER: <http://www.par-monitor.org>. Metodologjia dhe tabelat individuale të treguesve mund të merren nëpërmjet ‘PAR Monitor’.

- pas hartimit të raportit rajonal, anëtarët e Bordit Këshillimor të WeBER-it dhe ekspertë të njohur ndërkombëtarë kryen një rishikim të kapitujve rajonalë të monitorimit në përputhje me fushat e tyre të ekspertizës.

Raportet kombëtare gjithashtu iu nënshtruan procedurave standarde të rishikimit të brendshëm nga secila organizatë partnere e projektit.

■ Kryerja e monitorimit të RAP 2019/2020

Monitorimi u krye midis shkurtit dhe dhjetorit 2020. Në pjesën më të madhe të tij, monitorimi fokusohet në zhvillimet përgjatë vitit 2019 dhe gjysmën e parë të vitit 2020. Përjashtim bëjnë disa elementë të treguesve që shqyrtojnë rregullsinë e praktikave të raportimit qeveritar, ku u përfshinë viti 2018 ose viti 2017 si vitet bazë për shkak të cikleve të raportimit të vetë qeverive ose kërkesave të treguesve të veçantë.

Në matjet individuale të treguesve janë përcaktuar periudhat e sakta kohore të matjes, të mbajtura të krahasueshme në të gjithë rajonin, të cilat lejojnë identifikimin e qartë të afateve kohore ndaj të cilave i referohen të gjitha gjetjet në raport. Aty ku situatat kanë ndryshuar deri në kohën e shkrimit të këtij raporti, ato ndryshime do të pasqyrohen në rezultatet në ciklin e ardhshëm dyvjeçar të monitorimit WeBER dhe monitorimi i RAP për 2021/2022.

■ Kufizime të qëllimit dhe qasjes së monitorimit

Fusha e veprimit të monitorimit ishte e kufizuar në strategjitë dhe performancën e qeverisjes qendrore duke përzgjedhur shembuj të institucioneve që ishin të rëndësishme për parimet dhe treguesit specifik. Raporti i monitorimit nuk përfshin të gjithë kornizën e parimeve të SIGMA, por vetëm ato në të cilat interesi i shoqërisë civile dhe vlera e shtuar është më domethënëse në periudhën e para-anëtarësimit. Për më tepër, parimet e zgjedhura nuk janë gjithmonë të mbuluara në mënyrë të gjithanshme, por vetëm në ato çështje specifike të cilat janë përcaktuar nga autorët si më të rëndësishmet duke iu qasur nga perspektiva e monitorimit të shoqërisë civile.

Është e rëndësishme të mbahet parasysh se nuk kishte raporte vlerësimi të SIGMA-s për vitin 2020, rezultatet e të cilit mund të përdoren për këtë cikël monitorimi. Kështu, grupi i hulumtuesve kreu llogaritjet e dhjetë nën-treguesve SIGMA që WeBER-i përdor në fushën e Shërbimit Publik dhe Miradministrit të Burimeve Njerëzore. Bërë në përputhje me metodologjinë e SIGMA-s, rezultatet e këtyre llogaritjeve janë përgjegjësi e vetme e ekipit kërkimor dhe autorëve të raporteve të monitorimit; SIGMA/OECD nuk mund të mbahet përgjegjës për rezultatet e llogaritjeve të tyre.

Së fundmi, megjithë ndryshimet e bëra në indikatorin e ZHKP mbi gjithëpërfshirjen e politikëbërjes (shtjelluar më lart), disa prej parimeve ende trajtohen nga një këndvështrim më shumë i bazuar në perceptim. Kjo është mënyra më e dobishme për të plotësuar qasjen e SIGMA-s pasi monitoron perceptimet e grupeve të rëndësishme interesi, të tilla si nëpunësit publikë dhe OSHC-të. Ky është një përbërës i qëllimshëm i qasjes WeBER dhe ata tregues duhet të shihen si plotësues të vlerësimeve të kryera nga SIGMA për të njëjtat parime. Sidoqoftë, përvoja nga cikli i parë i monitorimit vuri në dukje kufizime në raste të caktuara kur kishte një mbështetje të tepërt në të dhënat e sondazheve të perceptimit. Një tregues mbi gjithëpërfshirjen dhe hapjen e politikëbërjes, i cili më parë ishte bazuar tërësisht në perceptimet e OSHC-ve, u plotësua me hulumtim të dokumentacionit në mënyrë që të kishte një vlerësim më të ekuilibruar, siç u përmend në pjesën për ndryshimet metodologjike. Një ndryshim i tillë solli vlerësim më objektiv, siç mund të shihet në analizën e këtij raporti. Sidoqoftë, elementët e rinj që analizojnë praktikën e konsultimit publik nuk e ndryshuan dukshëm pamjen e krijuar më parë në bazë të perceptimeve të OSHC-ve, kështu që vlerat e treguesit kryesisht kanë ndryshuar nga 0 në 1 mesatarisht. Në vazhdim, WeBER do të konsiderojë ndryshime të tjera nëse do të nevojiten rregullime të ngjashme për treguesit e tjerë për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme të monitorimit, por duke patur parasysh nevojën për të ruajtur një nivel krahasueshmërie midis gjetjeve nga cikle të ndryshme monitorimi.

Përsa i përket shtrirjes gjeografike, monitorimi dhe raporti mbulon gjashtë administratat e rajonit të BP-së, në përputhje me përkufizimin e BE-së për rajonin.¹¹ Për Bosnje-Hercegovinën (BH), WeBER përsëri është përqendruar kryesisht në institucionet e nivelit shtetëror kurdo që analizohen strukturat dhe praktikat e institucioneve. Përfshirjet e vetme për këtë janë treguesit e ofrimit të shërbimeve, ku shërbimet e marra nga administrata përfshijnë ato të ofruara nga nivele më të ulëta të qeverisjes në BH (siç janë njësitë autonome).


I.3 STRUKTURA E RAPORTIT

Raporti ndjek një strukturë standarde të vendosur që në monitorimin bazë të RAP-it, duke e ndarë atë në gjashtë kapituj, që kanë të bëjnë me fushat thelbësore të reformës: 1) korniza strategjike për reformën në administratën publike, 2) zhvillimi dhe koordinimi i politikave, 3) shërbimi publik dhe miradministrimi i burimeve njerëzore, 4) llogaridhënia, 5) ofrimi i shërbimeve dhe 6) miradministrimi i financave publike.

Secili kapitull ndjek një strukturë identike. Fillon me gjendjen e përgjithshme për çdo fushe, e ndjekur nga metodologjia për secilin parim dhe tregues. Më tej jepet një përmbledhje për vlerësimin e secilit tregues, i ndjekur nga një krahasim i rezultateve të vendeve në rajon. Secili kapitull përfundon me një përmbledhje të gjetjeve kryesore për secilën fushë, e ndjekur nga një vlerësim i statusit të rekomandimeve nga cikli i mëparshëm i monitorimit dhe prezantimi i rekomandimeve të reja.

Raporti përfundon me disa vërejtje të përgjithshme mbi rëndësinë e RAP-it në Shqipëri.

¹¹ Paketa e zgjerimit të Komisionit Evropian dhe raportet e progresit mund të gjenden në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/package_en.



KORNIZA STRATEGJIKE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

II.1 TREGUESIT WEBER TË PËRDORUR PËR KUADRIN STRATEGJIK TË REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE VLERAT PËR SHQIPËRINË

P1 I1: Përdorimi i qasjeve pjesëmarrëse në hartimin e dokumenteve strategjike kryesore të RAP-it					
0	1	2	3	4	5
P2_P4 I1: Përfshirja e shoqërisë civile në strukturat e monitorimit dhe koordinimit të RAP					
0	1	2	3	4	5

II.2 GJENDJA E KUADRIT STRATEGJIK TË RAP (KSRAP)

Dokumentet kyçe ekzistuese të kornizës strategjike për RAP në Shqipëri përfshijnë Strategjinë e RAP 2015-2020 – plani i veprimit i së cilës është zgjatuar deri në vitin 2022 – dhe Strategjinë e Miradmnistrimit të Financave Publike (MFP) 2019-2022. Përveç këtyre dokumenteve, masat më të hollësishme të reformës përshkruhen më tej nga dokumente të tjerë të rëndësishëm, të tilla si Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2020, Strategjia Kombëtare Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 dhe Strategjia Ndërsektorale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” 2015-2020.

Procesi i përgjithshëm i koordinimit dhe miradmnistrimit të RAP-it drejtohet nga Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave për RAP (GMIP-RAP), i cili përfshin tetë grupe tematike (politikëbërja, shërbimi civil dhe RAP-i, shërbimet publike, digjitalizimi, antikorrupsioni, decentralizimi, statistikat, zhvillimi rajonal) dhe komitetin drejtues për miradmnistrimin e financave publike.

Qeveria shqiptare krijoi mekanizmin e miradmnistrimit të integruar sektorial/ndërsektorial në shtator 2015 për të udhëhequr dhe monitoruar hartimin e politikave, zbatimin dhe vlerësimin e strategjive dhe për të forcuar koordinimin sektorial dhe të donatorëve nëpërmjet krijimit të grupeve të menaxhimit të integruara të politikave (GMIP) dhe komiteteve drejtuese sektorale (KDS). Struktura e përgjithshme e koordinimit u rishikua në 2018.¹² Aktualisht ekzistojnë pesë GMIP-e (RAP dhe qeverisja e mirë, konkurrenca dhe investimet, punësimi, menaxhimi i integruar i tokës dhe miradmnistrimi i integruar i ujit) dhe pesë KDS (reforma në drejtësi, punët e brendshme, miradmnistrimi i financave publike, ndërlidhja, si dhe klima e mjedisit dhe miradmnistrimi i mbetjeve).

GMIP-et dhe KDS-të janë përgjegjëse për (i) planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave në nivel politik; (ii) monitorimin dhe sigurimin e përmbushjes së objektivave prioritare të reformës; (iii) mbështetjen e koordinimit të politikave sektorale nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët e integritit dhe zhvillimit; (iv) nxitjen e një dialogu gjithëpërfshirës me institutet e pavarura, partnerët zhvillimorë, shoqërinë civile dhe sektorin privat, për të nxitur nisma të përbashkëta në fushat me përparësi të politikave dhe (v) udhëzimin dhe sigurimin e kontributit të bashkëpunimit ndërsektorial në fushat e politikave me përparësi për Komitetin e Planifikimit Strategjik, që është njësia përgjegjëse për të integruar përparësi të ndryshme politikash në procesin e vendimmarrjes së qeverisë qendrore.

GMIP-et dhe KSD-të duhet të rishikojnë, diskutojnë dhe miratojnë projekt-strategjitë, programet kombëtare ndërsektorale, raportet e monitorimit dhe udhëzimet e përbashkëta. Ata mbledhen nën udhëheqjen e zëvendëskryeministrit ose ministrit përgjegjës për politikat specifike të sektorit. Grupet tematike mbledhen nën drejtimin e ministrit përgjegjës, zëvendëskryeministrit ose drejtorit të përgjithshëm. Njësia për Mirëqeverisjen dhe Politikën e Zhvillimit, nën varësinë e Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje në Zyrën e Kryeministrit, shërben si sekretariati i përgjithshëm për koordinimin e politikave të integruara sektorale/ndërsektorale. Në

12 Shumica e GMIP-ve dhe KDS-ve veprojnë gjithashtu si komitete sektorale që monitorojnë zbatimin e fondeve të Instrumentit të Para-Anëtarësimit të Bashkimit Evropian për fushat e tyre specifike të përgjegjësisë. Urdhër i Kryeministrit nr. 157, datë 20.10.2018 “Për masat e marra për të zbatuar qasjen e gjerë sektorale/ndërsektorale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

institucionet përkatëse përgjegjëse janë krijuar sekretariatet teknike për grupet dhe komitetet për koordinimin sektorial/ndërsektorial.

Zëvendës kryeministri drejton GMIP-RAP, ndërsa Departamenti i Administratës Publike (DAP) udhëheq grupin tematik për shërbimin civil dhe RAP. Përsa i përket miradministrimit i financave publike (MFP), ministri (ose zëvendësministri) i Financave dhe Ekonomisë udhëheq komitetin drejtues përkatës që koordinon, monitoron dhe raporton për zbatimin e strategjisë së MFP-së.

Pavarësisht përparimit të bërë drejt krijimit të strukturave koordinuese për zbatimin e reformave, Komisioni Evropian¹³ ka vërejtur mangësi në shkallën e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara në bazë të strategjisë së RAP-it, si dhe në çështje të koordinimit midis niveleve politike dhe teknike. Komisioni e ka theksuar më tej si problematike çështjen e qëndrueshmërisë financiare të strategjisë, financimi i së cilës bazohet kryesisht në donatorë të huaj.

13 Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë 2019, 10-11, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/20190529-albania-report.pdf>.

II.3 ÇFARË MONITORON WEBER-I DHE SI?

Monitorimi i Kornizës Strategjike të Reformës në Administratën Publike bazohet në tre Parime SIGMA në këtë fushë, duke u përqendruar në ekzistencën e agjendave efektive të RAP-it, zbatimin dhe monitorimin e RAP-it, si dhe në ekzistencën e strukturave të miradministrit dhe koordinimit të RAP-it në nivel politik dhe administrativ..

- Parimi 1:** Qeveria ka hartuar dhe miratuar një agjendë të efektshme të reformës së administratës publike që trajton sfidat kryesore;
- Parimi 2:** Reforma e administratës publike zbatohet duke vendosur qëllime të qarta për t'u arritur; caktohen dhe monitorohen rregullisht rezultate të reformës;
- Parimi 4:** Reforma në administratën publike ka struktura të fuqishme dhe funksionale të koordinimit dhe miradministrit si në nivel politik ashtu edhe në atë administrativ, për të drejtuar procesin e hartimit dhe zbatimit të reformës.

Parimet e zgjedhura vlerësohen tërësisht nga pikëpamja e cilësisë së përfshirjes së shoqërisë civile dhe publikut në proceset e zhvillimit të dokumenteve strategjike të RAP-it, dhe në pjesëmarrjen në strukturat e monitorimit dhe koordinimit që duhet të sigurojnë zbatimin e tyre të qëllimshëm. Fokusi te gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja synon të përcaktojë shkallën në të cilën nevojat dhe pikëpamjet e palëve të interesuara përkatëse konsultohen dhe merren në konsideratë kur zhvillohen dhe zbatohen agjendat e reformave.

Për këtë qëllim, u caktuan dy tregues të WeBER-it. I pari përqendrohet në proceset dhe cilësinë e konsultimit gjatë zhvillimit të dokumenteve kryesore strategjike të RAP-it. Për këtë, deri në gjashtë dokumente kryesore strategjike të RAP-it u vlerësuan për secilën administratë të Ballkanit Perëndimor. Dokumentet më gjithëpërfshirëse të RAP-it (strategjitë e RAP-it ose të ngjashme me to) dhe dokumentet e reformës së MFP ishin të detyrueshme të për t'u zgjedhur, ndërsa zgjedhja e dokumenteve të tjera strategjike që mbulojnë fushat e mbetura të RAP-it ishte në varësi të agjendave të RAP-it, aktualisht në zhvillim e sipër. Monitorimi u krye duke kombinuar burimet e të dhënave për të siguruar besueshmërinë e rezultateve, përfshi analizën cilësore të dokumenteve strategjike dhe të dhënave zyrtare që janë në dispozicion të publikut, ose të marra nga institucionet përgjegjëse për RAP-in. Për më tepër, analiza e dokumenteve u vërtetua me rezultatet e intervistave gjysmë të strukturuar me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për RAP-in dhe fokus-grupet me përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët morën pjesë në proceset e konsultimit (atje ku ishte e pamundur të organizoheshin fokus-grupe, ato u zëvendësuan me intervista me përfaqësues të shoqërisë civile). Duke qenë se dokumentet strategjike zakonisht zbatohen për disa vite dhe miratimi ose rishikimi i tyre nuk përkon patjetër me ciklet e monitorimit të WeBER-it, gjetjet nga Monitorimi i RAP 2017/2018 u bartën për dokumente strategjike që nuk qenë rishikuar ose nuk qenë përditësuar në kohën e Monitorimi i WeBER-it.

Monitorimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në zbatimin e RAP-it (në strukturat koordinuese dhe monitoruese të RAP-it) mori parasysh vetëm dokumentet kyçe strategjike të reformës. Qëllimi i kësaj qasjeje ishte të përcaktonte nëse ekzistojnë përpjekje për të ndihmuar më mirë strukturat e monitorimit dhe koordinimit në agjendën e RAP-it në përgjithësi. Sa i përket treguesit të parë, u krye shqyrtimi dhe vlerësimi cilësor i dokumenteve zyrtare që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e këtyre strukturave dhe, për të vërtetuar gjetjet, u përdorën burime të tjera të dhënash.

II.4 REZULTATET E MONITORIMIT TË WEBER

PARIMI 1: QEVERIA KA HARTUAR DHE MIRATUAR NJË AGJENDË TË EFEKTSHME TË REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE QË TRAJTON SFIDAT KRYESORE

Tabela 1. Treguesi WeBER KSRAP P1 I1: Përdorimi i qasjeve pjesëmarrëse në hartimin e dokumenteve strategjike kryesore të RAP

Elemente të treguesit	Rezultatet
Kur hartohet dokumenti (et) bëhen konsultime me shoqërinë civile	0/4
Konsultimet me shoqërinë civile kryhen në një fazë të hershme të zhvillimit të dokumentit (eve)	0/4
Ftesat për pjesëmarrje të shoqërisë civile në konsultime janë të hapura	4/4
Institucionet përgjegjëse janë proaktive për të siguruar që në proces të përfshihen një gamë e gjerë e aktorëve të jashtëm	0/2
Shoqërisë civile i ofrohet informacion i plotë për t'u përgatitur për konsultime	4/4
Komentet dhe kontributet e marra në procesin e konsultimit merren në konsideratë nga organet përgjegjëse shtetërore për zhvillimin e dokumenteve kryesore strategjike të RAP-it	0/4
Organet përgjegjëse shtetërore japin publikisht reagime për trajtimin e komenteve të marra	0/2
Organet përgjegjëse shtetërore përfshihen në dialog të hapur me shoqërinë civile për pyetjet e diskutuara	0/2
Konsultimet në zhvillimin e dokumenteve strategjike të RAP-it janë të hapura për publikun	2/4
Rezultati i përgjithshëm	10/30
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)¹⁴	1

Qëllimi i këtij treguesi ishte të vlerësonte pjesëmarrjen e OSHC-ve në konsultimet e qeverisë për dokumentet strategjike të RAP-it. Pjesëmarrja e OSHC-ve u vlerësua në lidhje me konsultimin e kryer për dokumentet e mëposhtme: (1) Plani i Veprimit i RAP (2018-2022), (2) Strategjia e Miradministrimit të Financave Publike (MFP) 2019-2022, (3) Dokumenti i Politikave Afatgjata për Ofrimin e Shërbimeve me në Qendër Qytetarin nga Administrata Shtetërore në Shqipëri (2016-2025), dhe (4) Strategjia Ndërsëktoriale 'Agjenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020'. Vlerësimi për dokumentet (3) dhe (4) u bazua në ciklin e fundit të monitorimit (2017-2018), ndërsa për dokumentet (1) dhe (2) u bazua në procesin e konsultimit të mbajtur në 2019¹⁵.

Dokumentet (3) dhe (4) u miratuan nëpërmjet një qasjeje më proaktive sesa dokumentet (1) dhe (2), të cilat u miratuan në vitin 2019. Plani i Veprimit për RAP dhe Strategjia e MFP u botuan në portalin e konsultimit publik dhe faqen e institucionit përgjegjës – përkatësisht Departamenti i Administratës Publike dhe ministria e Financave dhe Ekonomisë – dhe OSHC-të u ftuan për të kontribuar nëpërmjet komenteve të tyre; megjithatë, konsultimet virtuale ose fizike nuk kanë qenë të vazhdueshme. Për Strategjinë e MFP-së u zhvillua një takim, por jo për Planin e Veprimit për RAP-in.

¹⁴ Konvertimi i pikëve: 0-5 pikë = 0; 6-10 pikë = 1; 11-15 pikë = 2; 16-20 pikë = 3; 21-25 pikë = 4; 26-30 pikë = 5..

¹⁵ Plani i Veprimit për RAP (2018-2022) u ndryshua në 2019.


Megjithëse dokumentet u botuan në portalin e konsultimit publik, institucionet përgjegjëse për hartimin e dokumenteve nuk kërkuar kontribut në mënyrë aktive nga grupime palësh të interesuara kyçe si sindikata, organizata me fokus barazinë gjinore dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe shoqata të biznesit. Sidoqoftë, institucionet publikuan informacion të plotë për t'i dhënë mundësi publikut për t'u përgatitur për procesin e konsultimit.

Pavarësisht thirrjes për konsultim publik të këtyre dokumenteve strategjike, nuk janë vendosur praktika për të përpunuar komentet dhe rekomandimet e marra nga publiku. Në rastet e proceseve të konsultimit fizik ose virtual, përgjigjet ndaj komenteve të marra jepen menjëherë nga zyrtarët shtetërorë të pranishëm në seancën e konsultimit. Përgjigjet ndaj komenteve të paraqitura nëpërmjet portalit të konsultimit publik ende nuk janë të përfshira, pasi portali nuk përmban asnjë mundësi për të kontrolluar nëse komentet janë marrë parasysh nga institucioni përgjegjës. Për më tepër, zakonisht nuk zhvillohet asnjë konsultë para hartimit të dokumenteve strategjike me OSHC-të.

Në përgjithësi, procesi i konsultimit për dokumentet strategjike të RAP-it nuk ka një qasje proaktive. Institucionet udhëheqëse, pavarësisht përpjekjeve të tyre më të mira, nuk i japin theks të mjaftueshëm procesit të konsultimit me palët e interesuara dhe OSHC-të përkatëse. Procesi është më tepër procedural dhe jo domethënës.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi KSRAP P1 I1: Përdorimi i qasjeve pjesëmarrëse në hartimin e dokumenteve kryesore strategjike të RAP



PARIMI 2: REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE ZBATOHET DUKE VENDOSUR QËLLIME TË QARTA PËR T'U ARRITUR; ÇAKTOHEN DHE MONITOROHEN RREGULLISHT REZULTATE TË REFORMËS

PARIMI 4: REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE KA STRUKTURA TË FUQISHME DHE FUNKSIONALE TË KOORDINIMIT DHE MIRADMINISTRIMIT SI NË NIVEL POLITIK ASHTU EDHE NË ATË ADMINISTRATIV, PËR TË DREJTUAR PROCESIN E HARTIMIT DHE ZBATIMIT TË REFORMËS.

Tabela 2. Treguesi WeBER KSRAP P2 4 I1: Përfshirja e shoqërisë civile në strukturat e monitorimit dhe koordinimit të RAP

Elemente të treguesit	Rezultatet
Strukturat administrative për koordinimin dhe monitorimin e RAP parashikojnë përfshirjen e OSHC-ve	0/2
Strukturat e nivelit politik për koordinimin e RAP parashikojnë përfshirjen e OSHC-ve	2/2
Formati i përfshirjes së OSHC-ve në strukturat administrative për koordinimin dhe monitorimin e RAP-it	0/4
Formati i përfshirjes së OSHC-ve në strukturat politike për koordinimin dhe monitorimin e RAP-it	2/4
Përfshirja e OSHC-ve arrihet bazuar në një proces të hapur konkurrimi	2/4
Takimet e strukturave të koordinimit dhe monitorimit të RAP zhvillohen rregullisht me përfshirjen e OSHC-ve	0/4
Formati i takimeve lejon diskutime, kontribute dhe reagime nga OSHC-të	0/4
OSHC-të konsultohen për masat specifike të financimit të RAP-it	0/2
Rezultati i përgjithshëm	6/26
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)¹⁶	1

Strukturat e koordinimit të RAP-it rregullohen nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 20.10.2018 "Për masat e marra për të zbatuar qasjen e gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar". Urdhri detajon, ndër të tjera, koordinimin ndërinstitucional të nivelit teknik dhe politik për zbatimin e reformave për burimet ujore, klimën dhe mjedisit, konkurrencën, miradministrimin e financave publike, si dhe mirëqeverisjen dhe administratën publike. Ai parashikon pjesëmarrjen e OSHC-ve në strukturat e nivelit politik. Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike e konsideron monitorimin e jashtëm nga OSHC-të si një mjet të vlefshëm, por nuk ka një format të qartë të përfshirjes së OSHC-ve në strukturat administrative për koordinimin dhe monitorimin e RAP-it.

Politika e RAP koordinohet nga GMIP-RAP nëpërmjet tetë grupeve tematike (politikëbërja, reforma e shërbimit civil dhe strategjia e RAP, ofrimi i shërbimeve publike, qeverisja elektronike dhe digjitalizimi, statistikët, anti-korrupsioni, decentralizimi dhe zhvillimi rural). Ai drejtohet nga zëvendës kryeministri dhe anëtarët e saj përfshijnë përfaqësues nga ministritë, nga kabineti i zëvendëskryeministrit dhe kryeministrit, drejtoritë brenda Zyrës së Kryeministrit, DAP, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara. OSHC-të mund të ftohen në takimet GMIP-RAP, por ato duhet të jenë

¹⁶ Konvertimi i pikëve: 0-5 pikë = 0; 6-9 pikë = 1; 10-13 pikë = 2; 14-17 pikë = 3; 18-21 pikë = 4; 22-26 pikë = 5.

anëtare të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC). KKSHC është një organizatë, anëtarët e së cilës përfaqësojnë si qeverinë ashtu edhe OSHC-të. Ato përfshijnë 13 përfaqësues të qeverisë, një përfaqësues nga komuniteti i biznesit dhe 13 përfaqësues të OSHC-ve.¹⁷


Në faqen e internetit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile publikohen thirrje të hapura që OSHC-të të bëhen anëtare të KKSHC. OSHC-të e regjistruara zgjedhin katër përfaqësues në KKSHC nga secila prej tri fushave të mëposhtme (12 OSHC gjithsej): (a) demokracia, sundimi i ligjit dhe integrimi në BE; (b) zhvillimi mjedisor, territorial dhe ekonomik; (c) mirëqenia, shërbimet sociale dhe mbrojtja sociale. Megjithatë, Urdhri i Kryeministrit nuk specifikon numrin e OSHC-ve që mund të ftohen në takimet e GMIP-PAR.

Sekretariati teknik për monitorimin dhe koordinimin e RAP-it përfshin Drejtorinë e Mirëqeverisjes dhe Jetësimit të Prioriteteve (pranë Zyrës së Kryeministrit) dhe DAP-in, por përfshirja e OSHC-ve nuk parashikohet.

Në vitin 2019 u zhvilluan katër takime të nivelit administrativ, ndërsa në vitin 2020 u zhvilluan dy të tilla.¹⁸ Po ashtu, në vitin 2019 u zhvilluan tre takime GMIP-RAP (në nivel politik).¹⁹ Pavarësisht nga dispozitat në Urdhri i Kryeministrit, është mjaft e paqartë natyra e angazhimit të OSHC-ve në strukturat koordinuese të RAP-it në nivel politik. Nuk ka asnjë të dhënë që të japë përshtypjen se ekzistojnë mekanizma të përshtatshëm për të siguruar kontribute domethënëse nga OSHC-të, ndërkohë që OSHC-të që morën pjesë në fokus-grupet për këtë tregues thanë se ato nuk ishin ftuar të merrnin pjesë në takimet përkatëse.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi KSRAP P2 P4 I1: Përfshirja e shoqërisë civile në strukturat e monitorimit dhe koordinimit të RAP-it



¹⁷ Ligji nr. 119/2015 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile", [http://www.amshc.gov.al/web/KKSHC/Ligj_Nr.119-2015_KKSHC-\(AL\).pdf](http://www.amshc.gov.al/web/KKSHC/Ligj_Nr.119-2015_KKSHC-(AL).pdf).

¹⁸ Informacion i siguruar nga Departamenti i Administratës Publike nëpërmjet një kërkesë për informacionin, 26 nëntor 2020.

¹⁹ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Annual Report on the Implementation of the IPA II Assistance Program under Direct and Indirect Management (Tirana, 2020), 33, <http://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/05/IPA-II-Annual-Implementation-Report-2019-ALBANIA.pdf>.

II.5 PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE: KUADRI STRATEGJIK I RAP

Qasja e qeverisë ndaj hartimit dhe diskutimit të strategjisë së reformës në administratën publike është mjaft hermetike. Ndërkohë që OSHC-të nuk janë të përfshira gjatë fazës së hartimit të dokumenteve, përfshirja e tyre në forume të tjera të koordinimit të politikave të RAP-it është jashtëzakonisht e kufizuar. Urdhri i Kryeministrit përshkruan detyrat e grupeve të integruara të miradministrit të politikave dhe të komiteteve drejtuese sektoriale, por nuk parashikon pjesëmarrje nga OSHC-të gjatë hartimit të dokumenteve të politikave strategjike, ose në konsultime në nivel administrativ. Kjo qasje i ka përjashtuar OSHC-të nga procesi i vendimmarrjes dhe – duke mos publikuar procesverbale ose përmbledhje të vendimeve të marra në takimet e GMIP-së dhe KDS-së – ka vënë në pikëpyetje efektshmërinë e planifikimit dhe të zbatimit të reformave të mirëqeverisjes dhe administratës publike.

Megjithëse pjesëmarrja e OSHC-ve në takimet e nivelit politik të koordinimit nëpërmjet ftesave të posaçme është një hap pozitiv drejt përfshirjes më të madhe të tyre, mungesa e dispozitave për përfshirjen dhe kontributin e OSHC-ve nënkupton që kjo masë është relativisht formale dhe me pak ndikim në politikëbërje.

Gjithashtu, përdorimi i portalit të konsultimit publik, pa takime fizike ose virtuale për të diskutuar dokumentet strategjike të RAP-it, është i pamjaftueshëm. Ndërsa parashtrimi i komenteve nëpërmjet portalit të konsultimit është i mundur, nuk ka siguri që komentet shqyrtohen nga institucionet publike, pasi nuk ka asnjë mundësi për të kontrolluar nëse ato janë shqyrtuar dhe nuk ekziston një sistem për t'i përpunuar ato.

OSHC-të mund të ofrojnë një mori informacionesh, veçanërisht për ofrimin e shërbimeve, anti-korrupsionin dhe reformën për sundimin e ligjit. Mospërfillja e ekspertizës së tyre është e dëmshme për suksesin dhe ndikimin e përgjithshëm shoqëror të strategjive. Angazhimi më i madh midis qeverisë dhe OSHC-ve pasuron debatin për RAP-in, duke prodhuar kështu dokumente politikash të bazuara në të dhëna studimore. Anasjelltas, nëse shoqëria civile vazhdon të jetë në kufijtë e procesit, agjenda e reformave do të vazhdojë të perceptohet si një proces i drejtuar ekskluzivisht nga qeveria dhe i mbështetur nga donatorët e huaj. Për më tepër, pa pjesëmarrje kuptimplotë të shoqërisë civile, procesi rrezikon legjitimitetin e tij, i cili është thelbësor për qëndrueshmërinë e agjendës reformuese.

II.8 REKOMANDIMET PËR KORNIZËN STRATEGJIKE TË RAP


Gjurmimi i rekomandimeve nga Monitorimi i RAP 2017/2108

Rekomandimi	Statusi	Koment
Për të promovuar pjesëmarrje transparente dhe gjithëpërfshirëse, institucionet përgjegjëse duhet të kryejnë konsultime të hershme dhe të përfshijnë në faza më të hershme palët e interesuara në procesin e zhvillimit të politikave, kur ka vend për të ndikuar rezultatin e politikave.	I pazbatuar	Asnjë konsultë me shoqërinë civile nuk është kryer në një fazë të hershme të zhvillimit të dokumenteve strategjike.
Për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive, institucionet përgjegjëse duhet publikojnë raporte konsultimi, që identifikojnë qartë pikat kryesore të ngritura, reagimet e marra, shqyrtimin e reagimeve dhe planet e ardhshme (nëse ka) për angazhim të mëtejshëm. Ky informacion normalisht duhet të publikohet para ose krahas ndërmarrjes së çdo veprimi të mëtejshëm.	I pazbatuar	Institucionet përgjegjëse nuk kanë publikuar raporte konsultimi që identifikojnë qartë pikat kryesore të ngritura, reagimet e marra, shqyrtimin e reagimeve dhe planet e ardhshme për angazhim të mëtejshëm.
Institucionet përgjegjëse duhet të sigurojnë që proceset e konsultimit të kapin gamën e plotë të palëve të interesuara të prekura dhe duhet të marrin në konsideratë konsultime me grupe të veçanta kur kjo është e mundur.	I pazbatuar	Nuk ka ndryshime krahasuar me ciklin e fundit të monitorimit. Procesi i konsultimit për dokumentet strategjike të RAP përfshin disa nga palët e interesuara të përfshira në metodologji, por jo gamën e plotë.
Institucionet përgjegjëse duhet të përdorin plotësisht portalin e-konsultimi, konsultimipublik.gov.al.	I pazbatuar	Portali nuk përmban mundësi për të lehtësuar gjurmimin e projekt dokumenteve të dorëzuara, si dhe për t'u regjistruar dhe për t'u përgjigjur rekomandimeve.
Institucionet përgjegjëse duhet t'i kushtojnë vëmendjen e duhur ndërtimit të kapaciteteve në administratën publike për përfshirjen e qenësishme të grupeve të interesit.	Zbatuar pjesërisht	Procesi RIA, i cili përfshin konsultimet me grupet e interesit, është bërë pjesë e procesit legjislativ.
Institucionet përgjegjëse duhet të ruajnë kujtesën e tyre institucionale. Meqenëse ky është një proces me kosto relativisht të ulët dhe efikas, ato duhet të shfrytëzojnë arkivimin në internet.	I pazbatuar	Arkivat në internet mund të gjenden vetëm për ministrinë e Mbrojtjes.
Në shqyrtimin e bërë ndaj kornizës rregulluese GMIP-RAP, Njësia për Mirëqeverisje dhe Zhvillimin e Politikave pranë ZKM duhet të sigurojnë pjesëmarrje të përshtatshme dhe të qëndrueshme të shoqërisë civile si në nivel politik ashtu edhe në atë teknik.	I pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.
Plani Vjetor i Punës i takimeve të GMIP-RAP duhet të publikohet në faqen e ZKM-së.	I pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.
Pas çdo takimi të GMIP-RAP, ZKM duhet të publikojë në faqen e internetit një përmbledhje ekzekutive të procesverbalit dhe përfundimet kryesore.	I pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.

Rekomandimet e Monitorimit të RAP 2019/2020

Rekomandimet për monitorimin e 2019/2020 nuk ndryshojnë thellësisht nga ato të ciklit të mëparshëm të monitorimit. Pothuajse të gjitha rekomandimet e mëparshme janë ende për t'u zbatuar. Rekomandimet e mëposhtme bazohen në të mëparshmet dhe evidentojnë çështjet kryesore të pjesëmarrjes së OSHC-ve që duhen trajtuar.

1. OSHC-të duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në takimet nivelit politik (GMIP) dhe teknike (grup tematik) për reformën e administratës publike. Ato duhet të jenë në gjendje të japin rekomandimet e tyre në diskutimet e politikave në takime të tilla pa patur pushtet vendimmarrës.
2. Pjesëmarrja e OSHC-ve nuk duhet të kufizohet vetëm tek anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile; ajo duhet të jetë e hapur për të gjitha OSHC-të e interesuara.
3. Plani vjetor i punës, agjendat dhe procesverbalet e takimeve të GMIP-së dhe sekretariatit teknik duhet të publikohen.
4. Për të promovuar pjesëmarrje transparente dhe gjithëpërfshirëse, institucionet përgjegjëse duhet të kryejnë konsultime të hershme dhe të përfshijnë – midis palëve të tjera të interesuara – sindikatat, organizatat që mbrojnë barazinë gjinore dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe shoqatat e biznesit, që në fazat e hershme të procesit të zhvillimit të politikave.
5. Për të inkurajuar pjesëmarrjen e publikut dhe për të dëshmuar transparencë në procesin e vendimmarrjes, institucionet përgjegjëse duhet të publikojnë raporte konsultimi që identifikojnë qartë temat kryesore të diskutimeve, komentet dhe rekomandimet e marra, dhe vendimet e tyre për kontributet e marra.



. ZHVILLIMI DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE

III.1 TREGUESIT WEBER TË PËRDORUR PËR ZHVILLIMIN DHE KOORDINIMIN E POLITIKAVE DHE VLERAT PËR SHQIPËRINË

P5 I1: Disponueshmëria e informacionit për publikun mbi performancën e qeverisë					
0	1	2	3	4	5
P5 I2: Perceptimi i shoqërisë civile për ndjekjen dhe arritjen nga qeveria e të saj objektivave të planifikuara					
0	1	2	3	4	5
P6 I1: Transparenca e vendimmarrjes së qeverisë					
0	1	2	3	4	5
P10 I1: Përdorimi i të dhënave studimore të krijuara nga institucione kërkimore, institute të pavarura dhe të OSHC-ve në zhvillimin e politikave					
0	1	2	3	4	5
P11 I1: Perceptimi i shoqërisë civile dhe shkalla e përfshirjes në politikëbërje					
0	1	2	3	4	5

■ Gjendja e Zhvillimit dhe Koordinimit të Politikave (ZHKP)

Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave qeveritare rregullohet nga legjislacioni për funksionimin e Këshillit të Ministrave.²⁰ Ai ngarkon Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave të koordinojë procesin e politikëbërjes në bashkëpunim me njësitë e tjera brenda Zyrës së Kryeministrit dhe me ministritë e linjës.

Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë që propozimet e politikave të jenë në përputhje me përparësitë e qeverisë dhe të jenë të koordinuara me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE).²¹ Projekt-dokumentet shpërndahen nëpërmjet platformës së qeverisë e-akte, ku ministritë përkatëse dhe institucionet e tjera qeveritare mund të komentojnë për projektaktet. Ministria e Drejtësisë dhe ministria përgjegjëse për anëtarësimin në BE japin komente për procesin e hartimit të ligjit dhe përafrimin e dokumenteve me legjislacionin e BE-së. Ndryshimet e fundit në vendimin e Këshillit të Ministrave – miratuar në 2018 – shtuan kërkesën për të përfshirë metodologjinë e vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA) në procesin legjislativ. Përkundër kësaj dispozite, ka përjashtime të gjëra nga kjo dispozitë, të cilat përfshijnë, ndër të tjera, projekt-aktet në lidhje me informacionin e klasifikuar, sigurinë kombëtare, marrëdhëniet ndërkombëtare, taksat dhe tatimet, si dhe çështjet e buxhetit.²²

Legjislacioni në fuqi ngarkon sekretarin e përgjithshëm të Këshillit të Ministrave me koordinimin e politikës qeveritare. Sidoqoftë, njësia përgjegjëse për koordinimin dhe hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) ishte Njësia e Planifikimit dhe Zhvillimit Strategjik, pjesë e Departamentit të Zhvillimit, Financimit dhe Ndihmës së Huaj pranë Zyrës së Kryeministrit²³, ndërsa koordinimi i politikave dhe strategjive të nivelit qendror, si dhe hartimi dhe mbarëvajtja e programeve kombëtare të zhvillimit bëhet nga Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje (DZHM).²⁴ Kjo drejtori funksionon gjithashtu si sekretariati i Komitetit të Planifikimit Strategjik – një organ ndërminstrior i kryesuar nga kryeministri – i cili përcakton dhe miraton përparësitë e qeverisë, kornizën për planifikimin e buxhetit afatmesëm dhe siguron koordinimin strategjik të ndihmës së jashtme me partnerët e zhvillimit të Shqipërisë.²⁵

20 Ligji nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.8.2003 "Për miratimin e rregullave të procedurave të Këshillit të Ministrave".

21 Kapitulli II, paragrafi 7 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.8.2003 (i ndryshuar), <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2003/08/28/584>.

22 Kapitulli VI, paragrafi 45 dhe 45/1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.8.2003 (i ndryshuar).

23 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, 11, <http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/278-strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim>.

24 Informacioni i siguruar nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes përmes postës elektronike në 29 qershor 2021.

25 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, 195-196. Informacioni i siguruar nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes.

Sipas raportit të SIGMA-s të vitit 2019 për Shqipërinë, 75% e angazhimeve legislative në PKIE u përfshinë në Programin e Përgjithshëm Analitik të Qeverisë, i cili përfshin nismat legislative kyçe gjatë një viti.²⁶ Për më tepër, SIGMA vëren se pavarësisht krijimit të platformës e-Akte, koordinimi ndërinstitucional mbetet problem duke qenë se rolet dhe përgjegjësitë e njësive në Zyrën e Kryeministrit dhe rregullimi i koordinimit të tyre të brendshëm nuk janë të përcaktuara qartë.²⁷ Për të përmirësuar bashkërendimin e politikave, në prill 2020, Këshilli i Ministrave miratoi një vendim për krijimin e bazës së të dhënave të qeverisë qendrore për Sistemin e Informacionit të Sistemit të Integruar të Planifikimit (IPSIS).²⁸

Përveç sfidave të koordinimit, transparenca e procesit të vendimmarrjes së qeverisë qendrore mbetet e vështirë për t'u arritur. Sipas Nenit 17, Pika 2 e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave, diskutimet në mbledhjet e Këshillit të Ministrave janë konfidenciale. Megjithatë, Sekretari i Përgjithshëm duhet të publikojë një raport gjithëpërfshirës për takimet, sipas parashikimeve të Nenit 22 të të njëjtit ligj, por ato raporte vazhdojnë të mos publikohen.²⁹

Pas miratimit të Ligjit për Konsultimet Publike, përpjekjet për ta bërë më gjithëpërfshirës procesin e politikëbërjes së qeverisë qendrore kanë ngecur. Raporti i KE-së për vitin 2020 për Shqipërinë vëren se, megjithëse personeli i ministrave të linjës ka marrë trajnim shtesë për konsultimet publike dhe është krijuar një portal funksional për to, përdorimi i portalit mbetet i kufizuar.³⁰ Organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri argumentojnë se procesi i konsultimit publik priret të jetë më tepër formal, sesa pjesë e një përpjekjeje të mirëfilltë për të kërkuar mendime dhe rekomandime.³¹

III.2 ÇFARË MONITORON WEBER DHE SI?

Në fushën e Zhvillimit dhe Koordinimit të Politikave, monitorimi i WeBER-it kryhet kundrejt katër Parimeve SIGMA:

- Parimi 5:** Monitorimi i rregullt i performancës së qeverisë mundëson shqyrtimin nga publiku dhe mbështet qeverinë për arritjen e objektivave të saj;
- Parimi 6:** Vendimet e qeverisë përgatiten në mënyrë transparente dhe janë të bazuara në gjykimin profesional të administratës; sigurohet përputhshmëria ligjore e vendimeve;
- Parimi 10:** Procesi i hartimit të politikave dhe i ligjeve është i bazuar në të dhëna studimore, si dhe në të gjitha ministratë përdoret vazhdimisht vlerësimi i ndikimit të tyre;
- Parimi 11:** Politikat dhe legjislacioni janë hartuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, që mundëson pjesëmarrjen aktive të shoqërisë dhe lejon koordinimin e këndvështrimeve të ndryshme brenda qeverisë;

Në botimin e dytë të monitorimit të RAP, janë përdorur pesë tregues WeBER për analizën e Zhvillimit dhe Koordinimit të Politikave. Krahësuar me Monitorimin e RAP 2017/2018, këtë herë Parimi 12 i SIGMA-s nuk ishte pjesë e monitorimit dhe për pasojë treguesi përkatës nuk u mat.³² Vendimi për një ndryshim të tillë u arrit në fillim të këtij cikli monitorimi si rezultat i diskutimit të brendshëm për përvojën e mësuar nga ushtrimi i mëparshëm i monitorimit, ku u arrit përfundimi se monitorimi i këtij parimi nuk përbën një shtesë të konsiderueshme në vlerat kryesore të monitorimit WeBER. D.m.th., që nuk përfaqësonte një çështje shqetësuese për shoqërinë civile dhe publikun në rajon.

26 OECD, Raporti i Monitorimit: Shqipëria (Paris: Botimet e OECD, 2019), 15, <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2019-Albania.pdf>.

27 OECD, Raport Monitorimi: Shqipëri, 10.

28 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.290, datë 11.4.2020, <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/04/11/290>.

29 Ligji nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave", <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2003/01/30/9000>.

30 Raporti i Komisionit të BE 2020 për Shqipërinë, 15, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf.

31 Blerjana Bino, Redion Qirjazi dhe Alban Dafa, Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrjen në Shqipëri (Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2020), 34, <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2020/03/CSO-Participation-in-Decision-Making-in-Albania.pdf>.

32 SIGMA Parimi 12: Legjislacioni është i qëndrueshëm në strukturë, stil dhe gjuhë; kriteret për hartimin e ligjeve zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha ministratë; legjislacioni bëhet i disponueshëm për publikun. Treguesi WeBER i përdorur për monitorimin e këtij parimi në 2017/2018: Perceptimi nga shoqëria civile e disponueshmërisë dhe marrjes së legjislacionit dhe materialeve përkatës shpjeguese.

Treguesi i parë mat shkallën e hapjes dhe disponueshmërisë së informacionit në lidhje me performancën e qeverisë për publikun, nëpërmjet analizës së faqeve në internet, nëpërmjet të cilave qeveria komunikon aktivitetet e saj dhe boton raporte. Informacioni me shkrim i publikuar nga qeveria përfshin njoftimet për shtyp dhe publikimin në internet të raporteve vjetore (ose gjysmë-vjetore). Matja mbulon një periudhë prej dy ciklesh raportimi vjetor, përveç njoftimeve për shtyp, të cilat vlerësohen për një periudhë prej një viti (për shkak të shpeshtësisë së botimit të tyre). Aspekte të tjera të informacionit të analizuar rreth performancës së qeverisë përfshijnë kuptueshmërinë e tij, përdorimin e informacionit sasior dhe cilësor, praninë e vlerësimeve/ përshkrimeve të rezultateve konkrete, disponueshmërinë e të dhënave në forma të përpunueshme (open data)³³ dhe sipas gjinisë, si edhe disponueshmërinë e raporteve për dokumentet kyçe qeveritare të planifikimit.

Treguesi i dytë mat se si shoqëria civile e percepton planifikimin, monitorimin dhe raportimin e qeverisë për punën dhe për objektivat që i ka premtuar publikut. Për të shqyrtuar perceptimet, u ndërmor një studim i organizatave të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor duke përdorur një platformë anketimi në internet, në periudhën midis gjysmës së dytë të qershorit dhe fillimit të gushtit 2020.³⁴ Pyetësi uniform me 28 pyetje u përdor në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke siguruar një qasje të barabartë në kryerjen e sondazhit. Ai u shpërnda në gjuhët përkatëse nëpërmjet rrjeteve dhe platformave ekzistuese të organizatave të shoqërisë civile me baza të gjera të dhënash kontakti, por edhe nëpërmjet pikave të kontaktit të centralizuara, si zyrat qeveritare të ngarkuara për bashkëpunim me shoqërinë civile. Për të siguruar që sondazhi të synonte sa më shumë organizata sa i përket llojit të tyre, shpërndarjes gjeografike dhe zonave të veprimtarisë, duke kontribuar kështu një përfaqësim sa më të gjerë, atje ku qe e nevojshme u bë një nxitje shtesë për të rritur numrin e të anketuarve. Një fokus-grup me OSHC-të i shërbeu qëllimit të plotësimit të gjetjeve të studimit me informacione cilësore.

Treguesi i tretë mat transparencën e vendimmarrjes nga qeveria (sa i takon Këshillit të Ministrave), duke kombinuar të dhënat e sondazhit për perceptimet e shoqërisë civile me analizën e faqeve përkatëse qeveritare në rrjet. Përveç botimit të informacionit për vendimet e qeverisë, analiza e faqes në internet merr në konsideratë tërësinë e informacionit, qasjen miqësore ndaj qytetarëve, afatet kohore dhe qëndrueshmërinë. Monitorimi u bë për secilën seancë qeveritare në periudhën e gjashtë muajve - tre muajt e fundit në vitin kalendarik që paraprind monitorimin (2019) dhe tre muajt e parë në vitin e monitorimit (2020), me përjashtim të afateve kohore që maten ndaj të gjithë seancave të qeverisë prej tre muaj nga fillimi i monitorimit (afërsisht nga fillimi i marsit deri në fillim të qershorit 2020).

Treguesi i katërt mat nëse institucionet qeveritare ftojnë shoqërinë civile të përgatisë dokumente të bazuara në të dhëna studimore dhe nëse të dhënat e prodhuara nga OSHC-të merren në konsideratë dhe përdoren në procesin e zhvillimit të politikave. Përsëri, matja kombinon analizën e dokumenteve zyrtare dhe një sondazh të të dhënave të perceptimit të shoqërisë civile. Në lidhje me të parën, është analizuar shpeshtia e referimit të gjetjeve të bazuara në studime të OSHC-ve, për politikat zyrtare dhe dokumentet strategjike, për dokumentet e politikave, si dhe për analizat e politikave ex-ante (para miratimit) dhe ex-post (pas zbatimit) dhe vlerësimet e ndikimit për tre fusha të politikave publike të përzgjedhura.³⁵

Së fundmi, treguesi i pestë, që përqendrohet në cilësinë e përfshirjes së publikut në politikëbërje nëpërmjet konsultimeve publike, u ndryshua në këtë cikël monitorimi për të përfshirë jo vetëm perceptimet e OSHC-ve të mbledhura nga kryerja e sondazhit në internet, por edhe të dhënat cilësore shtesë nëpërmjet analizës së një kampioni të konsultimeve publike si dhe vlerësimit të portaleve qeveritare në rrjet të përdorura për konsultimet publike. Më saktësisht, në këtë shtesë të monitorimit, treguesi u fuqizua me shtimin e analizës cilësore të shtrirjes dhe ndikimit të konsultimeve publike për dokumentet e politikave dhe legjislacionin në një periudhë prej gjashtë muajsh (gjysma e dytë e vitit 2019), disponueshmërisë dhe cilësisë së raportimit për konsultimet publike, funksionimi i portaleve të konsultimit publik dhe proaktivitetit të informimit nga institucionet përgjegjëse.

33 Formati open data nënkupton që të dhënat ruhen në një format që lejon përpunimin e tyre analitik nëpërmjet programeve të ndryshme kompjuterike. Shembuj të këtij formati përfshijnë, p.sh. .xls, .csv, .txt.

34 Anketa e OSHC-ve u administrua përmes një pyetësi anonim, në internet. Në Shqipëri, sondazhi u krye në periudhën 24 qershor – 29 korrik 2020. Metoda e mbledhjes së të dhënave përfshinte CASI (vetë-intervistim i ndihmuar nga kompjuteri). Kampioni i sondazhit ishte N = 81.

35 Fushat e politikave ku një numër i konsiderueshëm i OSHC-ve punon në mënyrë aktive. Për Shqipërinë, tre fushat e politikave të zgjedhura janë anti-korrupsioni, anti-diskriminimi dhe mbrojtja sociale.

III.3 REZULTATET E MONITORIMIT TË WEBER-IT

PARIMI 5: MONITORIMI I RREGULLT I PERFORMANCËS SË QEVERISË MUNDËSON SHQYRTIMIN NGA PUBLIKU DHE MBËSHTET QEVERINË NË ARRITJEN E OBJEKTIVAVE TË SAJ

Tabela 3. Treguesi WeBER ZHKP P5 I1: Disponueshmëria publike e informacionit për performancën e qeverisë

Elemente të treguesit	Rezultate
Qeveria boton rregullisht informacion me shkrim për aktivitetet e saj	0/4
Informacioni i dhënë nga qeveria për aktivitetet e saj është shkruar në mënyrë të kuptueshme	0/2
Informacioni i dhënë nga qeveria është mjaftueshëm i detajuar, duke përfshirë si të dhënat sasiore ashtu dhe informacion dhe vlerësime cilësore	0/4
Informacioni i dhënë nga qeveria përfshin vlerësime të arritjeve të rezultateve konkrete	0/4
Informacioni i dhënë nga qeveria për aktivitetet dhe rezultatet e saj është i qasshëm në formate të dhënash të përpunueshme (open data)	0/2
Informacioni i dhënë nga qeveria për aktivitetet dhe rezultatet e saj përmban të dhëna të ndara sipas gjinisë	0/2
Raportet për strategjitë dhe planet e qeverisë të cilat janë në dispozicion në internet	0/2
Pikët	0/20
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)³⁶	0

Për të matur shkallën e hapjes dhe disponueshmërisë së informacionit për performancën e qeverisë qendrore, ne kemi shqyrtuar njoftimet për shtyp dhe raportet për dokumentet kryesore të planifikimit të qeverisë. Dokumentet, raportet e zbatimit të të cilave u kërkuan, përfshijnë Programin e Qeverisë (PQ) për 2017-2021³⁷, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020³⁸, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2018-2020³⁹ dhe Programin Buxhetor Afatmesëm (PFA) 2018-2020⁴⁰.

Zyra e Kryeministrit (ZKM) nxjerr rregullisht njoftime për shtyp për nismat e qeverisë të cilat publikohen në faqen e internetit. Për më tepër, kryeministri gjithashtu përdor llogaritë në Facebook dhe Twitter për të shpërndarë filmime të shkurtra për punën e qeverisë. Përmbajtja e tyre ndryshon, por mund të klasifikohen përafërsisht në tre kategori: (1) komunikim javor, ndonjëherë edhe ditor, për zbatimin e projekteve qeveritare; (2) komunikim i ligjeve të ndryshme, ose nismave qeveritare (më shumë të përqendruara në digjitalizim) që janë miratuar; (3) shfaqje publike në biseda, konferenca shtypi apo diskutime në seancat plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

Pavarësisht informacionit të rëndësishëm të shpërndarë nga kryeministri, është e pamundur të vlerësohet puna e qeverisë bazuar vetëm në njoftimet për shtyp, deklaratat të kryeministrit dhe narrativës së shpërndarë nëpërmjet kanaleve zyrtare të komunikimit publik. Njoftimet për shtyp, megjithëse informuese, përfshijnë

36 Konvertimi i pikëve: 0-4 pikë = 0; 5-8 pikë = 1; 9-11 pikë = 2; 12-14 pikë = 3; 15-17 pikë = 4; 18-20 pikë = 5.

37 Këshilli i Ministrave, Programi i Qeverisë 2017-2021, http://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Programi_i_Qeverise_Shqiptare-1.pdf.

38 Këshilli i Ministrave, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, https://www.mod.gov.al/images/PDF/strategji2016/SKZHI_FINAL_QBZ.pdf.

39 Këshilli i Ministrave, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2018-2020, <http://integrimi-ne-be.punete.përrjashtim.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/PKIE-2018-2020.pdf>.

40 Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Programi Buxhetor Afatmesëm 2018-2020, https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Dokumenti_i_PBA_2018-2020_Lrishikuar.pdf.


përmbledhje ose deklarata të shkurtra nga kryeministri ose nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Ministrave. Në mënyrë të ngjashme, komunikimi nëpërmjet faqeve të kryeministrit në mediat sociale synon të theksojë më tepër sukseset e qeverisë sesa dështimet e saj.

Raportet zyrtare për zbatimin e PQ-së për 2017-2021, që është pa dyshim metoda më e rëndësishme për të matur përparimin e qeverisë, nuk publikohen.⁴¹ Për më tepër, nuk ka raporte qeveritare për zbatimin e SKZHI 2015-2020 dhe PKIE 2018-2020. Nga katër strategjitë dhe planet e qeverisë të vlerësuara, raporte mund të gjenden vetëm për PBA 2018-2020. Për 2018 dhe 2019, ka raporte 4-mujore, 8-mujore dhe të fundvitit për secilin institucion të qeverisë qendrore. Raportet e PBA-së gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë, si institucioni kyç që koordinon politikën buxhetore. Pjesa tjetër e raporteve duhet të gjenden në faqen e internetit të ZKM-së (për PQ dhe SKZHI) ose në ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (për PKIE).

Mungesa e raporteve të botuara për strategjitë dhe planet kyçe të qeverisë është tregues i fortë se objektivat e përshkruara në dokumente të tilla nuk përdoren nga qeveria si referenca për të vlerësuar progresin drejt realizimit të tyre.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi ZHKP P5 I1: Disponueshmëria e informacionit për performancën e qeverisë për publikun



41 PQ për 2017-2021 përshkruan objektivat e qeverisë në afro tre fusha kryesore: (1) rritja ekonomike, (2) shërbimet publike dhe sundimi i ligjit dhe (3) integrimi evropian.


Tabela 4. Treguesi WeBER ZHKP P5 I2: Perceptimi i shoqërisë civile për ndjekjen dhe arritjen prej qeverisë të objektivave të planifikuara prej saj

Elemente të treguesit	Rezultatet
OSHC-të i konsiderojnë dokumentet zyrtare të planifikimit të qeverisë si të rëndësishme për zhvillimet faktike në fushat individuale të politikës	0/2
OSHC-të konsiderojnë që qeveria i raporton rregullisht publikut për progresin lidhur me përmbushjen e objektivave të caktuara	0/4
OSHC-të konsiderojnë që strategjitë zyrtare përcaktojnë veprimet e qeverisë ose ministrive në fusha specifike të politikave	1/2
OSHC-të konsiderojnë që ministrat publikojnë rregullisht raporte monitorimi për strategjitë e tyre sektoriale	0/4
OSHC-të konsiderojnë se përparësitë e pranimit në BE janë integruar në mënyrë të përshtatshme në dokumentet e planifikimit të qeverisë	0/2
OSHC-të konsiderojnë që raportet e qeverisë përfshijnë përditësim të përshtatshme të progresit lidhur me përparësitë e përcaktuara për pranim në BE	0/2
Pikët	1/16
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)⁴²	0

Ky tregues përqendrohet në perceptimet e OSHC-ve për disponueshmërinë e raportimit të qeverisë për progresin e bërë lidhur me planin e saj të punës, lidhjen midis planeve të qeverisë dhe politikave faktike që zbatohen, dhe përfshirjen e përparësive të integritit në BE në planet e qeverisë. Kampioni përbëhej nga gjithsej 81 të anketuar nga OSHC-të dhe baza (numri i të anketuarve që u përgjigjën) për këto pyetje ishte 70. Përgjigjet u matën nga niveli i dakordësisë me deklaratat specifike.

Përafërsisht 11% e të anketuarve pohojnë se progresi në objektivat e planit të punës raportohet rregullisht nga qeveria. Ekziston një perceptim pak më pozitiv në lidhje me raportet e monitorimit të strategjive sektoriale të publikuara nga ministri të ndryshme: 15.7% e të anketuarve pohojnë se ministrat publikojnë raporte të tilla. Lidhur me përfshirjen e përditësimeve të progresit lidhur me përparësitë e pranimit në BE në raportet qeveritare, vetëm 20% konfirmojnë që ato janë përfshirë në mënyrë të përshtatshme.


Grafiku 1. Perceptimet e OSHC-ve për raportimin e zbatimin e planit të punës së qeverisë.



42 Konvertimi i pikëve: 0-3 pikë = 0; 4-5 pikë = 1; 6-7 pikë = 2; 8-10 pikë = 3; 11-13 pikë = 4; 14-16 pikë = 5

Ndërsa vetëm 13% e të anketuarve konsiderojnë se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis planit të punës të qeverisë shqiptare dhe zhvillimeve faktike të fushave të politikave, 30% thonë se në fusha të caktuara politikash, veprimi i qeverisë ose ministrive përcaktohet vërtet nga strategjitë zyrtare. Për më tepër, 25.8% konsiderojnë se planet e qeverisë, në fusha të caktuara politikash, përfshijnë në mënyrë të përshtatshme përparësitë e pranimi në BE.

Grafiku 2. Perceptimet e OSHC-ve për përfshirjen e përparësive të pranimi në BE në planet e punës dhe lidhjen midis planeve të punës së qeverisë dhe zbatimit të politikave.




Në tërësi, niveli i perceptimit pozitiv prej OSHC-ve se puna e qeverisë udhëhiqet nga strategjitë zyrtare ndryshon nga shumë i ulët (11%) në të ulët (30%).

Megjithëse nuk ka dallime të rëndësishme midis dy cikleve të monitorimit, perceptimet e OSHC-ve janë përkeqësuar në krahasim me ciklin e monitorimit 2017/2018. Rënia është e dukshme në të gjitha pyetjet që janë pjesë e këtij treguesi. Në lidhje me përafrimin e politikave qeveritare me planet e punës, ka një rënie prej 15.7% të perceptimit pozitiv; në çështjen e përcaktimit të veprimeve të qeverisë në fusha specifike nga strategjitë zyrtare, ka një rënie prej 4.1%; në çështjen e raportimit të qeverisë për progresin lidhur me përbushjen e objektivave të planit të punës, ka një rënie prej 6.2%. Edhe niveli i perceptimit pozitiv i OSHC-ve për përfshirjen e përparësive të pranimi në BE ka pësuar një rënie të ndjeshme: 11.4% në rastin e përfshirjes së përparësive të pranimi në planet e qeverisë dhe 10.8% rënie në rastin e përfshirjes së përditësimit të progresit drejt BE-së në raportet qeveritare.

Megenëse nuk ka raporte qeveritare për shumicën e strategjive dhe planeve tërësore të qeverisë, ka të ngjarë që perceptimi pozitiv i një pjese të OSHC-ve të anketuara ndikohet nga angazhimi dhe bashkëpunimi i tyre specifik bazuar në projekte me institucionet e qeverisë qendrore.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi ZHKP P5 I2: Perceptimi i shoqërisë civile lidhur me ndjekjen dhe arritjen nga qeveria të objektivave të planifikuara prej saj



PARIMI 6: VENDIMET E QEVERISË PËRGATITEN NË MËNYRË TRANSPARENTE DHE BAZUAR NË GJYKIMIN PROFESIONAL TË ADMINISTRATËS; SIGUROHET PËRPUTHSHMËRIA LIGJORE E VENDIMEVE

Tabela 5. Treguesi WeBER ZHKP P6 I1: Transparenca e vendimarrjes së qeverisë

Elementet e treguesit	Rezultatet
OSHC-të konsiderojnë që vendimarrja e qeverisë është përgjithësisht transparente	0/2
OSHC-të i konsiderojnë të përshtatshme përjashtimet nga rregullat e publikimit të vendimeve të qeverisë	0/2
Qeveria vë në dispozicion për publikun dokumentet e mbledhjeve të saj	0/4
Qeveria i komunikon vendimet e saj në mënyrë lehtësisht të kuptueshme për qytetarët	2/4
Qeveria i publikon dokumentet e miratuara në kohën e duhur	2/4
Pikët	4/16
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)⁴³	1

Ky tregues vlerëson transparencën e vendimeve të Këshillit të Ministrave duke rishikuar përmbajtjen e faqes në internet të ZKM-së për të përcaktuar nëse vendimet dhe informacioni për mbledhjet e qeverisë – agjendat e mbledhjeve, procesverbalet dhe njoftimet për shtyp – publikohen. Gjetjet nga ky proces plotësohen më tej duke matur perceptimet e OSHC-ve për transparencën e procesit të vendimarrjes.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së faqes në internet të ZKM-së, gjetëm se agjendat e mbledhjeve dhe procesverbalet e seancave të Këshillit të Ministrave nuk publikohen asnjëherë. Procesverbali nuk publikohet për shkak të “dispozitës së konfidencialitetit” në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave⁴⁴, ndërsa për agjendat e takimeve nuk ka pengesa ligjore. Lidhur me njoftimet për shtyp, gjatë periudhës gjashtë-mujore të monitorimit (tetor 2019 - mars 2020), ZKM kishte publikuar vetëm shtatë. Për më tepër, vendimet e Këshillit të Ministrave u botuan pjesërisht në kohën e duhur. Nga 192 vendime të Këshillit të Ministrave të nxjerra, vetëm 129 u publikuan dhe nga 21 akte normative të nxjerra vetëm 5 u publikuan. Ato mund të gjendeshin lehtësisht në faqen e internetit të ZKM-së.

Pandemia e COVID-19 nuk ndryshoi në mënyrë të konsiderueshme praktikën qeveritare në botimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave. Megjithatë, vlen të përmendet se nga 10 akte normative të miratuara në mars – në kulmin e kufizimeve të pandemisë COVID-19 – vetëm tre u botuan në faqen e internetit të ZKM.

Përmbledhje e rezultateve të sondazheve

Rezultatet e sondazhit të OSHC-ve rreth perceptimeve të tyre për transparencën e vendimarrjes së qeverisë nxjerrin në pah një mosmiratim të konsiderueshëm të praktikave faktike të qeverisë.⁴⁵ Kampioni përbëhej nga gjithsej 81 të anketuar dhe pyetjeve iu përgjigjën 71 OSHC.


Shumica e OSHC-ve (53.5%) e konsiderojnë procesin vendimarrës të qeverisë si jo-transparent, ndërsa më shumë se 1/3 e tyre (36.6%) janë neutrale. Në mënyrë të ngjashme, shumica e OSHC-ve (42%) i konsiderojnë përjashtimet nga rregullat e publikimit të vendimeve të qeverisë si të papërshtatshme, ndërsa më shumë se 1/3 (37%) janë neutrale në këtë temë.

43 Konvertimi i pikëve: 0-2 pikë = 0; 3-5 pikë = 1; 6-8 pikë = 2; 9-11 pikë = 3; 12-14 pikë = 4; 15-16 pikë = 5

44 Ligji nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

45 Kampioni përbëhej nga gjithsej 81 të anketuar, dhe 71 OSHC iu përgjigjën pyetjeve.


Grafiku 3. Perceptimet e OSHC-ve për transparencën e procesit të vendimmarrjes së qeverisë



Megjithëse nuk ka ndryshime në vlerën dhe rezultatin e përgjithshëm të treguesit krahasuar me ciklin e mëparshëm të monitorimit, kemi një rënie në përqindjen e OSHC-ve që mendojnë se procesi i vendimmarrjes së qeverisë është transparent (nga 15% në 8.4%) dhe të atyre që mendojnë se përjashtimet nga publikimi i vendimeve të qeverisë janë të përshtatshme (10.9% në 5.6%). Ngjashëm me treguesin e mëparshëm, meqenëse dokumentet kryesore në seancat e Këshillit të Ministrave, d.m.th. procesverbalet dhe rendi i ditës, nuk janë publikuar, ka të ngjarë që perceptimi pozitiv të formohet nga ndërveprimet e OSHC-ve me institucionet qeveritare ose nga mungesa e njohurive për dispozitat ligjore të cilat qartazi mundësojnë konfidencialitetin e seancave të qeverisë.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi ZHKP P6 I1: Transparenca e vendimmarrjes së Qeverisë



PARIMI 10: PROCESI I HARTIMIT TË POLITIKAVE DHE I HARTIMIT TË LIGJIT ËSHTË I BAZUAR NË PROVA, DHE NË TË GJITHA MINISTRITË PËRDORET VAZHDIMISHT VLERËSIMI I NDIKIMIT

Tabela 6. Treguesi WeBER ZHKP P10 I1: Përdorimi i provave të krijuara nga institute kërkimi, institucione të pavarura dhe OSHC të tjera në zhvillimin e politikave

Elementet e treguesit	Rezultatet
Shpeshtia e referimit të gjetjeve studimore të OSHC-ve në dokumentet e politikave të miratuara prej qeverisë	4/4
Shpeshtua e referimit të gjetjeve studimore të OSHC-ve në dokumentet e politikave dhe vlerësimet paraprake të ndikimit	2/4
Gjetjet studimore të prodhuara nga një gamë e gjerë e OSHC-ve, të tilla si institute kërkimore (think tank), institute të pavarura, organizata me bazë vendore, referohen në analiza dhe vlerësime faktike të politikave të institucioneve qeveritare	1/2
Ministritë përkatëse ose institucione të tjera qeveritare ftojnë ose porositin një gamë të gjerë të OSHC-ve, të tilla si institute kërkimore (think tank), institute të pavarura, organizata me bazë vendore, të përgatitin studime të politikave, dokumente ose vlerësime ndikimi për të shqyrtuar probleme ose propozime specifike të politikave	2/2
Përfaqësuesit e ministrive përkatëse marrin pjesë në diskutime politikash (diskutime, tryeza të rrumbullakëta, takime në dyer të mbyllura, etj.) lidhur me produkte specifike të hulumtimit të politikave.	2/2
Përfaqësues të një game të gjerë të OSHC-ve, të tilla si institute kërkimore, institucione të pavarura, organizata me bazë vendore ftohen të marrin pjesë në grupet e punës për hartimin e propozimeve për politika apo ligje, kur ato kanë propozime dhe rekomandime specifike të bazuara në studime	0/4
Ministritë përkatëse në përgjithësi japin komente për propozimet dhe rekomandimet e bazuara në studime nga një gamë e gjerë e OSHC-ve, të tilla si institute kërkimore, institute të pavarura, organizata me bazë vendore, të cilat janë pranuar ose refuzuar, duke justifikuar secilin nga veprimet	0/2
Ministritë pranojnë propozimet e politikave të OSHC-ve gjatë punës së kryer në grupet e punës për politika zhvillimore dhe ligje	0/4
Pikët	11/24
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)⁴⁶	2

Ky tregues ndërthur shqyrtimin e dokumenteve të politikave qeveritare dhe studimet e vlerësimit të ndikimit për të përcaktuar nëse ato referojnë gjetjet e OSHC-ve me perceptimet e OSHC-ve për përfshirjen e tyre në procesin e politikëbërjes nga institucionet e qeverisë qendrore. Tri fusha të politikave u zgjodhën për të vlerësuar përdorimin e gjetjeve të OSHC-ve në dokumentet e politikave qeveritare dhe në studimet e vlerësimit të ndikimit: anti-korrupsioni, anti-diskriminimi dhe mbrojtja sociale.

Fillimisht, u shqyrtuan strategjitë dhe planet e veprimit të qeverisë në tre fushat e politikave për të përcaktuar nëse gjetjet e OSHC-ve ishin referuar. Më tej, për të njëjtin qëllim u shqyrtuan studimet e vlerësimit të ndikimit para (ex-ante) miratimit të strategjive, planeve të veprimit dhe legjislacionit. I njëjti proces u përsërit për vlerësimet e ndikimit pas (ex-post) miratimit dhe zbatimit të strategjive, planeve të veprimit dhe legjislacionit.⁴⁷

- Relacion shoqërues për një projektligj dhe dokumentet e politikave qeveritare që i paraprijnë miratimit të legjislacionit (p.sh. dokumenti analitik që i paraprin legjislacionit të reformës në drejtësi në Shqipëri)⁴⁸ u konsideruan vlerësime ex-ante (paraprake).
- Raportet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatit të Popullit, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe raporte të tjera të qeverisë për monitorimin e strategjive, planeve të veprimit dhe legjislacionit u konsideruan dokumente të vlerësimit pasardhës (ex-post).

46 Konvertimi i pikëve: 0-5 pikë = 0; 6-8 pikë = 1; 9-12 pikë = 2; 13-16 pikë = 3; 17-19 pikë = 4; 20-24 pikë = 5

47 Fushat e politikave të shqyrtuara ishin anti-korrupsioni, anti-diskriminimi dhe mbrojtja sociale.

48 Komisioni Parlamentar i Përkohshëm për Reformën në Drejtësi, Analiza e Sistemit Shqiptar të Drejtësisë (Tiranë: Kuvendi, 2015), http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf.


Gjetjet e bazuara në studime të OSHC-ve mund të konsiderohen se referohen rregullisht në kampionin e strategjive të miratuara të qeverisë, pasi 69% (9 nga 13) e strategjive të shqyrtuara përmbajnë referenca të gjetjeve të OSHC-ve. Lidhur me vlerësimet paraprake të ndikimit dhe analizat pasardhëse për fushat e politikave të shqyrtuara, situata është përmirësuar disi në krahasim me ciklin e fundit të monitorimit, por mbetet e ulët. Për të njëjtën periudhë matjeje, 18% (4 nga 22) të dokumenteve të shqyrtuara dhe vlerësimeve të ndikimit ex-ante dhe 41% (5 nga 12) të dokumenteve të shqyrtuara a të politikave ex-post përmbajnë referencë ndaj gjetjeve të OSHC-ve.

Përmbledhje e rezultateve të sondazheve

Rezultatet nga sondazhi i perceptimit të OSHC-ve bazohen në përgjigjet e 62 OSHC-ve nga 81 gjithsej. Ato tregojnë një pamje mjaft komplekse të bashkëpunimit OSHC-qeveri në hartimin e dokumenteve të politikave dhe legjislacionit, si dhe për diskutimin e nismave të politikave. Ndërsa OSHC-të kanë qenë të interesuara për bashkëpunim më të fortë me institucionet publike, duket se ka një hezitim nga institucionet publike për të kërkuar në mënyrë proaktive dhe të vazhdueshme ekspertizën e OSHC-ve.


Bazuar në rezultatet e sondazhit të OSHC-ve, shumica e tyre (61.3%) thonë se janë ftuar të përgatitin ose paraqesin dokumente politikash, studime ose vlerësime të ndikimit kur autoritetet trajtojnë probleme të politikave ose zhvillojnë propozime politikash në fushat e tyre të punës, por mendojnë se propozimet e tyre merren shumë pak në konsideratë. Vetëm 12.9% e OSHC-ve besojnë se ministritë shpesh ose gjithmonë marrin parasysh propozimet e tyre, ndërsa 37% pajtohen se kjo ndodhë ndonjëherë.

Grafiku 4. Perceptimi i OSHC-ve për qasjen e qeverisë për të kërkuar ekspertizën e tyre të politikave



Përfaqësuesit e qeverisë angazhohen në mënyrë më proaktive nga OSHC-të për të diskutuar problematikë e politikave publike. Sipas 46.7% të të anketuarve, përfaqësuesit e qeverisë zakonisht ose gjithmonë, marrin pjesë në forume të politikave kur ftohen nga OSHC-të. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e OSHC-ve në grupet e punës për hartimin e politikave ose propozimeve legjislative në fushën e tyre të ekspertizës është e vogël. Vetëm 21% e OSHC-ve thonë se ato janë zakonisht ose gjithmonë të ftuara, ndërsa 38.7% thonë se ndonjëherë janë të ftuara. Për më tepër, reagimet e qeverisë për propozimet e bazuara në studime të OSHC-ve mbeten të ulëta. Vetëm 13% janë dakord që institucionet qeveritare japin arsyeime për pranimin ose refuzimin e propozimeve të OSHC-ve. Më shumë se 1/3 (35.5%) besojnë se kjo ndodh rrallë, ndërsa 25.8% besojnë se nuk ndodh kurrë.

Grafiku 5. Perceptimi i OSHC-ve për bashkëpunimin qeveri-OSHC për zhvillimin e politikave




Pavarësisht nivelit të ulët të bashkëpunimit, ka pasur disa përmirësime krahasuar me ciklin e fundit të monitorimit:

- Megjithëse ishin të vogla në shifra absolute, u gjetën më shumë vlerësime ex-ante dhe ex-post sesa gjatë ciklit të fundit të monitorimit 2017/18, gjatë të cilit ato mungonin.
- Ka pasur një rritje të perceptimit që OSHC-të janë të ftuara të paraqesin propozime të politikave (nga 37% në 2018 në 61% në 2020) dhe për pjesëmarrjen e palëve të interesuara nga qeveria në dialogun e politikave të organizuar nga OSHC-të (37% në 2018 në 47% në 2020)

Nga ana tjetër, ka pasur një rënie të lehtë të pjesëmarrjes së OSHC-ve në grupe pune (nga 27% në 2018 në 21% në 2020).

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi ZHKP 10 I1: Përdorimi i provave të krijuara nga cisterna mendimi, institucione të pavarura dhe OSHC të tjera në zhvillimin e politikave



PARIMI 11: POLITIKAT DHE LEGJISLACIONI JANË HARTUAR NË NJË MËNYRË GJITHËPËRFSHIRËSE, E CILA MUNDËSON PJESËMARRJEN AKTIVE TË SHOQËRISË

Tabela 7. Treguesi WeBER ZHKP P11 I 1: Perceptimi i shoqërisë civile dhe shkalla e përfshirjes në politikëbërje

Elementet e treguesit	Rezultatet
Qëllimi i konsultimeve publike për dokumentet e politikave në administratën qendrore	0/4
Qëllimi i konsultimeve publike për legjislacionin në administratën qendrore	2/4
Disponueshmëria e raporteve të konsultimit publik për dokumentet e politikave nga administrata qendrore	0/4
Disponueshmëria e raporteve të konsultimit publik për legjislacionin nga administrata qendrore	0/4
Funksionaliteti bazik i portalit kombëtar të konsultimit publik	0/4
Funksionaliteti i përparuar i portalit kombëtar të konsultimit publik	1/2
Proaktiviteti i informimit për konsultimin publik	0/4
Përfshirja e konsultimeve të hershme publike	0/2

Cilësia e raportimit për konsultimet publike	0/2
Ndikimi i rezultateve të konsultimit publik në politikëbërje	0/2
OSHC-të konsiderojnë se procedurat zyrtare të konsultimit krijojnë parakushte për përfshirjen e efektshme të publikut në procesin e politikëbërjes	1/2
OSHC-të konsiderojnë që procedurat zyrtare të konsultimit zbatohen në mënyrë të sistematike	0/2
OSHC-të konsiderojnë se ato janë konsultuar në fazat e hershme të procesit të politikëbërjes	0/2
OSHC-të konsiderojnë se të konsultuarve u është dhënë në kohë informacioni në lidhje me përmbajtjen e legjislacionit ose politikave të propozuara	0/2
OSHC-të konsiderojnë se të konsultuarve u sigurohet informacioni i duhur për përmbajtjen e legjislacionit ose politikave të propozuara	0/2
OSHC-të konsiderojnë që ministritë propozuese të projektakteve marrin masa që grupe interesi të larmishme (grupet e grave, grupet e të drejtave të pakicave, sindikatat, shoqatat e punëdhënësve, etj.) të përfaqësohen në proceset e konsultimit	0/2
OSHC-të konsiderojnë që ministritë (propozuese të projektakteve) përgjigjen me shkrim ndaj kontributeve/komenteve të të konsultuarve.	0/2
OSHC-të konsiderojnë se ministritë (propozuese të projektakteve) pranojnë kontributet/komentet e të konsultuarve	0/2
OSHC-të konsiderojnë se ministritë (propozuese të projektakteve) mbajnë diskutime konstruktive rreth mënyrës se si pikëpamjet e të konsultuarve kanë formësuar dhe ndikuar në politikën dhe vendimin përfundimtar të qeverisë	0/2
Pikët	4/50
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)⁴⁹	0

Ky tregues bazohet gjithashtu në një ndërthurje metodash: sondazhi i OSHC-ve dhe rishikim i procesit të konsultimit publik dhe legjislacionit. Të gjitha dokumentet e politikave dhe ligjet e miratuara në gjysmën e dytë të vitit 2019 – dhe që i nënshtrohen Ligjit për Konsultimin Publik – u kontrolluan nëse i ishin nënshtruar procesit të konsultimit publik duke kontrolluar thirrjet e publikuara në portalin e konsultimit publik.

Tipari kryesor i procesit të konsultimit publik është natyra e tij e çrregullt. Megjithatë janë përcaktuar kërkesa themelore ligjore për të siguruar një proces të efektshëm, institucionet e qeverisë qendrore nuk i përmbahen në mënyrë sistematike kornizës ligjore dhe nuk synojnë të angazhojnë në mënyrë proaktive organizatat e shoqërisë civile në procesin e konsultimit.

Ndërsa konsultimi publik u mbajt për afërsisht 64% (18 nga 28) të ligjeve të miratuara gjatë periudhës së matjes, vetëm 40% (6 nga 15) e strategjive dhe planeve të veprimit kishin kaluar fazën e konsultimit publik për të njëjtën periudhë. Për projektaktet që iu nënshtruan konsultimit publik, nuk u prodhua asnjë raport i konsultimit publik nga institucionet e qeverisë qendrore. Përveç mungesës së raportimit, një shqetësim tjetër është mungesa e proaktivitetit të institucioneve të qeverisë qendrore për të publikuar njoftimet për konsultimet publike nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit (përfshirë edhe media sociale), duke qenë se njoftimet publikohen kryesisht në faqet e tyre të internetit dhe nëpërmjet portalit të konsultimit publik.

Për më tepër, mungesa e raporteve të konsultimit publik dhe mungesa e përgjigjeve nga institucionet e qeverisë qendrore për rekomandimet e ofruara nga OSHC-të nuk siguron efektshmërinë e procesit të konsultimit dhe përjashton marrjen në shqyrtim të rekomandimeve, që mund të përmirësojnë një ligj ose dokument politikash para miratimit të tij. Megjithatë nuk janë parashikuar nga legjislacioni shqiptar dhe nuk janë kryer

49 Konvertimi i pikëve: 0-9 pikë = 0; 10-17 pikë = 1; 18-25 pikë = 2; 26-33 pikë = 3; 34-41 pikë = 4; 42-50 pikë = 5.

gjatë periudhës së monitorimit, konsultimet e hershme – d.m.th. konsultimet para se të hartohet projektakti – gjithashtu mund të përmirësojnë cilësinë e dokumentit të miratuar.

Portali i konsultimit publik të jep mundësinë për të shkruar dhe për të parë komente, si dhe për të shqyrtuar dokumentacionin mbështetës për një projektakt, por ai disa vështirësi në përdorimi. Megjithatë është e mundur të kërkojnë projektaktet nga institucionet e renditura në portal, ai nuk të jep mundësinë për të kërkuar në të njëjtën kohë bazën e të dhënave të tij pa pasur nevojë për të shfletuar projektaktet e publikuara një e nga një.


Përveç procesit të konsultimit publik të kryer nga institucionet e qeverisë qendrore, Kuvendi zhvillon procesin e vet të konsultimit publik të projektligjeve të paraqitura nga Këshilli i Ministrave. Kuvendi nxjerr raporte vjetore për konsultimet publike të mbajtura për projektligjet që janë miratuar, por raportet e tij janë mjaft të përgjithshme dhe përmbajnë vetëm të dhëna statistikore për rekomandimet që janë dorëzuar, pranuar dhe refuzuar.⁵⁰

Përmbledhje e rezultateve të sondazheve

Disa nga gjetjet nga rishikimi i procesit të konsultimit për projektaktet e zgjedhura konfirmohen edhe nga rezultatet e sondazhit të OSHC-ve. OSHC-të që iu përgjigjën pyetjeve në lidhje me konsultimin publik ishin 73 nga 81 gjithsej. Vetëm 7% e OSHC-ve pohojnë se ministritë përkatëse shpesh ose gjithmonë u japin atyre përgjigje për rekomandimet e bëra, ndërsa shumica (52%) pohojnë se ministritë e bëjnë këtë rrallë ose asnjëherë. Në mënyrë të ngjashme, vetëm 9.6% e OSHC-ve të anketuara pohojnë se ministritë, në fakt, i pranojnë rekomandimet e tyre ndërsa shumica (49%) pohon se kjo ndodh rrallë ose kurrë. Për më tepër, 45% e organizatave pohojnë se procedurat zyrtare të konsultimit nuk zbatohen në mënyrë sistematike.


Nga ana tjetër, perceptimi nëse procedurat faktike të konsultimit sigurojnë kushte për një përfshirje të efektshme të publikut në proceset e politikëbërjes janë të ndara relativisht në mënyrë të barabartë: 37% nuk pajtohen, ndërsa 35.7% pajtohen. Në legjislacionin shqiptar nuk parashikohen konsultimet në fazat e hershme të procesit të hartimit të projekteve; megjithatë, rezultatet e sondazhit tregojnë një larmi mendimesh: 11% thonë se janë konsultuar; 50% se nuk janë konsultuar; 30% pohojnë se, ndonjëherë, janë konsultuar para hartimit të një projektakti.

Grafiku 6. Perceptimi i OSHC-ve për trajtimin e sugjerimeve të OSHC-ve nga qeveria, nëpërmjet procesit të konsultimit publik




50 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Raport për Pjesëmarrjen e Publikut dhe Shoqërisë Civile në Procesin e Vendimmarrjes në Kuvend për Vitin 2020, http://www.parlament.al/Files/RaporteStatistika/2020_Pjes%C3%ABmarrja_Publikut.pdf.

Grafiku 7. Perceptimi i OSHC-ve për zbatimin e procedurave zyrtare të konsultimit publik nga qeveria




OSHC-të u pyetën gjithashtu, nëse në procesin e konsultimit përfaqësohen grupe të ndryshme të interesit (gratë, sindikatat, pakicat) dhe nëse janë kryer konsultime shtesë me OSHC-të, përveç procesit zyrtar. Në pyetjen e parë, 9.6% u përgjigjën se grupe të ndryshme interesi nuk përfaqësohen kurrë, ndërsa 45.2% të anketuarve se ato përfaqësohen rrallë. Në pyetjen e dytë, 22% u përgjigjën se nuk mbahen asnjëherë procese shtesë konsultimi, ndërsa 41% u përgjigjën se procese të tilla konsultimi mbahen rrallë.

Grafiku 8. Perceptimi i OSHC-ve për përfshirjen e grupeve të ndryshme të interesit në procesin e konsultimit dhe zbatimin e seancave shtesë të konsultimit



Një çështje tjetër, sipas OSHC-ve të anketuara, është se mungon informacioni i duhur për politikatat dhe propozimet ligjore. Vetëm 14% e OSHC-ve të anketuara deklarojnë se institucionet qeveritare ofrojnë informacion të përshtatshëm për përmbajtjen e ligjeve apo politikave të propozuara, ndërsa 43% janë neutrale dhe 39% nuk pajtohen. Sipas 44% të OSHC-ve institucionet qeveritare nuk arrijnë të ofrojnë informacion në kohë mbi përmbajtjen e ligjeve apo politikave të propozuara, ndërsa më shumë se një e treta (34.3%) ishin neutrale.

Grafiku 9. Perceptimi i OSHC-ve për kohën dhe përshtatshmërinë e informacionit të dhënë nga institucionet qeveritare për publikun për qëllime konsultimi




Nuk ka pasur ndonjë ndryshim të konsiderueshëm në rezultatet e elementeve të sondazhit të këtij treguesi, përveç zvogëlimit nga 45% (2017/2018) në 37% (2019/2020) të OSHC-ve që deklarojnë se procedurat faktike të konsultimit sigurojnë kushte për një përfshirje të efektshme të publikut në proceset e hartimit të politikave.

Rezultatet nga cikli i monitorimit 2019/2020 nuk mund të krahasohen në mënyrë rigoroze me ato të ciklit të mëparshëm të monitorimit, sepse ndryshimi në metodologji, duke shtuar elemente të bazuara në hulumtim dokumentesh zyrtare tek ato të bazuara në sondazh, ka ndikuar në rezultatin e përgjithshëm të treguesit dhe shkallën e vlerës.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi ZHKP P11 I1: Perceptimi i shoqërisë civile dhe shkalla e përfshirjes në politikëbërje



III.4 PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE: ZHVILLIMI DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE

Mungesa e raportimit të qeverisë për strategjitë/planet e veprimt të saj tërësore dhe shqyrtimi i bashkëpunimit qeveri-OSHC për zhvillimin dhe koordinimin e politikave nxjerrin në pah mangësi të konsiderueshme për transparencën, llogaridhënien, hapjen dhe angazhimin e mirëfilltë të publikut që kërkohet për të hartuar dhe zbatuar me sukses politikat. Tri prirje janë veçanërisht shqetësuese: (1) një bollëk publikimesh në media sociale për të promovuar arritjet e qeverisë, përkundrajt mungesës së raporteve zyrtare për politikat e qeverisë, (2) një proces konsultimi i papërshtatshëm dhe i paefektshëm dhe (3) mungesa e politikëbërjes së bazuar në të dhëna studimore.

Përdorimi i gjerë i fushatave të mediave sociale për të promovuar arritjet e pretenduara të qeverisë, pa të dhëna zyrtare të disponueshme për zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimt të qeverisë, krijon një asimetri informacioni në favor të qeverisë dhe në dëm të llogaridhënies publike. Pa informacione në dispozicion të publikut që mund të shqyrtohen, qeveria mundet dhe formon një fabul të përmbushjes me sukses së objektivave të saj. Ky është një tregues domethënës se qeveria nuk synon të ofrojë llogaridhënie të mirëfilltë ose të marrë në konsideratë pjesëmarrjen e shoqërisë civile në politikëbërje. Mungesa e politikëbërjes të bazuar në të dhëna studimore dhe e konsultimit të efektshëm publik e mbështesin edhe më tej këtë pohim.

Pavarësisht interesit të fortë të shoqërisë civile dhe – veçanërisht – të organizatave të shoqërisë civile me ekspertizë të konsiderueshme në fushat e shtetit të së drejtës, reformave për anëtarësimin në BE dhe politikës sociale, politikëbërësit shqiptarë ende nuk e kanë marrë parasysh dhe nuk e kanë vlerësuar rëndësinë e politikëbërjes të bazuar në të dhëna studimore dhe në pjesëmarrjen e shoqërisë civile. Ndërsa janë bërë përmirësime të dukshme nëpërmjet krijimit të një kornize ligjore për konsultimet publike, nuk është bërë asnjë përparim i mëtijshëm në krijimin e rregulloreve dhe procedurave të nevojshme për ta bërë procesin të efektshëm. Në mënyrë të ngjashme, përkundër përfshirjes zyrtare të metodologjisë së vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA) për projektligjet e qeverisë, dispozitat përjashtimore të përdorimit të kësaj metodologjie dhe mungesa e përdorimit të saj në fusha që nuk përjashtohen, jep përshtypjen se institucioneve qeveritare u mungojnë kapacitetet institucionale ose vullneti për të hartuar politika të bazuara në të dhëna studimore.

III.5 REKOMANDIME PËR ZHVILLIMIN DHE KOORDINIMIN E POLITIKAVE

Gjurmimi i rekomandimeve nga Monitorimi i RAP 2017/2108

Rekomandimi	Statusi	Komento
Këshilli i Ministrave duhet të publikojë raporte vjetore të zbatimit të Programit të Qeverisë.	I pazbatuar	Nuk ka raporte të publikuara për zbatimin e Programit.
Raportet e monitorimit për dokumentin e programit të qeverisjes qendrore duhet të vihen në dispozicion të publikut.	Zbatuar pjesërisht	Raportet e publikuara mund të gjenden vetëm për Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020, por jo për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, ose Programin e Qeverisë.
Këshilli i Ministrave duhet të publikojë agjendat, procesverbalet (përmbledhjet) dhe njoftimet për shtyp për seancat e qeverisë.	I pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.
Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) duhet të jetë e institucionalizuar dhe të zbatohet brenda sistemit aktual të politikëbërjes.	Zbatuar pjesërisht	RIA është përfshirë si pjesë e procesit qeveritar të hartimit të ligjeve, por nuk zbatohet plotësisht.
Ministritë propozuese duhet të përpiqen të referojnë në mënyrë të përshtatshme gjetjet e bazuara në studime të OSHC-ve në dokumentet e politikave dhe vlerësime të politikave.	Zbatuar pjesërisht	Megjithatë ka një rritje të referimit të botimeve të bazuara në studime të OSHC-ve, shumica e dokumenteve të politikave qeveritare dhe raporteve që shoqërojnë projektligjet e qeverisë zakonisht përmendin këshilla të dhëna nga organizata të ndihmës së huaj dhe ekspertë të jashtëm.
Gjatë procesit të politikëbërjes, ministritë propozuese duhet të sigurojnë në mënyrë proaktive dhe sistematike përgjigje për propozimet dhe rekomandimet e bëra.	I pazbatuar	Ministritë përkatëse në përgjithësi nuk përgjigjen ndaj rekomandimet e dhëna prej një gamë të gjerë të OSHC-ve, të tilla si institute kërkimore, institute të pavarura, organizata me bazë lokale që janë pranuar ose refuzuar. (Vlerësimi bazuar në diskutimet në fokus-grupe me OSHC-të lokale dhe kombëtare.)
Konsultimet publike duhet të jenë të orientuara drejt rezultateve në vend të orientimit drejt procesit.	I pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.
Ministritë duhet të publikojnë planet vjetore të procesit të tyre të vendimmarrjes.	I pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.
Ministritë duhet të përdorin vazhdimisht portalin e konsultimit publik për të publikuar të gjitha projekt-aktet që janë subjekt i konsultimit publik.	I pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.
Proceset e konsultimit publik duhet të lejojnë shqyrtimin në kohë të propozimeve të qeverisë në përputhje me afatet ligjore.	I pazbatuar	OSHC-të nuk janë pajisur në kohë me informacion për përmbajtjen e legjislacionit ose politikave të propozuara. (Vlerësim i bazuar në rezultatet e sondazhit të perceptimit të OSHC-ve dhe në shqyrtimin e procesit të konsultimit publik për projektaktet qeveritare të përzgjedhura.)
Ministritë duhet të publikojnë raportet e tyre vjetore për transparencën e procesit të vendimmarrjes, siç kërkohet nga ligji për konsultimin publik, duke përfshirë informacionin për numrin e akteve të miratuara, përshtypjet e marra, rekomandimet e pranuar dhe refuzuara, si dhe numrin e takimeve të zhvilluara.	I pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.
Institucionet publike duhet të sigurojnë përfaqësimin e interesave të ndryshme në proceset e konsultimit.	I pazbatuar	Ministritë propozuese nuk kanë ndërmarrë veprime të mjaftueshme për të siguruar që një larmi interesash të përfaqësohen në proceset e konsultimit (grupet e grave, grupet e të drejtave të pakicave, sindikatat, shoqatat e punëdhënësve). (Vlerësim i bazuar në rezultatet e sondazhit të perceptimit dhe në shqyrtimin e dokumenteve të siguruara nga institucionet publike për procesin e konsultimit publik për dokumentet strategjike të RAP-it.)
Ministritë duhet t'i kushtojnë vëmendjen e duhur ndërtimit të kapaciteteve brenda administratës publike për të angazhuar në mënyrë efektive grupet e interesit.	Zbatuar pjesërisht	ASPA ofron module trajnimi për angazhimin e grupeve të interesit.
Ministritë duhet të monitorojnë zbatimin proceseve të tyre të pjesëmarrjes.	Zbatuar pjesërisht	Angazhimi i palëve të interesuara ndryshon sipas ministrave. Sidoqoftë, në përgjithësi, ministritë duhet përmirësojnë mekanizmat e tyre të angazhimit dhe raportimit.

■ Rekomandimet e Monitorimit të RAP 2019/2020

Rekomandimet për këtë pjesë janë në thelb të njëjta me ato të ciklit të mëparshëm të monitorimit, pasi shumica e rekomandimeve të mëparshme nuk janë trajtuar, ndërsa disa janë trajtuar pjesërisht.

1. Këshilli i Ministrave duhet të publikojë raporte vjetore të zbatimit të Programit të Qeverisë, SKZHI-së dhe PKIE-së.
2. Këshilli i Ministrave duhet të publikojë agjendat, procesverbalet (përmbledhjet) dhe njoftimet për shtyp të mbledhjeve të qeverisë. Për këtë qëllim, klauzola e «konfidencialitetit» në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave duhet të shfuqizohet.
3. Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) duhet të zbatohet në mënyrë të efektshme. Procesi duhet të udhëhiqet nga studime zyrtare të vlerësimit dhe nga angazhimi sistematik e të përqëndruar te palët e interesuara.
4. Hartimi i politikave të bazuara në studime duhet të jetë në qendër të qasjes së qeverisë ndaj politikave publike. Institucionet publike duhet të krijojnë një rrjet bashkëpunimi me universitetet, institutet dhe OSHG-të për të ndarë të dhëna zyrtare, për të kërkuar propozime politikash dhe për të diskutuar mundësitë për përmirësuar politikat publike.
5. Portali i konsultimit publik duhet të jetë plotësisht funksional. Përveç mundësisë për të dhënë komente, qytetarët duhet të kenë mundësi të shohin komente të tjera dhe të marrin përgjigje nga institucionet kryesore.
6. Institucionet publike duhet të publikojnë planet vjetore të procesit të tyre të vendimmarrjes në përputhje me Nenin 6, Pika 1.b) të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe me Nenin 7, Pika 1.gj) të Ligjit për të Drejtën e Informimit.
7. Ministrinë duhet të publikojnë raportet e tyre vjetore për transparencën e procesit të vendimmarrjes në përputhje me Nenin 20 të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, duke përfshirë numrin e akteve të miratuara, përshtypjet e marra, rekomandimet e pranuar dhe të refuzuara, si dhe numrin e takimeve të kryera.
8. Ministrinë duhet të përdorin vazhdimisht portalin e konsultimit publik për të publikuar të gjitha projekt-aktet që janë subjekt i konsultimit publik.
9. Proceset e konsultimit publik duhet të lejojnë shqyrtimin në kohë të propozimeve të qeverisë në përputhje me afatet ligjore.
10. Institucionet publike duhet të sigurojnë përfaqësimin e interesave të ndryshme në proceset e konsultimit.

IV SHËRBIMI PUBLIK DHE MIRADMINISTRIMI ● I BURIMEVE NJERËZORE

IV.1 TREGUESIT WEBER TË PËRDORUR PËR SHËRBIMIN PUBLIK DHE MIRADMINISTRIMIN E BURIMEVE NJERËZORE DHE VLERAT PËR SHQIPËRINË

P2 I1: Disponueshmëria publike e të dhënave dhe raporteve zyrtare në lidhje me shërbimin civil dhe punonjësit në administratën qendrore të shtetit					
0	1	2	3	4	5
P2 I2: Kryerja e detyrave karakteristike të shërbimit civil jashtë rregullave të shërbimit civil të bazuar në meritë					
0	1	2	3	4	5
P3 I1: Hapja, transparenca dhe paanshmëria e rekrutimit në shërbimin civil					
0	1	2	3	4	5
P4 I1: Ndikimi direkt ose indirekt politik në pozicione të larta drejtuese në shërbimin publik					
0	1	2	3	4	5
P5 I1: Transparenca, qartësia dhe disponueshmëria publike e informacionit për sistemin e pagave në shërbimin civil					
0	1	2	3	4	5
P7 I1: Efektiviteti i masave për promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në shërbimin civil					
0	1	2	3	4	5

■ Gjendja e Shërbimit Publik dhe Miradministrimit të Burimeve Njerëzore (SHPMBNJ)

Në vitin 2013, Shqipëria miratoi një ligj të ri për të rregulluar shërbimin civil, ndërsa një strategji gjithëpërfshirëse për reformën së administratës publike (2015-2020) do të drejtonte reformën e shërbimit civil.⁵¹

Legjislacioni i shërbimit civil është përgjithësisht në përputhje me Parimet e Administratës Publike të SIGMA-s.⁵² Sidoqoftë, ka disa përjashtime nga shtrirja horizontale dhe vertikale e shërbimit civil, duke bërë që disa institucione apo pozicione të administratës qendrore të mos rregullohen nga legjislacioni i shërbimit civil.⁵³ Për shembull, përjashtime nga shtrirja horizontale përfshijnë Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, të cilat nuk janë subjekt të Ligjit për Nëpunësin Civil. Shembuj të përjashtimeve nga shtrirja vertikale përfshijnë drejtorin e përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe drejtorin e përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Procedurat e rekrutimit të shërbimit civil nuk kanë ndryshuar që prej ndryshimit të fundit të Ligjit për Nëpunësin Civil në 2014. Procesi i rekrutimit është i ngjashëm për të gjitha kategoritë, përveç nëpunësve të lartë civilë, të cilët rekrutohen nëpërmjet një sistemi kombëtar të rekrutimit në grup – për të gjitha vendet e lira të trupës së nivelit të lartë drejtues (TND) – për të ndjekur fillimisht programin e formimit të thellur nëpërmjet Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe më pas t'u emëruar sipas renditjes së tyre pas mbarimit të programit. Kjo mënyrë rekrutimi nuk është përdorur që nga miratimi i Ligjit për Nëpunësin Civil në 2013. Në vend të saj, pranimi i drejtpërdrejtë ka qenë norma. Ndërsa në rastin e parë kandidatët e suksesshëm duhet të marrin pjesë dhe të kalojnë me sukses provimin⁵⁴ e programit të formimit të thelluar të ASPA-s para se të pranohen në TND, në rastin e dytë ata mund të ndjekin programin e trajnimit pasi të pranohen në TND pa patur nevojë për të kryer programin e formimit të thelluar apo ndonjë provim shtesë. Konkurrimet për emërimet të drejtpërdrejta lejohen në përputhje me Nenin

51 Departamenti i Administratës Publike, "Strategjia Ndërsëktoriale e Reformës së Administratës Publike 2015-2020," http://www.dap.gov.al/images/DokumentaStrategjik/SNRAP_2015-2020_miratur.pdf

52 OECD, Methodological Framework for the Principles of Public Administration (Paris: OECD Publishing, 2017), <http://www.sigmaxweb.org/publications/Principles-of-Public-Administration-2017-edition-ENG.pdf>.

53 Shih OECD, Monitoring Report: Albania (Paris: OECD Publishing, 2017), 64-65, <http://www.sigmaxweb.org/publications/Monitoring-Report-2017-Albania.pdf>.

54 Duhet të arrihen të paktën 70 pikë për ta kaluar me sukses provimin.

27/5 të ligjit, derisa të dalë grupi i parë i të diplomuarve nga ASPA ose kur prurjet nga ASPA janë të pamjaftueshme.⁵⁵ Në vitin 2019, ASPA filloi pilotimin e një programi trajnimi për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm dhe të lartë.⁵⁶

Integriteti në administratën publike rregullohet kryesisht nga ligjet për konfliktin e interesit⁵⁷ dhe për deklarimin e pasurisë⁵⁸ të zyrtarëve publikë⁵⁹. Megjithatë kuadri rregullator është i vendosur, në raportin e vitit 2020 për Shqipërinë, Komisioni Evropian ka vërejtur mungesë kapacitetesh institucionale për të verifikuar pasuritë dhe për të vlerësuar konfliktet e interesit.⁶⁰ Kjo çështje pranohet gjithashtu nga Departamenti i Administratës Publike (DAP).⁶¹

Po ashtu, krijimi i një sistem të drejtë pagash ka vazhduar të jetë sfiduese. DAP ka hartuar një dokument politikash për reformën e shpërblyerjes, e cila do të konsultohet me ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të vlerësuar ndikimin financiar.⁶²

Për më tepër, çështja e nëpunësve civilë të shkarkuar në mënyrë të paligjshme po shkakton dëme të konsiderueshme financiare në buxhetin e vendit. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerësoi se ishin paguar 511,748,508 lekë në paga të prapambetura për shkak të shkarkimeve të paligjshme.⁶³ Njëkohësisht, ritmi i rikthimit në punë të tyre në shërbimin civil ka qenë i ngadaltë, pjesërisht për shkak të dëshirës së tyre për të vazhduar punën në të njëjtën pozicion që kishin para se të largoheshin nga puna. Kjo nuk ka qenë gjithmonë e mundur dhe në raste të caktuara pozicioni i tyre nuk ishte më i disponueshëm për shkak të ristrukturimit të institucionit ku ata punonin. Deri në fund të vitit 2019, 66.5% e vendimeve të gjykatës ishin zbatuar, duke i rikthyer nëpunësit civilë në një pozicion të ri. Ka një rritje të lehtë në shkallën e zbatimit krahasuar me 2018 kur qëndronte në 62.8%.⁶⁴

■ Çfarë monitoron WeBER-i dhe si?

Monitorimi i WeBER-it brenda fushës së SHPMBNJ mbulon pesë Parime SIGMA dhe lidhet ekskluzivisht me administratën qendrore (institucionet e qeverisjes qendrore, ministri, organe vartëse dhe organe të posaçme). Me fjalë të tjera, monitorimi përfshin shërbimin civil të qeverisë qendrore, siç përcaktohet nga legjislacioni përkatës (kryesisht ligji i shërbimit civil). Parimet e përzgjedhura janë ato që përqendrohen në cilësinë dhe zbatimin praktik të kornizave ligjore dhe të politikave të shërbimit civil, në masat që lidhen me rekrutimin e bazuar në meritë, përdorimin e punësimeve të përkohshme, transparencën e sistemit të pagave, integritetin dhe anti-korrupsionin në shërbimin civil. Qasja WeBER u bazua në elemente të cilat SIGMA nuk përqendrohet fort në monitorimin e saj, por që janë domethënëse për shoqërinë civile nga këndvështrimi i transparencës së sistemit të shërbimit civil dhe hapjes së qeverisë, apo disponueshmërisë së të dhënave për publikun lidhur me zbatimin e politikës së shërbimit civil.

Në përputhje me kriteret e përzgjedhjes së WeBER-it u zgjodhën për monitorim parimet e mëposhtme SIGMA:

Parimi 2: Kuadri politik dhe ligjor për një shërbim publik profesional dhe koherent janë të përcaktuara dhe zbatohen në praktikë; struktura institucionale mundëson praktika të qëndrueshme dhe të efektshme për miradministrimin e burimeve njerëzore në tërë shërbimin publik.

55 Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", <http://www.dap.gov.al/images/Legjislacionishc/Ligji%20152%20perditesuar.pdf>.

56 Departamenti i Administratës Publike, "Strategjia Ndësektoriale e Reformës së Administratës Publike: Raporti Vjetor i Monitorimit 2019", 56, <http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/204-raportet-e-monitorimit-te-strategjise>.

57 Ligji nr. 9367, datë 7.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar), <http://dap.gov.al/images/LegjislacioniAP/Ligj%20nr.9367,%20date%207.4.2005%20Per%20parandalimin%20e%20konfliktit%20te%20interesave.pdf>.

58 Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimin financiar të personave të zgjedhur dhe të disa nëpunësve publikë" (i ndryshuar), <http://www.ildkpk.al/legjislacioni/>.

59 Ligjin nr. 138/2015 "Për integritetin e zyrtarëve që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", <http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/91-ligj-nr-138-2015-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-ose-ushtrojne-funksione-publike>; Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", <http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/44-ligj-nr-9131-date-08-09-2003-per-rregullat-e-etikes-ne-administraten-publike>; dhe Ligji nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", <http://www.ildkpk.al/legjislacioni-section3/>.

60 Komisioni Evropian, "Raporti për Shqipërinë 2020", 16-17, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf.

61 Departamenti i Administratës Publike, "Raporti për Shërbimin Civil 2019", 18, <http://dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>.

62 Departamenti i Administratës Publike, "Raporti për Shërbimin Civil 2019", 42-43.

63 Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, "Raporti Vjetor 2019", 136, <http://www.kmsch.al/wp-content/uploads/2021/01/ANNUAL-REPORT-2019.pdf>.

64 Departamenti i Administratës Publike, "Raporti për Shërbimin Civil 2019", 35-36.

- Parimi 3:** Rekrutimi i nëpunësve publikë bazohet në meritë dhe trajtim të barabartë në të gjitha fazat e tij; kriteret për ulje në detyrë dhe përfundimi i marrëdhënieve të punës së nëpunësve publikë janë të qarta.
- Parimi 4:** Parandalohet ndikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt politik në pozicionet e nivelit të lartë drejtues në shërbimin publik.
- Parimi 5:** Sistemi i pagave të nëpunësve publikë bazohet në klasifikimin e vendeve të punës; ai është i drejtë dhe transparent.
- Parimi 7:** Ekzistojnë masat për promovimin e integritetit, parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e disiplinës në shërbimin publik.

Monitorimi i këtyre parimeve ndërthur gjetjet e vlerësimit të SIGMA-s brenda nëntreguesve specifikë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se nuk ka vlerësime të SIGMA-s për vitin 2020, studiuesit e WeBER-it kryen llogaritjen e tyre të nëntreguesve të SIGMA-s në këtë cikël të Monitorimit RAP, në bazë të metodologjisë së SIGMA-s. SIGMA/OECD nuk mund të bëhen përgjegjës për rezultatin e këtyre llogaritjeve, por vetëm autorët e këtij raporti.

Përveç kësaj, monitorimi bazohet në shqyrtimin e legjislacionit, dokumenteve dhe faqeve të internetit nga ekspertët e WeBER-it, përfshi mbledhjen dhe analizën e të dhënave administrative qeveritare, raportet dhe dokumentet e tjera të kërkuara në internet ose të kërkuara nëpërmjet kërkesave për informacion. Për të patur një qasje më të ekuilibruar cilësore dhe sasiore, hulumtimi përfshiu matjen e perceptimeve të nëpunësve civilë, OSHC-ve dhe publikut të gjerë, duke përdorur sondazhe të perceptimit të tyre. Në fund, mbledhja e të dhënave përfshiu intervista gjysmë të strukturuar ballë për ballë dhe me fokus-grupe me aktorë të rëndësishëm të interesuar, si p.sh. nëpunës civilë të nivelit të lartë, ish-kandidatë për vendet e lira të shërbimit civil dhe përfaqësues të institucioneve qeveritare përgjegjëse për politikën e miradmirimit të burimeve njerëzore.

Sondazhet e nëpunësve civilë dhe OSHC-ve në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor u realizuan duke përdorur një mjet sondazhi në internet, midis gjysmës së dytë të qershorit dhe fillimit të gushtit 2020.⁶⁵ Anketa e nëpunësve civilë u shpërnda në shumicën e rasteve nëpërmjet një pike të vetme kontakti – zakonisht institucionet kombëtare përgjegjëse për sistemin e përgjithshëm të shërbimit civil.⁶⁶ Anketa e OSHC-ve, u shpërnda nëpërmjet rrjeteve dhe platformave ekzistuese të organizatave të shoqërisë civile nëpërmjet baza të dhënash kontakti në dispozicion të tyre, por edhe nëpërmjet pikave të kontaktit të qendrore si zyrat shtetërore përgjegjëse për bashkëpunimin me shoqërinë civile.⁶⁷ Për të siguruar që sondazhi i OSHC-ve të synonte sa më shumë organizata sa i përket llojit të tyre, shpërndarjes gjeografike dhe fushave të veprimtarisë të tyre, duke patur kështu një përfaqësimin sa më të madh të mundshëm të saj, atje ku qe e nevojshme u bë një nxitje shtesë e thirrjes për ta plotësuar. Ndërkohë, sondazhi i perceptimit të publikut përfshiu intervista personale të ndihmuara nga kompjuteri të publikut të gjerë (të moshës 18 vjeç e lart) të secilit vend të Ballkanit Perëndimor, gjatë periudhës 5 maj - 30 maj 2020.⁶⁸ Në të tri sondazhet, WeBER-i aplikoi pyetësorë të njëjtë në të gjithë rajonin dhe i shpërndau në gjuhët përkatëse, duke siguruar një qasje të barabartë në realizimin e sondazhit.

WeBER-i përdor gjashtë tregues për të matur pesë parimet e përmendura më lart. Në treguesin e parë, WeBER-i monitoron disponueshmërinë publike të të dhënave zyrtare dhe raporteve në lidhje me shërbimin civil dhe nëpunësit e administratës qendrore. Në treguesin e dytë, monitorimi përfshin shkallën në të cilën procedurat e punësimit të përkohshëm cenojnë punësimin e bazuar në meritë. Hapja, transparencja dhe paanshmëria e rekrutimit në shërbimin civil, si një aspekt tepër kritik i MBNJ-së në administratën publike të llogaridhënies ndaj publikut, shqyrtohet brenda treguesit të tretë. Treguesi i katërt përqendrohet në parandalimin e ndikimit direkt dhe indirekt politik në pozicionet

65 Sondazhet u administruan nëpërmjet një pyetësori anonim në internet. Metoda e mbledhjes së të dhënave përfshinte CASI (vetë-intervistim i ndihmuar nga kompjuteri). Në Shqipëri, sondazhi i nëpunësve civilë u krye nga data 15 korrik deri më 4 gusht 2020 dhe u shpërnda nga DAP. Sondazhi i OSHC-ve u krye nga data 24 qershor deri më 29 korrik 2020.

66 Për Shqipërinë, kampioni i sondazhit ishte N = 975. Baza (numri i të anketuarve që u përgjigjën) për pyetjet brenda Parimit 2 ishte n = 892 të anketuar, për Parimin 3 kishte n = 975 të anketuar, për Parimin 5 kishte n = 392 dhe n = 457 të anketuar dhe për Parimi 7 ishte n = 791 të anketuar.

67 Për Shqipërinë, kampioni e sondazhit ishte N = 81. Baza për pyetjet brenda fushës SHP & MBNJ ishte n = 70 të anketuar.

68 Perceptimet janë hulumtuar duke përdorur një sondazh që synon publikun (të moshës 18 vjeç e lart) e të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sondazhi i perceptimit të publikut përdori një kampionim në shumë faza dhe u administrua duke kombinuar intervistimin në internet dhe telefon të ndihmuar nga kompjuteri (CAWI dhe CATI), duke përdorur një pyetësor të standardizuar nëpërmjet sondazheve omnibus (me shumë kategori të dhënash) në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbi gjatë periudhës 5 maj - 30 maj 2020. Për Shqipërinë, kufiri i gabimit për kampioni e përgjithshëm prej 1007 qytetarë është 3.14%, në nivelin e besimit 95%.

e larta menaxheriale në shërbimin publik, ndërsa treguesi i pestë analizon nëse informacioni për pagat në shërbimin civil është transparent, i qartë dhe i disponueshëm për publikun. Në fund, në treguesin e gjashtë, WeBER-i shqyrton mbështetjen/nxitjen e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në shërbimin civil.

IV.2 REZULTATET E MONITORIMIT TË WEBER-IT

PARIMI 2: KUADRI POLITIK DHE LIGJOR PËR NJË SHËRBIM PUBLIK PROFESIONAL DHE KOHERENT JANË NË FUQI DHE ZBATOHEN NË PRAKTIKË; STRUKTURA INSTITUCIONALE MUNDËSON PRAKTIKA TË QËNDRUESHME DHE TË EFEKTSHME TË MIRADMINISTRIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE NË TË GJITHË SHËRBIMIN PUBLIK.

Tabela 8. Treguesi WeBER SHPMBNJ P2 I1: Disponueshmëria publike e të dhënave zyrtare dhe raporteve në lidhje me shërbimin civil dhe të punësuarit në administratën qendrore shtetërore

Elementet e treguesit	Rezultatet
Qeveria mban të dhëna të besueshme që kanë të bëjnë me shërbimin publik	2/4
Qeveria publikon rregullisht të dhëna statistikore bazë që kanë të bëjnë me shërbimin publik	0/4
Të dhënat statistikore të publikuara përfshijnë të dhëna për punonjësit që nuk janë nëpunës civilë me kohë të plotë në administratën qendrore të shtetit	0/4
Të dhënat statistikore të publikuara për shërbimin publik grupohen mbi kritere gjinore dhe etnike	2/2
Të dhënat zyrtare të publikuara janë të disponueshme në formatin e të dhënave të përpunueshme (open data)	0/1
Qeveria raporton në mënyrë gjithëpërfshirëse për politikën e shërbimit publik	4/4
Qeveria raporton rregullisht për politikën e shërbimit publik	2/2
Raportet për shërbimin publik përfshijnë informacion konkret në lidhje me cilësinë dhe/ose rezultatet e punës së shërbimit publik	1/2
Të dhënat dhe informacioni në lidhje me shërbimin publik publikohen në mënyrë aktive në publik	2/2
Rezultatet e përgjithshme	13/25
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)⁶⁹	2

Ky tregues përqendrohet në mbledhjen, përdorimin dhe raportimin prej qeverisë të të dhënave të shërbimit publik. Shqipëria ka krijuar një bazë të dhënash qendrore për burimet njerëzore (Sistemi i Informacionit të Miradministrimit të Burimeve Njerëzore - HRMIS), i cili përfshin të dhëna për pagat e shërbimit civil dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe kujdesin shëndetësor. Baza e të dhënave administrohet nga DAP, por është përgjegjësia e secilit institucion të përditësojë të dhënat përkatëse. Pavarësisht ndërveprimit të saj me bazat e të dhënave të tjera qeveritare, HRMIS-ja nuk ofron mundësi për të prodhuar të dhëna historike për numrin e nëpunësve publikë sipas kategorisë së shërbimit civil dhe organit administrativ. Të dhënat për pagat mesatare vjetore për kategori të ndryshme të shërbimit civil administrohen nga ministria e Financave dhe Ekonomisë.

69 Konvertimi i pikëve: 0-5 pikë = 0; 6-9 pikë = 1; 10-13 pikë = 2; 14-17 pikë = 3; 18-21 pikë = 4; 22-25 pikë = 5.

DAP prodhon dhe publikon rregullisht raporte vjetore për shërbimin civil në internet. Raporti për vitin 2019 përfshin informacion për (i) miradministrimin e burimeve njerëzore, (ii) reformën strukturore, (iii) sistemin e pagave, (iv) trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve, dhe (v) zhvillimin dhe zgjerimin e HRMIS-së, i cili ka të bëjë me shkallën e përdorimit të sistemit në administratën publike.

Pjesa e raportit për reformën strukturore trajton riorganizimin e ministrive të linjës dhe institucioneve të varësisë; pjesa për pagat trajton ndryshimet përkatëse legjislative për pagat në shërbimin civil dhe ndikimin e tyre mbi nivelin dhe pozicionin e punës; dhe pjesa për trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve trajton trajnimet e organizuara për çdo nivel nëpunësi civil në bazë të temave përkatëse, shkëmbimet rajonale dhe ndihmën e huaj. Pjesa për miradministrimin e burimeve njerëzore përfshin të dhëna për rekrutimin, ecurinë në karrierë brenda shërbimit civil dhe integritetin dhe masat disiplinore të marra.

Raportet vjetore përqendrohen vetëm te shërbimi civil dhe nuk japin ndonjë të dhënë për punonjësit e administratës shtetërore qendrore me kontratë të përkohshme ose për nëpunësit publikë pa status të veçantë, të cilët mundësojnë shërbime mbështetëse për administratën qendrore. Kjo ndodh pasi DAP-it nuk i kërkohet ligjërisht të administrojë të dhëna për punonjës të tjerë përveç nëpunësve civilë. Rrjedhimisht, është e vështirë të vlerësosh performancën dhe nevojat e kësaj kategorie punonjësish.

Raporti për vitin 2019 mbulon gjashtë nga shtatë çështjet kryesore të shërbimit publik. Ai trajton (i) planifikimin dhe rekrutimin, (ii) zhvillimin e karrierës, (iii) trajnimet e kryera, (iv) pagat, (v) procedimet dhe vendimet disiplinore, dhe (vi) masat për të siguruar integritetin profesional dhe parandalimin e korrupsionit; ndërkohë, vlerësimet e nëpunësve civilë nuk janë të përfshira. Këto pjesë të raportit përfshijnë informacione dhe të dhëna të përgjithshme, por ka shumë pak analiza që diskutojnë sfidat ose ndikimin e arritjeve në performancën e shërbimit civil.

Të dhënat e shërbimit civil nuk publikohen në një format që lejon përpunimin e të dhënave (open data), por ato promovohen nëpërmjet llogarive në media sociale të DAP në Facebook dhe Twitter. Me përjashtim të rritjes së përdoruesve të bazës së të dhënave të burimeve njerëzore, nuk ka ndryshime të konsiderueshme nga cikli i monitorimit 2017/2018 lidhur me miradministrimin e burimeve njerëzore dhe raportimin për politikën e shërbimit publik.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi SHPMBNJ P2 I1: Disponueshmëria publike e të dhënave dhe raporteve zyrtare në lidhje me shërbimin civil dhe punonjësit në administratën qendrore shtetërore




Tabela 9. Treguesi WeBER SHPMBNJ P2 I2: Kryerja e detyrave karakteristike të shërbimit civil jashtë rregullave të shërbimit civil të bazuar në meritë

Elementet e treguesit	Rezultatet
Numri i punësimeve të përkohshme për kryerjen e detyrave karakteristike të shërbimit civil në administratën qendrore të shtetit është i kufizuar me ligj	0/4
Ka kriteret specifike të përcaktuara për përzgjedhjen e individëve për punësim të përkohshëm në administratën shtetërore	0/4
Procedura e punësimit për individët e angazhuar me kontrata të përkohshme është e hapur dhe transparente	0/4
Kohëzgjatja e kontratave të angazhimit të përkohshëm është e kufizuar	0/4
Nëpunësit civilë mendojnë që punësimet e përkohshme në administratë përbëjnë përjashtime	1/2
Nëpunësit civilë mendojnë se kryerja e detyrave karakteristike të shërbimit civil nga individët të punësuar mbi baza të përkohshme është përjashtim	1/2
Nëpunësit civilë mendojnë që emërimet e përkohshme në administratë bazohen në meritë	1/2
Nëpunësit civilë mendojnë se rregullat zyrtare për emërimet e përkohshme zbatohen në praktikë	1/2
Nëpunësit civilë mendojnë se individët e punësuar përkohësisht bëhen nëpunës civilë pas përfundimit të kontratës së përkohshme	1/2
Nëpunësit civilë mendojnë që kontratat për angazhime të përkohshme zgjaten mbi një vit	1/2
Rezultatet e përgjithshme	28/6
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)⁷⁰	1

Ky tregues vlerëson kriteret ligjore për angazhime të përkohshme në administratën qendrore. Angazhimet e përkohshme i referohen punësimit të përkohshëm në administratën qendrore për të kryer detyra të ngjashme në natyrë me ato që kryen nga nëpunësit civilë.⁷¹ Legjislacioni shqiptar përcakton dy lloje të angazhimeve të përkohshme të punonjësve që kryejnë detyra të ngjashme me shërbimin civil: (1) punonjës me kontratë afatshkurtër, që punojnë në administratën qendrore⁷² dhe (2) kontratat e shërbimit publik të një natyre intelektuale ose këshilluese⁷³. Treguesi mat më tej perceptimet e nëpunësve civilë për përdorimin e angazhimeve të përkohshme në administratën qendrore.

Legjislacioni shqiptar nuk e kufizon numrin e punonjësve të përkohshëm në lidhje me numrin e përgjithshëm të nëpunësve civilë në administratën qendrore. Megjithatë vendimet e Këshillit të Ministrave specifikojnë kufijtë vjetorë të punonjësve sipas dispozitave të kontratës së përkohshme, ai kufi ndryshon shpesh. VKM nr. 47, datë 22.01.2020 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore" specifikon kufijtë vjetorë të punonjësve sipas dispozitave të kontratës së përkohshme, por ky kufi është rritur nga 1,427 në 2,597 punonjës përgjatë vitit. Për më tepër, ai nuk përfshin kriteret specifike për të vlerësuar punonjësit e mundshëm për angazhime të tilla.

Në mënyrë të ngjashme, VKM nr. 109, datë 6.3.2019 "Për vendosjen e standardeve në kryerjen e disa aktiviteteve me punonjës të përkohshëm, në njësitë e qeverisjes qendrore" përshkruan llojin e pozicioneve për angazhime të përkohshme, por nuk përfshin kriteret për punësim. Këto kriteret përcaktohen nëpërmjet urdhrave të

70 Konvertimi i pikëve: 0-4 pikë = 0; 5-9 pikë = 1; 10-14 pikë = 2; 15-19 pikë = 3; 20-24 pikë = 4; 25-28 pikë = 5.

71 Punonjësit e shërbimeve të përgjithshme janë të përjashtuar.

72 Pika 5, Neni 16, Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2012/09/27/90>.

73 Ligji për Prokurimin Publik përfshin një dispozitë për shërbimet e këshillimit, të cilat përcaktohen si 'kontrata të shërbimeve publike të një natyre intelektuale ose këshilluese' në ligj. <http://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/ligji/>.


përbashkët midis ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucioneve përkatëse të qeverisë qendrore. Ndërkohë, institucionet e qeverisë qendrore nuk publikojnë thirrje për vende të lira pune për angazhime të përkohshme që nuk klasifikohen si “kontrata shërbimi”, pasi nuk u kërkohej të publikojnë thirrje të tilla nga legjislacioni në fuqi.

Angazhimet e përkohshme nëpërmjet kontratave të këshillimit publikohen nëpërmjet Agjencisë së Prokurimit Publik dhe duhet të përfshijnë objektin e kontratës, referencën e procedurës së prokurimit, shpërbimin, kohëzgjatjen, përshkrimin e shkurtër të kontratës, termat e referencës dhe afatin e fundit për dorëzimin e propozimeve. Ato përcaktohen si “kontrata të shërbimeve publike të një natyre intelektuale ose këshilluese” në Ligjin për Prokurimit Publik dhe rregullohen nëpërmjet VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nuk ka afate ligjore të përcaktuara për kontrata të tilla, por kohëzgjatja e kontratës përfshihet në thirrjen e kontratës së shërbimit. Kriteret për përzgjedhjen e konsulentëve të mundshëm përfshijnë: (i) përvojën e konsulentit, (ii) cilësinë e metodologjisë së propozuar, (iii) kualifikimin e stafit që do të përfshihet, (iv) transferimin e njohurive (nëse kërkohej)⁷⁴. Sidoqoftë është e paqartë se cilat janë kriteret specifike, përkatësisht përvoja minimale e punës që duhet të merret parasysh ose natyra e kualifikimit të personelit. Thirrjet e kontratës së shërbimit të botuara në Buletinin e Njoftimeve Publike nuk përfshijnë përshkrimin e kontratës, termat e referencës, kërkesat e kualifikimit dhe procedurën e përzgjedhjes.

■ Përmbledhje e rezultateve të sondazheve

Pavarësisht nga dispozitat e pamjaftueshme ligjore që rregullojnë kohëzgjatjen dhe punësimin për angazhime të përkohshme, përgjigjet nga sondazhi⁷⁵ i nëpunësve civilë tregojnë se ekzistojnë rregullore të brendshme që zbatohen nga institucioni i tyre. Vetëm 30.0% e nëpunësve civilë pohojnë se punësimi i individëve në baza të përkohshme (me afat të caktuar, shërbime dhe kontrata të tjera të përkohshme) përbën përjashtim në institucionin e tyre.

Grafiku 10. Perceptimet e nëpunësve civilë për angazhimet e përkohshme.



⁷⁴ Neni 37, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, <http://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=303a2377-25d3-450c-9a4c-e63638e45a27>.

⁷⁵ Kampioni i sondazhit ishte N = 975 ndërsa baza për pyetjet në këtë tregues ishte n = 892. Përgjigjet u matën nga niveli i miratimit të deklaratave specifike.

Punonjësit e punësuar përkohësisht nuk bëhen nëpunës civilë pas përfundimit të angazhimeve të tyre të përkohshme, sipas 30.3% të nëpunësve civilë. Pothuajse e njëjta përqindje (30.2) thonë se nuk e di, ose nuk kanë dashur të përgjigjen.

Sipas 46.2% të nëpunësve civilë, punonjësit e përkohshëm zgjidhen bazuar në kualifikimet dhe aftësitë e tyre. Ndërkohë, 25.1% ose nuk e dinë ose nuk kanë dashur të përgjigjen.


Lidhur me zgjatjen e kontratave të përkohshme, 46.7% e nëpunësve civilë pohojnë se ata "rrallë" ose "kurrë, ose pothuajse kurrë" nuk zgjaten për më shumë se një vit, ndërsa 28.6% ose nuk e dinin ose nuk donin të përgjigjeshin.

Për sa i përket shtrirjes së angazhimit të punonjësve të përkohshëm, 43.5% e nëpunësve civilë pohojnë se individët të punësuar përkohësisht nuk kryejnë detyra të cilat normalisht duhet të kryhen nga nëpunësit civilë.

Ndryshimet e shpeshta të kufirit të numrit të punonjësve të qeverisë më kontrata të përkohshme japin përshtypjen e mungesës së planifikimit të duhur për nevojat institucionale dhe ofrimin e shërbimeve.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi SHPMBNJ P2 I2: Kryerja e detyrave karakteristike të shërbimit civil jashtë rregullave të shërbimit civil të bazuar në meritë



PARIMI 3: REKRUTIMI I NËPUNËSVE PUBLIKË BAZOHET NË MERITË DHE TRAJTIM TË BARABARTË NË SECILËN PREJ FAZAVE TË TIJ; KRITERET PËR ULJE NË DETYRË DHE ZGJIDHJEN E KONTRATËS SË NËPUNËSVE PUBLIKË JANË TË QARTA

Tabela 10. Treguesi WeBER SHPMBNJ P3 I1: Hapja, transparencja dhe paanshmëria e rekrutimit në shërbimin civil

Elementet e treguesit	Rezultatet
Informacioni për konkursat publike bëhet gjerësisht i disponueshëm për publikun	2/4
Njoftimet për konkursat publike shkruhen në një gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe të kuptueshme	2/4
Gjatë procedurës së konkursit publik, kandidatët e interesuar mund të kërkojnë dhe marrin sqarime, të cilat bëhen të disponueshme për publikun	0/4
Nuk ka pengesa të paarsyeshme për kandidatët e jashtëm, që i bëjnë konkursat publike më të lehta për kandidatët e brendshëm	2/2
Procedura e aplikimit përmban ngarkesë minimale administrative dhe të dokumentacionit për kandidatët	2/4
Kandidatët lejohen dhe ftohen të plotësojnë dokumentacionin që mungon brenda një afati kohor të arsyeshëm	2/4
Vendimet dhe arsyetimet e paneleve të përzgjedhjes bëhen të disponueshme për publikun, duke respektuar sa duhet mbrojtjen e informacionit personal	2/4
Informacioni në lidhje me njoftimet e anuluar bëhet i disponueshëm publikisht, shoqëruar me arsyetim	0/4
Nëpunësit civilë i perceptojnë rekrutimet në shërbimin civil si të bazuara në meritë	1/2
Nëpunësit civilë e perceptojnë procedurën e rekrutimit si procedurë që siguron mundësi të barabarta	2/2
Publiku i percepton rekrutimet e bëra nëpërmjet procesit të konkursit publik si të bazuara në meritë	0/2
Rezultatet e përgjithshme	15/36
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)⁷⁶	2

Ky tregues mat kriteret për rekrutimin dhe uljen në detyrë të nëpunësve civilë duke shqyrtuar dispozitat përkatëse në legjisllacionin e shërbimit civil, që rregullojnë procedurat e rekrutimit dhe kriteret për uljen në detyrë. Për të vlerësuar transparencën dhe meritokracinë e procesit të rekrutimit, ne shqyrtuam pesë konkurse publike të përfunduara për vendet e punës në shërbimin civil për viti i parapriu monitorimit, d.m.th. 2019. Shpalljet e konkursit u përzgjedhën nga pesë autoritete të ndryshme të administratës shtetërore: një ministri e madhe, një ministri e mesme, një ministri e vogël dhe dy agjenci qendrore të administratës shtetërore (organizma të posaçme, zyra, shërbime shtetërore, etj.). Vetëm institucionet dhe pozicionet që i nënshtrohen Ligjit për Nëpunësin Civil u morën parasysh.

Vumë re se njoftimet për vendet e lira të punës publikohen kryesisht në portalin e Departamentit të Administratës Publike. Institucionet e përzgjedhura⁷⁷ ose nuk kishin një seksion përkatës për shpalljet e vendeve të lira të punës në faqen e tyre të internetit, ose lidhja elektronike që ata ofronin çonte në faqen e internetit të DAP. Njoftimet janë përgjithësisht të qarta dhe pjesa e përshkrimit të punës rendit përgjegjësitë për pozicionin. Kriteret e vlerësimit për secilin pozicion përfshijnë pjesën e rezultatit për testin me shkrim, intervistën dhe jetëshkrimin e kandidatit, por njoftimet nuk shpjegojnë më tej metodologjinë. Sidoqoftë, vendoset një lidhje elektronike me një udhëzim të DAP-it që detajon kriteret e vlerësimit.⁷⁸

76 Konvertimi i pikëve: 0-6 pikë = 0; 7-12 pikë = 1; 13-18 pikë = 2; 19-24 pikë = 3; 25-30 pikë = 4; 31-36 pikë = 5.

77 Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Agjencia e Përpunimit të Koncesioneve.

78 Udhëzimi i DAP nr. 2, datë 27.3.2015, <http://www.dap.gov.al/legjisllacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

Procesi i konkurrimit për të gjithë pozicionet e shërbimit civil përfshin dy faza: (a) verifikimin paraprak të kandidatëve për të siguruar përmbushjen e kërkesave bazë dhe (b) vlerësimin e kandidatëve që plotësojnë kërkesat bazë. Kandidatët e skualifikuar për mospërmbushjen e kërkesave bazë pas procesit paraprak të verifikimit mund të kërkojnë sqarime të mëtejshme dhe të kërkojnë të paraqesin dokumente shtesë. Kandidatët e pasuksesshëm për pozicionet në nivel ekzekutiv, të ulët, të mesëm dhe TND mund t'i paraqesin të tilla kërkesa dhe dokumente DAP-it brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit.⁷⁹

Vendet e lira të punës plotësohen së pari nëpërmjet konkurseve të brendshme (lëvizje paralele, ose ngritje në detyrë) brenda shërbimit civil për nivelin ekzekutiv, të ulët dhe të mesëm. Nëse vendet vakante nuk plotësohen nëpërmjet konkurseve të brendshme, konkursi është i hapur për kandidatët jashtë shërbimit civil.⁸⁰ Për pozicionet në TND, konkursat zhvillohen ose për t'u pranuar për të kryer programin e thelluar të ASPA-s – dhe për t'u emëruar më pas në një pozicion TND pas përfundimit të trajnimit – ose për t'u pranuar direkt në TND, pas të cilit atyre u kërkohet të marrin pjesë në programin e thelluar të trajnimit të ASPA-s. Procesi i konkurrimit për pozicione në TND nëpërmjet pranimit në programin e ASPA-s është i hapur për kandidatët jashtë shërbimit civil, por vetëm 20% e vendeve të lira janë në dispozicion të atyre kandidatëve, ndërsa 80% e tyre u caktohen nëpunësve civilë.⁸¹ Sidoqoftë, kjo procedurë faktikisht nuk është përdorur dhe vendet e lira TND janë plotësuar nëpërmjet konkurseve të drejtpërdrejta, të cilat janë të hapura për kandidatët jashtë shërbimit civil.

Neni 27 i Ligjit për Nëpunësin Civil lejon rekrutimin e drejtpërdrejtë të nëpunësve civilë të lartë, derisa grupi i parë të jetë diplomuar nga ASPA, ose kur numri i të diplomuarve nga ASPA nuk plotëson nevojat për pozicione TND.⁸² Sidoqoftë, VKM-ja që rregullon procesin e rekrutimit për pozicionet TND nënvizon se pasi të jenë emëruar në pozicione TND, kandidatët e suksesshëm do të duhet të përfundojnë programin e thelluar të trajnimit të ASPA-s.⁸³ Megjithatë, kërkesa që nëpunësit civilë të pranuar në TND t'i nënshtrohen programit të thelluar të trajnimit nuk është zbatuar që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Nëpunësin Civil, sepse programi është ende në fazën e pilotimit.

Legjislacioni i shërbimit civil kërkon që rezultatet e konkursit dhe vendimet përfundimtare të publikohen në faqen e internetit të DAP-it dhe në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Sidoqoftë, nuk ka kërkesa për arsyetimin e vendimit që do të publikohet. Nuk ka gjithashtu asnjë dispozitë për të mandatuar botimin e anulimit të njoftimeve.

■ Përmbledhje e rezultateve të sondazheve

Nëpunësit civilë⁸⁴ iu përgjigjën pyetjeve për perceptimet e tyre për meritokracinë dhe transparencën e procesit të rekrutimit.⁸⁵ Sipas 46.8% të nëpunësve civilë, nuk janë të nevojshme lidhjet (personale) për të marrë një punë në shërbimin civil në institucionin e tyre; 63.2% pohojnë se nëpunësit civilë në institucionin e tyre rekrutohen në bazë të kualifikimeve dhe aftësive.⁸⁶ Lidhur me trajtimin e barabartë të kandidatëve në procesin e rekrutimit, sipas 72.6% të nëpunësve civilë, në institucionin e tyre të gjithë kandidatët trajtohen në mënyrë të barabartë.⁸⁷

79 Shih Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjet paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", ndryshuar me VKM Nr. 746, datë 19.12.2018, <http://dap.gov.al/legjislacioni/per-sherbimin-civil>; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira të punës për pozicione drejtuese të nivelit të ulët dhe të mesëm", ndryshuar me VKM Nr. 748, datë 19.12.2018, <http://dap.gov.al/legjislacioni/per-sherbimin-civil>; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 5.3.2014 "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të punës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së", ndryshuar me VKM nr. 388, datë 6.5.2015, <https://bit.ly/3bCucLU>.

80 Për secilin nga këto kategori të shërbimit civil, shih nenet 22-26 të Ligjit për Nëpunësin Civil, <http://dap.gov.al/legjislacioni/per-sherbimin-civil>.

81 Kapitulli IV, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 5.3.2014 "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të punës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së", ndryshuar me VKM nr. 388, datë 6.5.2015.

82 Neni 27, Pika 5, Ligji për Nëpunësin Civil.

83 Kapitulli VI, Paragrafi 4, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 5.3.2014.


84 Kampioni për sondazhin e perceptimit publik ishte N = 1007 të anketuar nga Shqipëria e moshës mbi 18 vjeç, baza për pyetjen është n = 1007.

85 Kampioni për sondazhin e nëpunësve civilë ishte N = 975; baza për pyetjet në këtë tregues ishte n = 975.

86 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultatet ishin përkatësisht 44% dhe 63.7%.


87 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 67.9%.

Grafiku 11. Perceptimet e nëpunësve civilë për meritokracinë e procesit të rekrutimit.



Pavarësisht këtyre perceptimeve relativisht pozitive të nëpunësve civilë, vetëm 26.3% e publikut shqiptar pohon se rekrutimi i nëpunësve publikë bazohet në meritë.⁸⁸


Grafiku 12. Perceptimet publike për meritokracinë e rekrutimit të nëpunësve civilë.



Ekziston një ndryshim i rëndësishëm midis perceptimeve të publikut të gjerë dhe nëpunësve civilë për integritetin dhe natyrën meritokratike të rekrutimit të nëpunësve civilë. Kjo mund të vijë për shkak të mungesës së informacionit nga publiku ose anshmëria e nëpunësve civilë.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi SHPMBNJ P5 I1: Transparenca, qartësia dhe disponueshmëria publike e informacionit për sistemin e shpërblyerit në shërbimin civil



88 Në ciklin e fundit të monitorimit, kjo përqindje ishte 35.2%.

PARIMI 4: NDIKIMI I DREJTPËRDREJTË OSE INDIREKT POLITIK NË NIVELIN E LARTË DREJTUES NË SHËRBIMIN PUBLIK PARANDALOHET

Tabela 11. Treguesi WeBER SHPMBNJ P411: Mbrojtja efektive e pozicionit të nëpunësve të lartë civilë nga ndërhyrjet e padëshiruara politike

Elementet e treguesit	Rezultatet
Ligji parashikon procedura konkurruese, të bazuara në meritë, për përzgjedhjen e nëpunësve të nivelit të lartë në shërbimin civil	2/2
Ligji përshkruan kriteret objektive për përfundimin e punësimit të nëpunësve të lartë civilë	2/2
Rekrutimi i bazuar në meritë i nëpunësve të lartë civilë zbatohet në mënyrë efektive në praktikë.	2/4
Drejtuesit e përkohshëm në nivelin e lartë të shërbimit civil mund dhe emërohen me ligj, vetëm nga radhët e shërbimit civil për një periudhë maksimale të kufizuar me ligj	0/4
Raporti midis kandidatëve të kualifikuar për vendet e lira të nivelit të lartë të shërbimit civil	0/4
Nëpunësit civilë konsiderojnë që procedurat për emërimin e nëpunësve të lartë civilë sigurojnë që vendet e punës t'i marrin kandidatët më të mirë	1/2
OSHC-të perceptojnë që procedurat për emërimin e nëpunësve të lartë civilë sigurojnë që vendet e punës t'i marrin kandidatët më të mirë	0/2
Nëpunësit civilë perceptojnë që nëpunësit e lartë civilë emërohen bazuar në mbështetjen politike	1/2
Ekzistenca e procedurave të verifikimit ose shqyrtimit për emërimet e nëpunësve të lartë civilë jashtë fushës së legjislacionit të shërbimit civil	2/2
Nëpunësit civilë konsiderojnë që nëpunësit e lartë civilë nuk zbatohen dhe mund t'i refuzojnë në mënyrë të efektshme urdhrat e paligjshëm të eporëve politikë	1/2
Nëpunësit civilë konsiderojnë se pozitat e larta të shërbimit civil nuk janë subjekt i marrëveshjeve politike dhe "ndarjes së tortës" mes partive politike në pushtet	1/2
Nëpunësit civilë perceptojnë që nëpunësit e lartë civilë nuk largohen nga detyra për motive politike	1/2
Nëpunësit civilë konsiderojnë që kriteret për shkarkimin e nëpunësve të lartë publikë zbatohen siç duhet në praktikë	0/2
OSHC-të konsiderojnë që nëpunësit civilë të nivelit të lartë menaxherial profesionalizohen në praktikë	0/2
Nëpunësit civilë perceptojnë që nëpunësit e lartë civilë nuk marrin pjesë në fushata elektorale të partive politike	1/2
Pjesa e emërimeve pa procedurë konkurruese (duke përfshirë pozicionet të përkohshme jashtë fushës së shërbimit publik) nga numri i përgjithshëm i emërimeve në pozitat e larta drejtuese të shërbimit civil	4/4
Rezultatet e përgjithshme	18/40
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)⁸⁹	2

Ndërhyrja politike në pozitat e larta drejtuese vlerësohet duke shqyrtuar kornizën legjislative dhe procesin dhe rezultatet e rekrutimit të fundit të pozicioneve TND. Gjetjet plotësohen me rezultatet nga sondazhet me nëpunësit civilë dhe OSHC-të. Metodologjia për elementet nr.1-3 dhe nr. 5 bazohet në kriteret e vlerësimit të SIGMA-s.

Kuadri legjislativ është i përshtatshëm për të siguruar një proces konkurrues të bazuar në meritë dhe jo-diskriminues për vendet e lira të nëpunësve të lartë civilë. Kriteret e rekrutimit për pozicionet TND janë të bazuara në meritë dhe jo-diskriminuese.

Shpalljet për vendet e lira të punës publikohen në përputhje me planin vjetor të rekrutimit, pas vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e numrit të vendeve të lira të punës. Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes, i cili përfshin nëntë anëtarë, vlerëson kandidatët. Komiteti drejtohet nga drejtori i DAP-it dhe anëtarët e tjerë

⁸⁹ Konvertimi i pikëve: 0-7 pikë = 0; 8-14 pikë = 1; 15-21 pikë = 2; 22-28 pikë = 3; 29-34 pikë = 4; 35-40 pikë = 5

përfshijnë drejtorin e ASPA-s, një anëtar nga fusha akademike i emëruar për një mandat dy-vjeçar nga ASPA pas një konkursi të hapur, një nëpunës i lartë civil i zgjedhur rastësisht për një mandat dy-vjeçar dhe pesë anëtarë të tjerë nga fusha akademike të emëruar nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet një procesi të hapur konkurrues (kohëzgjatja e mandatit e paqartë).⁹⁰ Anëtarët nga fusha akademike nuk duhet të kenë qenë anëtarë të partive politike në tre vitet e fundit, përpara emërimit të tyre në Komision. Pas marrjes së vendimit nga Komisioni nuk ka asnjë proces shtesë verifikimi administrativ apo politik. Për më tepër, Ligji për Nëpunësin Civil ndalon nëpunësit e lartë civilë të jenë anëtarë të një partie politike. Pavarësisht këtyre dispozitave shumë të rëndësishme, abuzimi i vazhdueshëm e i dokumentuar i burimeve shtetërore – duke përfshirë burimet njerëzore – nga partitë në pushtet gjatë zgjedhjeve parlamentare tregon se ato mund të forcohen më tej.⁹¹

Shqipëria përdor një proces rekrutimi në grup për nëpunësit e lartë civilë. Kjo do të thotë që kandidatët për pozicionet TND nuk aplikojnë për një vend të lirë specifik, por për të gjitha vendet e lira të punës. Njoftimet për vendet e lira për pozicionet TND nuk përfshijnë pozicionet specifike dhe institucionet përkatëse.⁹² Kandidatët e mundshëm për TND mund të regjistrohen në portalin e DAP, por portali nuk ofron një mundësi për t'u abonuar për njoftimet e reja dhe ata duhet t'i paraqesin dokumentet e tyre personalisht në DAP⁹³. Në fund të procesit të përzgjedhjes, kandidatët renditen dhe emërohen në përputhje me renditjen përfundimtare.

Lista e kandidatëve të suksesshëm publikohet, por jo rezultatet e renditjes së tyre.⁹⁴ Lista e kandidatëve të suksesshëm më pas u dorëzohet institucioneve në mënyrë që ato të mund të përzgjedhin kandidatin për secilin prej vendeve të lira përkatëse të punës.⁹⁵

Deri në nëntor 2020, ishin emëruar 118 nëpunës të lartë civilë dhe të gjithë ata janë emëruar nëpërmjet një procedure konkurruese.⁹⁶ Kjo është e lavdërueshme veçanërisht kur krahasohet me vendet e tjera në rajon që kanë procedura shtesë të verifikimit pas konkursit të pranimit⁹⁷; megjithatë, është e vështirë të vlerësohet nëse një nga tre kandidatët më të mirë ose kandidati më i mirë është caktuar në një pozicion TND – sipas kriterëve metodologjike për këtë tregues. Kjo pasi DAP-i publikon listën e kandidatëve të suksesshëm, e cila përfshin vetëm emrat e tyre dhe nuk publikon listën e të gjithë kandidatëve që kanë fituar më shumë se 70 pikë, si dhe rezultatet e tyre përkatëse.⁹⁸ Rrjedhimisht nuk është e mundur të kryhen krahasimet dhe verifikimet e nevojshme.

Sidoqoftë, vlen të theksohet një praktikë mjaft pozitive në procedurën e renditjes: përkatësisht, kur dy kandidatë kanë të njëjten rezultat, por njëri prej tyre është grua ose person me aftësi të kufizuara, ajo/ai renditet më lart se kandidati tjetër.⁹⁹

Rekrutimi në grup është sigurisht një proces më i lehtë për t'u kryer dhe natyra e tij e qendërsuar e bën më të lehtë monitorimin, por nuk merr parasysh ekspertizën në politikat publike të nevojshme për një pozicion të caktuar. Institucionet ku duhet të plotësohen vendet e lira nuk publikohen dhe kriteret e rekrutimit janë rrjedhimisht të përgjithshme. Pra, ato nuk janë të orientuara drejt politikave përkatëse për të cilat institucioni

90 Kapitulli II, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 5.3.2014.

91 Shih raportet e vitit 2009, 2013 dhe 2017 të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). ODIHR, Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë 28 Qershor 2009: Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR (Varshavë: ODIHR, 2009), <https://www.osce.org/files/f/documents/9/8/38597.pdf>; ODIHR, Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë 23 Qershor 2013: Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR (Varshavë: ODIHR, 2013), <https://www.osce.org/files/f/documents/e/2/106963.pdf>; ODIHR, Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë 25 Qershor 2017: Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR (Varshavë: ODIHR, 2017), <https://www.osce.org/files/f/documents/4/d/346661.pdf>.

92 Njoftimi për vendet e lira TND për vitin 2019 përfshin vetëm kriteret e rekrutimit ndërsa numri i vendeve të lira përfshihet në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave. Shih "Njoftimi për pranim të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND)", http://dap.gov.al/images/Tnd/2019-04-20%20TND_shpallje%20final.pdf dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 215, datë 17.4.2019 "Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, edhe për kandidatët jashtë Shërbimit Civil, dhe për përdorimin e pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2019", <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/04/17/215>.

93 Informacion i siguruar nga DAP më 5 mars 2021 nëpërmjet postës elektronike.

94 Shih "Njoftim mbi shpalljen e listës përfundimtare të fituesve për procedurën e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND)", <http://dap.gov.al/images/Tnd/2019-30-06TND-Lista-Perfundimtare.pdf>.

95 Seksioni IV, Pika E, Udhëzimi i DAP-së nr. 6, datë 19.09.2014 "Për procesin e rekrutimit dhe të emërimit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND", i ndryshuar, <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/58-udhezim-nr-6-date-19-09-2014>.

96 Përgjigje e informacionit të kërkuar nga DAP, marrë më 26 nëntor 2020.

97 Shih Miloš Dindić et al, Western Balkans PAR Monitor 2019/2020 (European Policy Centre - CEP: Beograd, 2021), 96, <https://bit.ly/3AKF6LZ>.

98 Sidoqoftë, DAP publikon listën e kandidatëve të verifikuar paraprakisht. Shih "Njoftim për rezultatet e verifikimit pararak për pranimin e drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND)", http://dap.gov.al/images/Tnd/TND_Lista_Paraprake.pdf.

99 Kapitulli IV, paragrafi 18, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 5.3.2014.

është përgjegjës. Mospërfshirja e kriterëve në lidhje me ekspertizën politike të nevojshme paraqet rrezik të shtuar politik dhe në drejtim të hartimit të politikave publike të suksesshme, pasi nëpunësit e lartë civilë mund të emërohen në çdo institucion të qeverisë qendrore bazuar në lidhje politike, pavarësisht nga ekspertiza ose mungesa e saj.¹⁰⁰

Kriteret për shkarkimin nga shërbimi i lartë civil janë objektive dhe jodiskriminuese. Ato përfshijnë anëtarësimin në parti politike, (ii) përfundimin pa sukses të trajnimit të ASPA-s, (iii) dy vlerësime të njëpasnjëshme 'jo të kënaqshme' (pas 24 muajsh), (iv) një situatë të vazhdueshme konflikti interesi për të cilën nëpunësi civil nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta zgjidhur, (v) ristrukturimin institucional (nëse nuk është e mundur emërimi në një pozicion tjetër), (vi) dorëheqjen e vullnetshme, (vii) paaftësi shëndetësore dhe (ix) raste të tjera të përcaktuara me ligj.¹⁰¹


Lidhur me caktimin e përkohshëm të nëpunësve civilë të lartë në një pozicion përkohësisht i lirë, Nenet 14 dhe 15 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore rregullojnë kushtet në të cilat mund të bëhen emërimet të tilla. Pozicioni i drejtorit të përgjithshëm në rast mungese afatshkurtër zëvendësohet përkohësisht nga më i vjetri i drejtorëve brenda drejtorisë së përgjithshme. Në mënyrë të ngjashme, në rast të një mungese afatshkurtër në pozicionin e sekretarit të përgjithshëm, caktohet përkohësisht më i vjetri i drejtorëve të përgjithshëm. Këto dispozita sigurojnë që caktimet e përkohshme të kryhen në përputhje me Ligjin për Nëpunësin Civil duke siguruar që zyrtarët të jenë nëpunës civilë; megjithatë, kohëzgjatja e këtyre detyrave të përkohshme nuk është e kufizuar ligjërisht.

■ Përmbledhje e rezultateve të sondazheve

Nëpunësit civilë¹⁰² dhe OSHC-të¹⁰³ iu përgjigjën pyetjeve për kriteret e rekrutimit dhe emërimet e nëpunësve civilë. Ka dallime të dukshme midis këtyre dy grupeve, megjithëse krahasimet midis tyre nuk mund të kryen për të gjitha pyetjet.

Sipas 49.8% të nëpunësve civilë procedurat për emërimin e nëpunësve të lartë civilë sigurojnë emërimin e kandidatëve më të mirë. Anasjelltas, vetëm 7.1% e OSHC-ve janë të të njëjtit mendim.¹⁰⁴ Përafërsisht 57% mendojnë se procedura të tilla nuk sigurojnë emërimin e kandidatëve më të mirë, ndërsa 27% ishin neutralë..

Grafiku 13. Perceptimi i OSHC-ve përkundër nëpunësve civilë për procedurat e emërimit të nëpunësve të lartë civilë.



100 Përfshirja e kriterëve në lidhje me ekspertizën e nevojshme në fushën politike përkatëse do të siguronte që nëpunësit civilë të nivelit të mesëm ose një kandidat i jashtëm, të cilët kanë ekspertizë në një fushë të caktuar politikash publike, të emërohen në përputhje me ekspertizën e tyre. Aktualisht, një kandidat i suksesshëm me ekspertizë për politikën e energjisë mund të caktohet në një vend të lirë të TND-së në ministrinë e Arsimit ose të Bujqësisë.

101 Kapitulli XII, Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil".


102 Kampioni për sondazhin e nëpunësve civilë ishte N = 975, ndërsa baza për pyetjet në këtë tregues ishte n = 821. Përgjigjet u matën nga niveli i dakordësisht me deklaratat specifike, nëpërmjet një pyetësoi të vetadministruar.

103 Kampioni për anketimin e OSHC-ve ishte N = 81 të anketuar nga OSHC-të, të anketuar nëpërmjet një pyetësoi të vetadministruar. Baza për këto pyetje ishte n = 70.

104 Në ciklin e fundit të monitorimit rezultatet për nëpunësit civilë dhe OSHC-të ishin përkatësisht 47.8% dhe 15.9%.

Lidhur me ndikimin e mbështetjes politike në emërimet e nëpunësve të lartë civilë, 35.8% e nëpunësve civilë perceptojnë se ata nuk janë “kurrë ose pothuajse kurrë” ose “rrallë” të emëruar në mënyrë të njëanshme për shkak të mbështetjes politike.¹⁰⁵ Përafërsisht 29.3% e tyre pohojnë se kjo ndodh “ndonjëherë” ose “shpesh”. Në mënyrë të ngjashme, 40.9% e nëpunësve civilë pohojnë se emërimet në shërbimin e lartë civil nuk janë pjesë e marrëdhënieve ndërqeveritare midis partive politike në qeverinë e koalicionit¹⁰⁶; 17.4% janë neutralë, ndërsa 20.7% nuk e dinin. Anasjelltas, vetëm 8.6% e OSHC-ve pohojnë se nëpunësit e lartë civilë janë profesionistë në praktikë.¹⁰⁷ Përafërsisht, 42.8% e tyre nuk janë dakord, ndërsa 41.4% janë neutralë në lidhje me këtë pohim.


Grafiku 14. Perceptimet e nëpunësve civilë dhe OSHC-ve për ndikimin politik në emërimin e nëpunësve të lartë civilë.



Për pjesëmarrjen e nëpunësve të lartë civilë në fushatat elektorale të partive politike, 32.4% e nëpunësve civilë perceptojnë se nëpunësit e lartë civilë në institucionin e tyre nuk kishin marrë pjesë “asnjëherë, ose pothuajse asnjëherë” në fushata elektorale¹⁰⁸; 37.5% u përgjigjën se nuk e dinë.

Lidhur me shkarkimet e nëpunësve të lartë civilë, 42.4% e nëpunësve civilë perceptojnë se nëpunësit e lartë civilë nuk largohen për motive politike;¹⁰⁹ 33.3% nuk e dinin. Sidoqoftë, vetëm 27.3% e nëpunësve civilë konsiderojnë se rregullat dhe kriteret zyrtare për shkarkimin e nëpunësve të lartë civilë zbatohen siç duhet në praktikë;¹¹⁰ 35.2% u përgjigjën se nuk e dinë.

Grafiku 15. Perceptimet e nëpunësve civilë për shkarkimet dhe pjesëmarrjen e nëpunësve të lartë civilë në fushata elektorale.



105 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 32%.

106 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 35.9%.


107 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 22.7%.

108 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 31.5%.

109 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 39.8%.

110 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 26.5%.


Nëpunësit civilë u pyetën nëse ata janë nën presion për të kryer veprime të paligjshme në institucionin e tyre dhe nëse ata mund të refuzojnë kryerjen e veprimeve të tilla pa rrezikuar pozicionin e tyre. Për pyetjen e parë, 51.8% e nëpunësve civilë konsiderojnë se në institucionin e tyre nëpunësit e lartë civilë nuk do të kryenin veprime të paligjshme, nëse eprorët politikë do t'ua kërkonin ta bënin këtë, ndërsa 39.7% konsiderojnë se nëpunësit e lartë civilë mund të refuzojnë një urdhër të paligjshëm nga një ministër ose nga një epror tjetër politik pa rrezikuar pozicionin e tyre.¹¹¹



Ndërsa rezultatet e sondazhit për nëpunësit civilë janë në përputhje me ciklin e fundit të monitorimit dhe tregojnë një rritje të lehtë, rezultatet nga sondazhi i OSHC-ve tregojnë një ulje të perceptimit se rekrutimi i nëpunësve të lartë civilë është meritokratik. Mungesa e dokumentacionit nga konkursi i vitit 2019 për pozicionet e TND ka ndikuar negativisht në rezultatin për elementin nr. 5 dhe, rrjedhimisht, për të gjithë treguesin.

Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi SHPMBNJ P4 I1: Mbrojtja efektive e pozicionit të nëpunësve të lartë civilë nga ndërhyrjet e padëshiruara politike



111 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultatet ishin përkatësisht 48.4% dhe 36.2%.

PARIMI 5: SISTEMI I PAGAVE TË NËPUNËSVE PUBLIKË BAZOHET NË KLASIFIKIMIN E VENDIT TË PUNËS; AI ËSHTË I DREJTË DHE TRANSPARENT

Tabela 12. Treguesi WeBER SHPMBNJ P5 I1: Transparenca, qartësia dhe disponueshmëria publike e informacionit për sistemin e pagave të shërbimit civil

Elementet e treguesit	Rezultatet
Sistemi i pagave të shërbimit civil është i strukturuar në mënyrë të thjeshtë	2/4
Sistemi i pagave/shpërblimeve të shërbimit civil parashikon mundësi të kufizuara dhe të përcaktuara qartë për shtesat e pagave mbi pagën bazë	4/4
Informacioni për sistemin e pagave të shërbimit civil vihet në dispozicion në internet	4/6
Në internet janë në dispozicion për qytetarët shpjegime ose prezantime të kuptueshme me informacion për pagat në shërbimin civil	0/2
Shtesa fakultative janë të kufizuara nga legjislacioni dhe nuk mund të përfshijnë një pjesë të madhe të pagës/shpërblimit të një nëpunësi civil	4/4
Nëpunësit civilë mendojnë se shpërblimet përdoren për qëllimin e tyre të synuar të nxitjes dhe shpërblimit të performancës dhe jo për favorizimin politik apo personal	1/2
Rezultatet e përgjithshme e përgjithshme	15/22
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)¹¹²	3

Ky tregues mat nëse sistemi i pagave në shërbimin civil përshkruhet qartë, në mënyrë të drejtë dhe transparente në legjislacion. Rezultati llogaritet duke marrë parasysh edhe perceptimet e nëpunësit civil.¹¹³

Struktura bazë e pagave kategorizohet thjeshtësisht, por rregullat dhe përcaktimet për llogaritjen e shtesave paraqesin përjashtime të bazuara në përkatësinë institucionale.¹¹⁴ Për më tepër, llogaritja e shtesave nuk bazohet në një sistem të qartë dhe të standardizuar, me anë të të cilit vështirësia në vendin e punës dhe natyra specifike e punës që do të kryhet përcaktohet qartë dhe zbatohet në praktikë. DAP-i ka punuar për të reformuar sistemin e pagave dhe ka përgatitur një dokument për ta reformuar, i cili është drejt miratimit.¹¹⁵ Legjislacioni nuk përfshin shpërblime: as në ligjin e buxhetit, as në ligjin e pagave.

Shtesat për punën jashtë orarit ndahen në tri kategori: (i) punë jashtë orarit gjatë natës (1900-0600), (ii) punë jashtë orarit gjatë ditës (deri në ora 1900), dhe (iii) punë jashtë orarit gjatë pushimeve dhe fundjavave. Kompensimi ndahet në dy grupe: (i) 50% kohë pushimi shtesë për kohën e punës ose 50% kompensim shtesë financiar të pagës së rregullt për punë gjatë fundjavës, pushimeve zyrtare dhe nga 2200 në 0600 gjatë ditëve të punës; (ii) 25% kohë pushimi shtesë për kohën e punës ose 25% kompensim shtesë financiar të pagën e rregullt për orët shtesë të punës gjatë ditës.¹¹⁶

Në faqen e internetit të DAP-it gjendet informacion i përgjithshëm për pagën e nëpunësit civil sipas kategorive. Ka informacione të mtejshme për pagesat shtesë bazuar në arritjet arsimore ose përkatësitë institucionale; megjithatë, në njoftimet për punë nuk përfshihet informacioni për pagën..

¹¹² Konvertimi i pikëve: 0-3 pikë = 0; 4-7 pikë = 1; 8-11 pikë = 2; 12-15 pikë = 3; 16-19 pikë = 4; 20-22 pikë = 5.

¹¹³ Kampioni për sondazhin e nëpunësve civilë ishte N = 975.

¹¹⁴ Vendim i Këshillit të Ministrave nr.187, datë 8.3.2017 " Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë/Nëpunësve, Zëvendësministrit dhe Nëpunësve të Kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të Linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, Disa Institucione të Pavarura, Institucionet në Varësi të Kryeministrit, Institucionet në Varësi të Ministrave të Linjës dhe Administratën e Prefektit" (<http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/144-vkm-187-pagat-e-nepunesve-civile>).


¹¹⁵ DAP, Raporti Vjetor 2020, 16, <http://dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>.

¹¹⁶ Shih Kodin e Punës, <https://bit.ly/3sq40uM>; VKM Nr. 511 datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore" i ndryshuar, <https://bit.ly/3snglun>.

Përmbledhje e rezultateve të sondazheve


Nëpunësve civilë iu kërkua t'u përgjigjen pyetjeve nëse sistemi i pagave në fuqi është i drejtë. Sipas 19.9% e nëpunësve civilë, shpërblimet ose rritja pagës sipas kategorisë përdoren nga eprorët vetëm për të stimuluar ose shpërblyer performancën; 31.4% nuk pajtohen me këtë, ndërsa 34.2% nuk e dinë. Në pyetjen për ndikimin e mundshëm politik në ndarjen e shpërblimeve ose në rritjen e pagave, 50.5% e nëpunësve civilë konsiderojnë që lidhjet politike dhe personale ose "kurrë ose pothuajse kurrë", ose "rrallë" i ndihmojnë punonjësit të marrin shpërblime. Baza (numri i të anketuarve që u përgjigjën) për këto pyetje ishin përkatësisht 392 dhe 457.

Grafiku 16. Perceptimet e nëpunësve civilë për përdorimin e shpërblimeve ose rritjes së gradave të pagave.



Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi SHPMBNJ P5 I1: Transparenca, qartësia dhe disponueshmëria publike e informacionit për sistemin e pagave në shërbimin civil



PARIMI 7: EKZISTOJNË MASAT PËR PROMOVIMIN E INTEGRITETIT, PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT DHE SIGURIMIN E DISIPLINËS NË SHËRBIMIN PUBLIK

Tabela 13. Treguesi WeBER SHPMBNJ P7 I1: Efektiviteti i masave për promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në shërbimin civil

Elementet e treguesit	Rezultatet
Masat e integritetit dhe antikorrupsionit për shërbimin civil janë të vendosura zyrtarisht në administratën qendrore	2/4
Masat e integritetit dhe antikorrupsionit për shërbimin civil zbatohen në administratën qendrore	2/4
Nëpunësit civilë i konsiderojnë efikase masat për integritetin dhe antikorrupsionin	2/2
OSHC-të i konsiderojnë efikase masat për integritetin dhe antikorrupsionin	0/2
Sipas nëpunësve civilë, masat për integritetin dhe antikorrupsionin janë të paanshme	1/2
Sipas OSHC-ve, masat për integritetin dhe antikorrupsionin në administratën shtetërore janë të paanshme	0/2
Nëpunësit civilë mendojnë se do të mbroheshin nëse do të ishin sinjalizues (denoncues i akteve korruptive)	0/2
Rezultati i përgjithshëm	7/18
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)¹¹⁷	2

Ky tregues vlerëson përshtatshmërinë e dispozitave ligjore për të promovuar integritetin, parandaluar korrupsionin dhe siguruar disiplinën në shërbimin publik. Vlerësimi bazohet në kornizën metodologjike të SIGMA-s për vlerësimin e masave dhe në përgjigjet nga sondazhet e perceptimit me nëpunësit civilë dhe OSHC-të.

Legjislacioni në fuqi për të parandaluar konfliktet e interesit dhe për të siguruar integritetin në shërbimin civil përfshin dispozita që rregullojnë përfitimin e dhuratave, zotërimin e aksioneve në ndërmarrjet private dhe vetëpërfshirimin nga vendimarrja ose dorëheqjen nga një pozicion (dhe rrimërimin) në rast të konfliktit të interesit.¹¹⁸ Ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurive detyron nëpunësit civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm të paraqesin çdo vit formularin për deklarimin e pasurive¹¹⁹ ndërsa fushëveprimi i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve përfshin të gjitha institucionet publike dhe kompanitë ku shteti ka shumicën e aksioneve.¹²⁰

Kodi Penal përfshin një sërë dispozitash për mashtrime, vjedhje dhe vepra korruptive nga zyrtarët publikë që përfshijnë mashtrime financiare kundër shtetit, akte të falsifikimit të dokumenteve, ryshfet aktiv, ryshfet pasiv, përvetësim, shpërdorim detyre, ushtrim i ndikimit të paligjshëm, pastrimi i parave dhe të përfitimeve të tjera kriminale; megjithatë, pasurimi i paligjshëm nuk dënohet.¹²¹

Pavarësisht këtyre dispozitave, legjislacioni në fuqi nuk përfshin dispozita të qarta për situatat e "ndërrimit të xhakave".¹²² Megjithatë Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit përcakton se zyrtarët publikë mund të ndikohen në mënyrë të papërshtatshme gjatë ushtrimit të funksionit të tyre nga interesa private nëpërmjet

117 Konvertimi i pikëve: 0-3 pikë = 0; 4-6 pikë = 1; 7-9 pikë = 2; 10-12 pikë = 3; 13-15 pikë = 4; 16-18 pikë = 5

118 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.714, datë 22.10.2004 "Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike", Kreu II, Paragrafi 14, kufizon dhuratat për një punonjës të administratës publike deri në 10,000 lekë. Ai gjithashtu përfshin dispozita që ndalojnë dhuratat të natyrës që përfshijnë hua ose objekte të tjera me vlerë nën vlerën e tregut, kalimin e aksioneve ose transferimin e tyre te anëtarët e familjes.

119 Ligji për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa Nëpunësve Publikë, <https://bit.ly/2RvEJmb>.

120 Ligji për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, <http://www.ildkpk.al/wp-content/uploads/2019/01/ligj-nr-60-dt-2.6.2016.pdf>.

121 Shumica e këtyre dispozitave përfshihen në Kreun VIII, Seksioni II, "Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik". <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20190607141620Kodi%20Penal%20i%20Republikës%20së%20Shqipërisë.pdf>

122 Situatat e "ndërrimit të xhakave" ndodhin kur profesionistë të ndryshëm lëvizin nga sektori privat tek ai publik dhe anasjelltas – lëvizje që shkaktojnë konflikte interesi. Ato situata ndodhin ose për shkak të mundësisë që një nëpunës civil ta përdorë postin publik për përfitime private nëse ai/ajo punësohet nga një subjekt privat në këmbim të trajtimit të favorizuar gjatë punës në shërbimin publik, ose kur një drejtues në një kompani private punësohet në sektorin publik në një pozicion në të cilin ai/ajo është në gjendje ta përdorë zyrën publike për të mirën e punëdhënësit të mëparshëm në këmbim të përfitimeve private.

ofrimit të mundësisë së punësimit në një subjekt privat në të ardhmen¹²³, dispozitat për zgjidhjen e situatave të konfliktit të interesit si për nëpunësit civilë ashtu edhe për zyrtarët e tjerë që punojnë në institucione rregullatore i referohen konflikteve që lindin kur zyrtarët ushtrojnë funksionet e tyre publike dhe nuk përmbajnë dispozita specifike që trajtojnë kufizimet e punësimit pas largimit nga shërbimi publik. Vetëm Ligji për Rregullat e Etikës në Administratën Publike përfshin një dispozitë që rregullon punësimin pas shërbimit publik: Neni 17 ("Ndalimi i përfaqësimit në konflikte kundër administratës publike") ndalon zyrtarët publikë për dy vjet pas largimit nga shërbimi publik të përfaqësojnë një person ose organizatë "të përfshirë në një konflikt ose marrëdhënie tregtare me administratën publike shqiptare", të lidhur me detyrën të kryer nga zyrtari.

Ndonëse kjo dispozitë përfshin një periudhë dy-vjeçare "ftohjeje" (shkëputjeje), përcaktimi i angazhimeve të punësimit pas largimit nga shërbimi publik është mjaft e paqartë. Titulli i nenit jep përshtypjen se ai i referohet përfaqësimit ligjor, ndërsa vetë dispozita duket se i referohet gjithashtu rasteve në të cilat ish-zyrtari publik mund të përdorë njohuritë e përftuara gjatë punës në administratën publike për interesat e tij private në pozicionin e tij të ri në sektorin privat. Nëse do të ishte kështu, kjo dispozitë do të nënkuptonte se fitimi i mundshëm privat nga ish-zyrtari publik do të vonohej vetëm për dy vjet. Përveç nevojës që ka kjo dispozitë për t'u qartësuar më tej, boshllëku më i rëndësishëm në legjislacion është mungesa e detyrimeve institucionale për të kontrolluar dhe parandaluar konfliktet e interesit që lindin si pasojë e punësimit të mëparshëm ose në të ardhmen në sektorin privat të zyrtarëve publikë.¹²⁴

Në mënyrë të ngjashme, për nëpunësit civilë nuk ka ndonjë dispozitë për të kufizuar punësimin e dyfishtë përveç nevojës për të patur një aprovim zyrtar nga eprori.¹²⁵

Nërkohë, përse i përket strategjisë ekzistuese anti-korrupsion, ajo ka identifikuar qartë objektivat, ndërsa planet e veprimit përcaktojnë qartë aktivitetet, afatet kohore, kostot dhe institucionet e ngarkuara me zbatimin e aktiviteteve për të luftuar korrupsionin në sektorin publik. Raportet tremujore dhe vjetore për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit publikohen në faqen e internetit të ministrisë së Drejtësisë dhe janë lehtësisht të disponueshme.¹²⁶ Për vitin 2019, shkalla e zbatimit të masave anti-korrupsion në lidhje me qasjen parandaluese të politikës anti-korrupsion, të cilat synojnë transparencën dhe integritetin e administratës publike, ishte 55%.¹²⁷ Megjithatë disa nga aktivitetet nën qasjen parandaluese kanë të bëjnë me shërbimin civil, raportet nuk përfshijnë statusin e përmbylljes së aktiviteteve specifike; prandaj, nuk është e mundur të dallohen aktivitetet që lidhen posaçërisht me shërbimin civil, duke qenë se statusi i përfundimit të tyre është tërësor.

■ Përmbledhje e rezultateve të sondazheve

Rezultatet nga sondazhet me nëpunësit civilë¹²⁸ dhe OSHC-të¹²⁹ për perceptimet e tyre përkatëse rreth integritetit të nëpunësve civilë ndryshojnë shumë. Sipas 61.8% të nëpunësve civilë, masat anti-korrupsion të vendosura në institucionin e tyre janë efektive në arritjen e qëllimit të tyre; vetëm 14.3% e OSHC-ve i konsiderojnë masa të tilla si efektive, ndërsa shumica (54.3%) nuk pajtohen me këtë pohim.¹³⁰

Në lidhje me paanshmërinë e masave në fuqi për integritetin, sipas 59.5% të nëpunësve civilë masat e integritetit dhe ato anti-korrupsion në institucionin e tyre zbatohen për të gjithë në të njëjtën mënyrë; vetëm 10.0% e OSHC-ve kanë mendimin se masa të tilla në administratën shtetërore janë të paanshme ndërsa shumica (61.43%) nuk janë dakord me këtë pohim.¹³¹

123 Neni 5, Pika 1.ç, Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike", <https://bit.ly/3hVaSNv>.

124 Për një referencë mbi rregulloret e punësimit pas shërbimit publik, shih organizimin dhe funksionimin e Komitetit Këshillues për Emërimet në Biznes të Mbretërisë së Bashkuar, <https://www.gov.uk/government/organisations/advisory-committee-on-business-appointments>. Për një referencë mbi rregulloret e situatave të "ndërrimit të xhaketa" shih Direktivën nr. 14 të Qeverisë Malteze "Kudri qeverisë për miradministrimin e politikës së dyerve rrotulluese (ndërrimit të xhaketa) për punonjësit publikë", <https://publicservice.gov.mt/en/people/Documents/Directives/Directive14.pdf>.

125 Neni 47 i Ligjit për Nëpunësin Civil rregullon dypunësimin e nëpunësve civilë. Dispozitat e këtij neni lejojnë që nëpunësit civilë të merren me veprimtari fitimprurëse, me kusht që ata të kenë një leje me shkrim nga eprorët e tyre.

126 Shih Ministria e Drejtësisë, Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, http://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Inter-sectoral_Strategy_against_Corruption_2015-2020_4.pdf.

127 Ministria e Drejtësisë, Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, 17-18.


128 Kampioni për sondazhin e nëpunësve civilë ishte N = 975, ndërsa baza për pyetjet në këtë tregues ishte n = 791.

129 Shembulli për anketimin e OSHC-ve ishte N = 81 të anketuar nga OSHC-të. Baza për pyetjet për këtë tregues ishte n = 70.

130 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultatet ishin përkatësisht 61.2% dhe 17.0%.


131 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultatet ishin përkatësisht 57.9% dhe 9.1%.

Grafiku 17. Perceptimet e OSHC-ve përkundër nëpunësve civilë për efikasitetin e masave të integritetit.




Mbi masat e mbrojtjes së sinjalizuesit, 20.9% e nëpunësve civilë mendojnë se nëse do të bëheshin sinjalizues, ata do të ndiheshin të mbrojtur;¹³² 22.25% janë neutralë, ndërsa 25.16% u përgjigjen se nuk e dinë.

Grafiku 18. Perceptimet e nëpunësve civilë për mbrojtjen e sinjalizuesve.



Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi SHPMBNJ P7 I1: Efektiviteti i masave për promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në shërbimin civil



132 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 17.7%.

IV.3 PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE: SHËRBIMI PUBLIK DHE MIRADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Nuk ka pasur ndonjë ndryshim thelbësor në politikën e shërbimit civil të Shqipërisë krahasuar me ciklin e fundit të monitorimit dhe vlerësimin e vitit 2017 të SIGMA-s. Përjashtimet nga shtrirja vertikale dhe horizontale e legjislacionit të shërbimit civil vazhdojnë. Procedurat e konkurrimit në shërbimin civil mbeten të njëjta dhe nëpunësit e lartë civilë kanë vazhduar të emërohen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Disa tendenca pozitive janë vërejtur gjatë këtij cikli monitorimi, duke përfshirë një rritje në përdorimin e sistemit të qendëruar të informacionit për miradministrimin e burimeve njerëzore (HRMIS) dhe përdorimin e mediave sociale për të publikuar të dhëna dhe për të siguruar informacion për procesin e aplikimit dhe procedurat e konkurrimit në shërbimin civil.

Pavarësisht këtyre tendencave pozitive, politikat në fuqi për rregullimin e angazhimeve të përkohshme dhe masat e integritetit bartin rreziqe të konsiderueshme politike dhe korrupsioni. Përveç rasteve të angazhimeve të përkohshme për kontratat e konsulencës, detyrimet dhe kriteret ligjore për procesin e përzgjedhjes për angazhime të përkohshme, për kufizimin e numrit maksimal të angazhimeve të përkohshme dhe për të ripërtëritur kontratat afatshkurtra janë të pamjaftueshme. Mungesa e kriterëve të qarta ligjore për angazhime të përkohshme cenon integritetin, paanshmërinë dhe profesionalizmin e administratës publike.

Në mënyrë të ngjashme, masat e integritetit në fuqi nuk mbulojnë të gjithë shërbimin civil dhe ato paraqesin boshllëqe thelbësore veçanërisht në lidhje me dypunësimin dhe situatat e “ndërrimit të xhaketa”. Këto janë fusha me rrezik domethënës, sepse ato mund të lejojnë kompanitë ose individët privatë të ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm në shërbimin civil, duke formësuar kështu politikën rregullatore ose duke siguruar që politikat publike u shërbejnë interesave privatë. Si pasojë, mungesa e rregulloreve të tilla paraqet rrezikshmëri të lartë që burimet publike të vihen në shërbim të interesave private.

Megjithëse kriteret e rekrutimit dhe emërimit në pozicione TND në fuqi janë transparente, ato janë mjaft të përgjithshme. Miratimi i kriterëve të përgjithshme – dhe jo të bazuara mbi ekspertizë specifike – për rekrutimin dhe emërimin e nëpunësve të lartë civilë zvogëlon mundësinë që të aplikojnë kandidatët më të mirë të mundshëm për një fushë të caktuar politikash, sepse vendet e lira TND nuk kategorizohen sipas institucionit. Për më tepër, kriteret e rekrutimit nuk synojnë të promovojnë rekrutimin e ekspertëve të politikave, ndërsa procesi i përzgjedhjes për emërimin e kandidatëve të suksesshëm për pozicione TND nuk siguron që kandidatët me ekspertizë në një fushë të caktuar të politikave të emërohen në institucionin përkatës.

IV.4 REKOMANDIME PËR SHËRBIMIN PUBLIK DHE MIRADMINISTRIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Gjurmimi i rekomandimeve nga Monitorimi i RAP 2017/2108

Rekomandimi	Statusi	Komento
Duhet të arrihet funksionaliteti i plotë i Sistemi i Informacionit për Miradministrimin e Burimeve Njerëzore (HRMIS) në mënyrë që të mundësojë planifikimin, monitorimin dhe miradministrimin e burimeve njerëzore.	Zbatuar pjesërisht	Ka pasur një shtim të përdorimit të HRMIS nga institucionet. (Raportet vjetore të DAP-it.)
DAP-i duhet të vendosë praktikën e publikimit të të dhënave periodike statistikore në shërbimin civil (përfshi numrin e nëpunësve civilë për institucion, ose për llojin e institucionit dhe për kategorinë/funksionin në shërbimin civil).	I pazbatuar	Qeveria nuk publikon rregullisht të dhëna statistikore bazë që kanë të bëjnë me shërbimin publik. Ajo publikon të dhëna të tilla vetëm në lidhje me nëpunësit civilë të cilët janë rekrutuar ose ngritur në detyrë çdo vit.
Raportimi vjetor i DAP-it për politikën e shërbimit civil duhet të përfshijë informacione më konkrete në lidhje me cilësinë dhe/ose rezultatet e punës së shërbimit publik.	Zbatuar pjesërisht	Raportet vjetore të DAP-it përfshijnë statistika për rekrutimin, masat disiplinore dhe trajnimet, por nuk ka vlerësime të rezultateve ose performancës së shërbimit civil.
Në mënyrë që të sigurohet trajtimi i barabartë i të gjithë kandidatëve dhe t'u ofrohet njësoj informacion gjatë rekrutimit, DAP-i duhet të sigurojë në mënyrë proaktive informacion për procesin e rekrutimit për t'i informuar.	I zbatuar	DAP-i përfshin video dhe grafika të shkurtra që synojnë të sqarojnë procesin e aplikimit.
DAP-i duhet të publikojë njoftime kur anulohen konkurset publike.	I pazbatuar	Informacioni në lidhje me njoftimet e anuluar nuk vihet publikisht në dispozicion.
DAP-i duhet të sigurojë që pjesëmarrja në shërbimin e lartë civil të bëhet nëpërmjet procedurave standarde – pra, konkursit kombëtar për të ndjekur program i thelluar të trajnimit të ASPA-s dhe kalimin e provimit përfundimtar.	I pazbatuar	Rekrutimi dhe ngritja në detyrë në pozicione të nëpunësit të lartë civil vazhdon të zhvillohet nëpërmjet konkurseve për emërimë të drejtpërdrejta.
DAP-i duhet të paraqesë reformën e pagave në shërbimin civil duke siguruar një strukturë të qartë dhe të thjeshtë të sistemit të pagave.	I pazbatuar	Reforma e pagave nuk është zbatuar. Një dokument politikash është hartuar nga DAP, por pritet ende miratimi i tij.
DAP-i duhet të publikojë shpjegime ose prezantime lehtësisht të kuptueshme për qytetarët lidhur me pagat në shërbimin civil.	I pazbatuar	Asnjë shpjegim ose prezantim lehtësisht i kuptueshëm për qytetarët për shpërblimet nuk është i disponueshëm në internet.
Institucionet publike duhet të rrisin ndërgjegjësimin dhe të promovojnë sistemin e mbrojtjes së sinjalizuesit.	I pazbatuar	Sipas sondazhit të perceptimit të nëpunësve civilë, vetëm 20.9% ndjejnë se ata do të mbroheshin si sinjalizues.

Rekomandimet e Monitorimit të RAP 2019/2020

Ky cikël monitorimi ofroi një mundësi për të shqyrtuar në detaje legjislacionin e shërbimit civil duke përdorur kornizën e vlerësimit SIGMA. Kjo qasje mundësoi një shqyrtim më të gjerë të legjislacionit për të identifikuar nevojat specifike për përmirësimin e efektivitetit të tij. Rekomandimet e mëposhtme bazohen në rekomandimet e dala nga cikli i fundit i monitorimit, duke i shtjelluar ato më tej dhe duke shtuar rekomandime të reja.

1. Funksionaliteti i të plotë i Sistemit të Informacionit të Miradministrimit të Burimeve Njerëzore është shumë i rëndësishëm për të mundësuar një proces të reformës së administratës publike të bazuar mbi të dhëna. DAP-i duhet të hartojë një plan gjithëpërfshirës për një zgjerim konkret të sistemit, që merr parasysh trajnimin për përdorimin e sistemit dhe nevoja të tjera teknike të organeve qeveritare.
2. DAP-i duhet të publikojë të dhëna statistikore jo vetëm për shërbimin civil, por edhe për pjesën tjetër të administratës shtetërore. Këto të dhëna do të ofronin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të shërbimit civil dhe do të përfshinin numrin e të punësuarve për institucion ose për llojin e institucioneve dhe për çdo kategori/funksion në administratën shtetërore. Megjithatë në raportet vjetore të DAP-it publikohen disa

të dhëna kyçe, të dhëna të hollësishme mund të publikohen në formate të dhënash të përpunueshme (open data).

3. Përveç statistikave të shërbimit civil për rekrutimin, masat disiplinore dhe trajnimet, raporti vjetor i DAP-it për politikën e shërbimit civil duhet të përfshijë një analizë më thelbësore për performancën e shërbimit civil.
4. Njoftimet për vendet e lira të punës duhet të kenë një përmbledhje të detyrave dhe përgjegjësi kryesore për vendin e punës, që janë të kuptueshme jo vetëm nga nëpunësit civilë, por edhe nga kandidatët e jashtëm, të cilët mund të mos kenë njohuri të detajeve teknike në lidhje me organizimin dhe proceset e brendshme të institucionit që publikon vendin e lirë të punës.
5. DAP-i duhet të publikojë njoftime kur anulohen konkurset publike dhe duhet të ofrojë/sigurojë një pikë të qartë kontakti për paraqitjen e ankesave dhe sqarimeve.
6. Procesi i rekrutimit në shërbimin e lartë civil nuk i kushton vëmendjen e duhur ekspertizës së nevojshme të politikave, d.m.th., ekspertizës në fushën specifike të politikave për të cilën institucioni është përgjegjës. Kriteret në fuqi të rekrutimit në shërbimin të lartë civil duhet të rishikohen për të kërkuar që kandidatët për nëpunës të lartë civilë të kenë përvojën dhe njohuritë e nevojshme të politikave për të cilat është përgjegjës institucionin në të cilin ata aplikojnë.
7. Për të siguruar transparencën e konkurseve të shërbimit të lartë civil, përveç identitetit dhe rezultatit të kandidatëve të suksesshëm, rezultatet përfundimtare të konkursit duhet të përfshijnë identitetin dhe rezultatit të kandidatëve që kanë marrë të paktën 70 pikë, edhe nëse nuk janë emëruar si anëtarë të TND-së.
8. Puna për miratimin e një sistemi të qartë dhe të drejtë pagash në shërbimin civil duhet të përshpejtohet.
9. Duhet të vendosen kriteret të qarta dhe të standardizuara ligjore për të siguruar që angazhimet e përkohshme për detyra të ngjashme me ato të shërbimit civil të jenë të bazuara në meritë, të kenë rendiment financiar dhe të përmirësojnë performancën institucionale.
10. Duhet të kufizohet ligjërisht kohëzgjatja e zëvendësimeve të përkohshme në shërbimin e lartë civil për t'u siguruar që të tilla zëvendësime nuk ndikojnë negativisht në efektivitetin institucional.
11. Kuadri ligjor për integritetin e shërbimit civil duhet të përfshijë dispozita të qarta që rregullojnë plotësisht dypunësimin dhe që parandalojnë situatat e «ndërrimit të xhaketa».
12. Sistemi i sinjalizuesve duhet të rishikohet për të siguruar që nëpunësit civilë të inkurajohen për të dënuar publikisht zyrtarët dhe proceset institucionale të korruptuara dhe të ndihen të sigurt për ta bërë këtë.

V. LLOGARIDHËNIA

V.1 TREGUESIT WEBER TË PËRDORUR PËR LLOGARIDHËNIEN DHE VLERAT PËR SHQIPËRINË

P2 I1: Perceptimi i shoqërisë civile për cilësinë e legjislacionit dhe praktikën e marrjes së informacionit					
0	1	2	3	4	5
P2 I2: Informimi proaktiv i publikut nga autoritetet publike					
0	1	2	3	4	5

■ Gjendja e Llogaridhënies (LL)

Llogaridhënia, në kuadër të këtij raporti monitorimi, përfshin publikimin e informacionit nga institucionet e qeverisë qendrore për fushën e punës së tyre, strukturën dhe organizimin e tyre, politikat, raportet e zbatimit të politikave, si dhe mundësinë e përfuturit të informacionit nga publiku.

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", përfshin dispozita që detyrojnë autoritetet publike të publikojnë informacione për punën e tyre dhe rregullon të drejtën për përfuturimin e informacionit publik. Në përputhje me Nenin 7, institucionet e qeverisë qendrore duhet të publikojnë informacione për një gamë të gjerë temash, të cilat përfshijnë strukturën organizative dhe të pagave, politikat dhe dokumentet e politikave, kuadrin ligjor që rregullon punën e tyre, mekanizmat e kontrollit të brendshëm (përfshi publikimin e raporteve të auditimit), zbatimin e buxhetit, dhe informacionin për prokurimin publik. Ky informacion është pjesë e programit të transparencës që institucionet publike duhet të miratojnë në përputhje me ligjin.

Neni 10 kërkon që institucionet publike të caktojnë një koordinator për të drejtën e informimit, i cili është përgjegjës për lehtësimin e marrjes së informacionit nga publiku. Masat administrative për mosdhënie të informacionit dhe mospërpunimin e kërkesave për informacion ndahen mes titullarit të institucionit, koordinatorsit dhe zyrtarëve që janë drejtpërdrejt përgjegjës për administrimin e dokumenteve zyrtare.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDMDP) është institucioni përgjegjës për të mbikëqyrur zbatimin e dispozitave të Ligjit për të Drejtën e Informimit dhe për të shqyrtuar ankesat administrative të rasteve kur informacioni i kërkuar nuk është dhënë nga institucioni përgjegjës. Sipas raportit të Komisionerit për vitin 2019, 60% e të gjitha institucioneve publike e kanë zbatuar programin e transparencës.¹³³ Pas shqyrtimit të 30 institucioneve publike – përfshirë ministrinë – Komisioneri gjeti se informacioni për arsimin dhe pagat e punonjësve, mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe për zbatimin e buxhetit dhe planit të prokurimit publik nuk ishin botuar, duke shkelur kështu dispozitat e Nenit 7 të ligjit.¹³⁴ Pavarësisht këtyre shkeljeve, është e paqartë nëse institucioneve shkelëse u janë vendosur gjoba. Raporti përmend numrin e çështjeve gjyqësore në të cilat Komisioneri është përfshirë për shkak të vendimeve të dhëna, por është e paqartë nëse Komisioneri ka marrë pjesë në ato raste si palë në mosmarrëveshje apo për të dhënë dëshmi në lidhje me ndonjë rast ku kërkuar i informacionit ka paditur institucionin publik për mosrespektim të vendimit të Komisionerit që e detyron institucionin të japë informacionin e kërkuar.¹³⁵

Për vitin 2020, Komisioneri prezantoi gjetjet e procesit të monitorimit të 36 institucione të qeverisë qendrore.¹³⁶ Metodologjia për këtë proces monitorimi është sasiore dhe institucionet publike vlerësohen në treguesit e mëposhtëm:

1. Publikimi i programit model të transparencës;
2. Publikimi i regjistrat për kërkesa dhe përgjigje të përditësuar;
3. Emri dhe mbiemri i koordinatorsit për të drejtën e informimit;

¹³³ KDMDP, "Raporti Vjetor 2019", 8, https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/03/Annual_Report_2019.pdf.

¹³⁴ KDMDP, "Raporti Vjetor 2019", 8. Këto çështje u theksuan gjithashtu në raportin e Komisionit Evropian të vitit 2020 për Shqipërinë. Shih Komisionin Evropian, Raporti për Shqipërinë 2020, 17, 31, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

¹³⁵ KDMDP, 17-18.

¹³⁶ KDMDP, "Indeksi i Transparencës Proaktive i Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë", https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/01/raport_monitorimi_i_institucioneve_qendrore_dhe_te_varesise.pdf.

4. Publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar gjatë vitit të monitorimit;
5. Regjistri elektronik për kërkesa dhe përgjigje është i vendosur.

Për shkak të ndryshimit të qasjes së vlerësimit, krahasimi i dy raporteve – atij të vitit 2019 dhe atij të vitit 2020 – nuk është i mundur.

V.2 ÇFARË MONITORON WEBER-I DHE SI?

Parimi SIGMA që mbulon të drejtën për marrjen e informacionit publik është parimi i vetëm që monitorohet në fushën e llogaridhënies, megjithatë ky parim merr në konsideratë si anët proaktive ashtu edhe ato reaguese të çështjes.

Parimi 2: E drejta për marrjen e informacionit publik është miratuar në legjislacion dhe zbatohet vazhdimisht në praktikë..

Ky parim ka rëndësi maksimale në rritjen e transparencës së administratave dhe të kërkesës së llogarisë ndaj tyre nga shoqëria civile dhe qytetarët, si dhe për mbrojtjen e të drejtës së publikut të gjerë për t'u informuar si parakusht për një administrim më të mirë. Qasja e WeBER-it ndaj parimit nuk vlerëson zgjidhjet rregullatore të përfshira në legjislacionin për të drejtën e informimit, por bazohet në mënyrën se si institucionet i zbatojnë dispozitat ligjore në praktikë dhe se sa proaktive janë ato në publikimin e informacionit me interes publik. Nga njëra anë, qasja merr në konsideratë përvojën e anëtarëve të shoqërisë civile në zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit dhe, nga ana tjetër, ajo qëmton faqet të internetit të organeve të administratës për të vlerësuar publikimin proaktiv të informacionit me interes publik.

Monitorimi i WeBER-it kryhet duke përdorur dy tregues. I pari përqendrohet tërësisht në perceptimin e shoqërisë civile për shtrirjen e së drejtës për të marrë informacion dhe nëse mekanizmat e zbatimit të tij i mundësojnë shoqërisë civile që ta ushtrojë atë të drejtë në një mënyrë të plotë. Për të zbuluar perceptimet, u realizua një studim i organizatave të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor duke përdorur një platformë të anketimit në internet, nga gjysma e dytë e qershorit deri në fillim të gushtit 2020.¹³⁷ Pyetësori uniform me 28 pyetje u përdor për të vlerësuar të gjitha administratat e Ballkanit Perëndimor, duke siguruar një qasje të barabartë në zbatimin e sondazhit. Ai u shpërnda në gjuhët e secilit vend nëpërmjet rrjeteve ekzistuese dhe platformave të organizatave të shoqërisë civile dhe nëpërmjet pikave qendrore të kontaktit, siç janë institucionet përgjegjëse për bashkëpunimin me shoqërinë civile. U përhoqëm për të siguruar që sondazhi të synonte sa më shumë lloje organizatash, shpërndarje gjeografike dhe fusha veprimtarie dhe kështu të kishim kampione përfaqësuese. Për të plotësuar gjetjet e sondazhit me të dhëna cilësore, u organizuan fokus-grupe me OSHC-të, mirëpo rezultatet e fokus-grupeve nuk u përdorën për caktimin e pikëve për treguesin.

Treguesi i dytë përqendrohet në informimin proaktiv të publikut nga organet e administratës, veçanërisht duke monitoruar gjithëpërfshirjen, kohën dhe qartësinë e informacionit të shpërndarë nëpërmjet faqeve zyrtare të internetit. Në total u përzgjedhën dhe u vlerësuan 18 lloje informacioni në bazë të dy grupeve kriteresh: 1) kriteret themelore, që shqyrtojnë nëse informacioni është i plotë dhe i përditësuar dhe 2) kriteret e avancuara, që shqyrtojnë mundësinë dhe lehtësinë e marrjes së informacionit nga qytetarët nëpërmjet faqeve të internetit të institucioneve. Informacioni u mbledh nga faqet zyrtare të internetit të një kampioni prej shtatë institucioneve, që përfshijnë tre ministri të linjës (një ministri e madhe, një e mesme dhe një e vogël për sa i përket fushëveprimit tematik), një ministri me funksione të planifikimit dhe koordinimit të përgjithshëm, një zyrë qeveritare me funksionet e qeverisjes qendrore, një institucion vartës i një ministri/ministrie dhe një zyrë qeveritare e ngarkuar për ofrimin e shërbimeve.¹³⁸

¹³⁷ Anketa e OSHC-ve u administrua nëpërmjet një pyetësori anonim, në internet. Metoda e mbledhjes së të dhënave përfshinte CASI (vetë-intervistim i ndihmuar nga kompjuteri). Në Shqipëri, sondazhi u krye në periudhën 24 qershor - 29 korrik 2020. Metoda e mbledhjes së të dhënave përfshinte CASI (vetë-intervistim i ndihmuar nga kompjuteri). Kampioni i sondazhit ishte N = 81.

¹³⁸ Për Shqipërinë, kampioni përfshiu Zyrën e Kryeministrit, ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrinë e Drejtësisë, ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë për Trajtimin e Pronave dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

V.3 REZULTATET E MONITORIMIT TË WEBER-IT

PARIMI 2: E DREJTA PËR MARRJEN E INFORMACIONIT PUBLIK ËSHTË MIRATUAR NË LEGJISLACION DHE ZBATOHET VAZHDIMISHT NË PRAKTIKË.

Tabela 14. Treguesi WeBER LL P2 I1: Perceptimi i shoqërisë civile për cilësinë e legjislacionit dhe praktikën e marrjes së informacionit publik

Elementet e treguesit	Rezultatet
OSHC-të gjykojnë se informacioni i regjistruar dhe dokumentuar nga autoritetet publike është i mjaftueshëm për zbatimin e duhur të së drejtës për marrjen e informacionit publik	2/4
OSHC-të gjykojnë që përjashtimet nga supozimi i karakterit publik të informacionit përcaktohen në mënyrë të përshtatshme	1/2
OSHC-të gjykojnë që përjashtimet nga supozimi i karakterit publik të informacionit zbatohen në mënyrë të përshtatshme	0/4
OSHC-të konfirmojnë që informacioni jepet në formatin e kërkuar	0/2
OSHC-të konfirmojnë që informacioni jepet brenda afateve të përcaktuara	1/2
OSHC-të konfirmojnë që informacioni jepet falas	2/2
OSHC-të konfirmojnë që personi që kërkon informacion nuk është i detyruar të japë arsytet për kërkesat që kryen	1/2
OSHC-të konfirmojnë që në praktikë pjesët e pa klasifikuara të materialeve që ndodhen në dokumente të klasifikuara jepen	0/4
OSHC-të gjykojnë që informacioni i kërkuar jepet pa pjesët që përmbajnë të dhëna personale	0/2
OSHC-të gjykojnë se kur jepen vetëm disa pjesë materiale të klasifikuara, kjo nuk bëhet për të mashtruar kërkesin me informacion të pjesshëm	0/2
OSHC-të gjykojnë që organi i caktuar mbikëqyrës, nëpërmjet praktikës së tij, ka vendosur standarde mjaftueshëm të larta të së drejtës dhe të marrjes së informacionit publik	2/4
OSHC-të gjykojnë se masat e buta të dhëna nga autoriteti mbikëqyrës për autoritetet publike japin rezultat	1/2
OSHC-të gjykojnë se pushteti i autoritetit mbikëqyrës për të vendosur sanksione çon në pasoja mjaftueshëm të rënda për personat përgjegjës në autoritetin moszbatues	1/2
Rezultati i përgjithshëm	11/34
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)¹³⁹	1

Ky tregues bazohet tërësisht në rezultatet e sondazhit të OSHC-ve. Baza (numri i të anketuarve që u përgjigjën) e pyetjeve për këtë tregues ishte 73 – për tre elementët e parë (disponueshmëria e informacionit dhe përjashtimet nga e drejta e marrjes së informacionit) – dhe 47 për pjesën tjetër të elementeve.

Një e treta e OSHC-ve në Shqipëri (34.3%)¹⁴⁰ gjykojnë se autoritetet publike të Shqipërisë regjistrojnë informacion të mjaftueshëm që mund të vihet në dispozicion të publikut kur ai ushtron të drejtën e informimit. Sidoqoftë, shumica e të anketuarve (37%) janë ose të pavendosur ose nuk e dinë. Nga OSHC-të që kanë kërkuar informacion në përputhje me dispozitat e të drejtës për informim, 19.1% vërejnë se informacioni “shpesh” ose “gjithmonë” sigurohet në formatin e kërkuar¹⁴¹, ndërsa 49% pohojnë se “ndonjëherë” ofrohet në formatin e kërkuar. Për më tepër, 36.2% e të anketuarve thonë se një informacion i tillë sigurohet shpesh ose gjithmonë brenda afateve ligjore¹⁴²; megjithatë, e njëjta përqindje e të anketuarve pohon se kjo ndodh rrallë ose kurrë.

¹³⁹ Konvertimi i pikëve: 0-6 pikë = 0; 7-11 pikë = 1; 12-17 pikë = 2; 18-23 pikë = 3; 24-28 pikë = 4; 29-34 pikë = 5.


¹⁴⁰ Në ciklin e mëparshëm të monitorimit, ishte 28%.

¹⁴¹ Në ciklin e fundit të monitorimit ishte 34.8%.

¹⁴² Në ciklin e fundit të monitorimit ishte 34.7%.

Informacioni jepet falas në shumicën e rasteve në bazë të perceptimeve të 83% e të anketuarve¹⁴³, ndërsa arsyet për të shpjeguar kërkesën për informacion kërkojnë "rrallë" ose "kurrë" sipas më shumë se gjysmës së të anketuarve (53.2%)¹⁴⁴.

Grafiku 19. Disponueshmëria dhe përfundi i informacionit publik.



Përfundimet nga e drejta e marrjes së informacionit në legjislacion janë të përshtatshme¹⁴⁵ sipas 42.5% të OSHC-ve, por vetëm 15.1% pajtohen që këto përfundime zbatohen në përputhje me dispozitat ligjore në praktikë¹⁴⁶. Lidhur me dhënien e pjesëve të paklasifikuara të materialeve të klasifikuara¹⁴⁷, vetëm 4.3% e të anketuarve pohojnë se një informacion i tillë jepet "shpesh" ose "gjithmonë".¹⁴⁸ Shumica e tyre (44.7%) nuk e dinë, ndërsa 42.5% konsiderojnë se një informacion i tillë ose jepet "rrallë", ose nuk jepet "kurrë".

Pjesa e përgjigjeve pozitive është pak më e madhe në lidhje me dhënien e materialeve pa të dhënat personale që gjenden në to; 17% thonë se ato jepen "shpesh" ose "gjithmonë".¹⁴⁹ Sidoqoftë, përqindja e të anketuarve që nuk e dinë (42.6%) është e ngjashme me pyetjen e mëparshme për dhënien e pjesëve të paklasifikuara të materialeve të klasifikuara. Në mënyrë të ngjashme, pothuajse gjysma e OSHC-ve (48.9%) nuk e dinë nëse të dhënat jepen në mënyrë selektive për të mashtuar kërkesuesin e informacionit dhe vetëm 12.7% konsiderojnë

143 Në ciklin e fundit të monitorimit ishte 93.5%.

144 Në ciklin e fundit të monitorimit ishte 43.5%.

145 Kufizimet përfshihen në Nenin 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

146 Në ciklin e fundit të monitorimit, vlerat ishin përkatësisht 46.3% dhe 18.3%.


147 Sipas nenit 17, paragrafi 5 dhe 6, në rastet kur informacioni i kërkuar klasifikohet sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar si" sekret shtetëror "(i ndryshuar), autoritetit publik i kërkohej të fillojë procedurat për të rivlerësuar dokumentin dhe për të siguruar një version të redaktuar të kërkuarës.

148 Në ciklin e fundit të monitorimit ishte 2.2%.

149 Në ciklin e fundit të monitorimit ishte 21.7%.


se informacioni i pjesshëm, i lëshuar “rrallë” ose “kurrë”, nuk synon të mashtrojë personin kërkues¹⁵⁰. Sipas më shumë se 1/3 të OSHC-ve, dhënia e pjesshme e informacionit “ndonjëherë” (21.3%) dhe “shpesh” (17%) e mashton marrësin.¹⁵¹

Grafiku 20. Dhënia e informacionit të pjesshëm nga materiale të klasifikuara.



Në përgjithësi, shumica e OSHC-ve (55.3%) pajtohen se praktika e punës së KDIMDP-së ka vendosur standarde mjaftueshëm të larta për ushtrimin e të drejtës së informimit¹⁵² dhe sanksionet (masat) e buta¹⁵³ shihen si të efektshme nga 34.1% e të anketuarve¹⁵⁴. Sidoqoftë, shumica (44.7%) janë neutralë ose nuk e dinë, ndërsa 21.3% nuk pajtohen me këtë vlerësim. Sa i përket ashpërsisë së sanksioneve të ndaj autoriteteve publike moszbatuese të ligjit, 42.6% e OSHC-ve bien dakord ose pajtohen plotësisht që ato çojnë në pasoja mjaft të ashpra¹⁵⁵, ndërsa 29.8% nuk mendojnë në të njëjtën mënyrë.

Grafiku 21. Ndikimi i KDIMDP në vendosjen e standardeve për të drejtën e informimit.



¹⁵⁰ Në ciklin e fundit të monitorimit ishte 30.4%.

¹⁵¹ Në ciklin e fundit të monitorimit, vlerat ishin përkatësisht 24% dhe 11% (të rrumbullakosura).

¹⁵² Në ciklin e fundit të monitorimit ishte 47.8%.

¹⁵³ KDIMDP mund të ndërmjetësojë në mosmarrëveshjet ndërmjet kërkuesit të informacionit dhe autoritetit publik, të cilit i kërkohet informacioni.

¹⁵⁴ Në ciklin e fundit të monitorimit ishte 36.9%.

¹⁵⁵ Në ciklin e fundit të monitorimit ishte 45.7%.


Krahasuar me rezultatet e monitorimit të reformës gjatë 2017/2018, ka përmirësime dhe përkeqësime në perceptimet e OSHC-ve në lidhje me përfitim të informacionit. Praktika e autoriteteve publike për regjistrimin e informacionit të mjaftueshëm për përfitim falas të tij në të ardhmen perceptohet më pozitivisht (+ 6.3%), por ka një rënie të konsiderueshme të perceptimit që informacioni ofrohet në formatin e kërkuar (-15.6%) dhe falas (- 10.5%). Nga ana tjetër, ekziston një rritje pozitive (+ 9.7%) e OSHC-ve që thonë se atyre nuk u kërkohej të japin arsye kur kërkojnë informacion dhe atyre që pohojnë se informacioni i kërkuar është marrë brenda afatit ligjor (+ 1.5%).

Perceptimet pozitive për përshtatshmërinë e përjashtimeve në legjislacionin për të drejtë e informimit dhe për zbatimin në praktikë të tij janë ulur (-3.7% dhe -3.2% përkatësisht). Sidoqoftë, mospasja e një mendimi për këtë çështje, ose mungesa e njohurive për të, është ende e përhapur mes OSHC-ve. Megjithatë ka një rritje të vogël (+ 2.1%) në perceptimin se pjesët e paklasifikuara të materialeve të klasifikuara jepen, ekziston një rënie e konsiderueshme (-17.7%) e perceptimit se kjo gjë nuk ka për qëllim të mashtrojnë kërkuuesin e informacionit. Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se mbi 40% e OSHC-ve nuk kanë një mendim për zbatimin e dispozitave ligjore që u kërkojnë autoriteteve publike të zbulojnë përmbajtjen e paklasifikuara të materialeve të klasifikuara.

Ndikimi i punës së Komisionerit në rritjen e transparencës institucionale perceptohet më pozitivisht (+ 7.5%), por perceptimet për efektshmërinë e masave të tij të buta (-2.8%) dhe ndikimi i sanksioneve (-3.1%) mbi autoritetet publike janë ulur disi.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi LL P2 I1: Perceptimi i shoqërisë civile për cilësinë e legjislacionit dhe praktikës së marrjes së informacionit publik



PARIMI 2: E DREJTA PËR MARRJEN E INFORMACIONIT PUBLIK ËSHTË MIRATUAR NË LEGJISLACION DHE ZBATOHET VAZHDIMISHT NË PRAKTIKË

Tabela 15. Treguesi WeBER LL P2 I2: Informimi proaktiv i publikut nga autoritetet publike

Elementet e treguesit	Rezultatet
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar për fushën e veprimtarisë së punës së tyre	2/4
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacione për fushën e veprimtarisë së punës së tyre, të cilat janë lehtësisht të përfutshme nga qytetarët	0/2
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar për llogaridhënien (kujt duhet t'i përgjigjen institucionalisht)	0/4
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar për dokumente përkatëse të politikës dhe akte juridike	0/4
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë një informacion lehtësisht të përfutshëm për qytetarët mbi dokumente përkatëse të politikave dhe akte juridike	0/2
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar për dokumente, studime dhe analiza të politikave të lidhura me politikën nën kompetencën e tyre	0/4
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacion lehtësisht të përfutshëm nga qytetarët për dokumentet e politikave, studimet dhe analizat përkatëse për politikën nën kompetencën e tyre	0/2
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë raporte vjetore të plota dhe të përditësuara	0/4
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë raporte vjetore lehtësisht të përfutshme nga qytetarët	0/2
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar për buxhetin e institucionit	0/4
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacion lehtësisht të përfutshëm nga qytetarët për buxhetin e institucionit	0/2
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar të pikave të kontaktit (përfshirë adresat elektronike)	0/4
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacion për pikat e kontaktit të cilat janë lehtësisht të përfutshme nga qytetarët (përfshi adresat elektronike)	1/2
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë organigramën e plotë dhe të përditësuar të institucionit	2/4
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë një organigramë lehtësisht të përfutshme nga qytetarët	2/2
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar për pikat e kontaktit për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë të jashtëm, përfshirë proceset e konsultimit publik	2/4
Faqet e internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacion lehtësisht të përfutshëm nga qytetarët për mënyrat se si ato bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë të jashtëm, përfshi proceset e konsultimit publik	0/2
Autoritetet publike ndjekin në mënyrë aktive politikën e publikimit të dhënave të përpunueshme (open data)	0/4
Rezultati i përgjithshëm	9/56
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)¹⁵⁶	0

156 Konvertimi i pikëve: 0-10 pikë = 0; 11-19 pikë = 1; 20-28 pikë = 2; 29-37 pikë = 3; 38-46 pikë = 4; 47-56 pikë = 5.

Vlerësimi për këtë tregues bazohet në shqyrtimin e faqeve të internetit të një kampioni institucionesh, të cilat përfshijnë Zyrën e Kryeministrit (ZKM), ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrinë e Drejtësisë, ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë e Trajtimit të Pronave dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Institucionet kishin përgjithësisht informacione bazë për fushën e veprimtarisë së tyre, informacione për kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe në disa raste edhe të atij për konsultim publik. Mund të gjendeshin informacione të përgjithshme për buxhetin e institucionit – me përjashtim të ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ZKM-së dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Por informacioni buxhetor sipas kriterëve të këtij treguesi – që përfshin raportin financiar e vitit të kaluar dhe planin financiar të vitit aktual – ishte i paplotë. Raportet vjetore financiare mungonin në faqen e ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndërsa Agjencia e Trajtimit të Pronave kishte publikuar vetëm planet e prokurimit për vitin 2019. Planet për vitin aktual (2020) mungonin në të gjitha institucionet.

Përtej publikimit të tij, informacioni i ofruar në internet nga institucionet e marra në shqyrtim prirret të mos jetë lehtësisht i përfutueshëm nga përdoruesit. Për më tepër, raportet vjetore për aktivitetet e institucionit dhe informacionet buxhetore duket se nuk janë të parashikuara për publikun e gjerë, pasi nuk paraqiten në mënyrë të përmbledhur dhe të thjeshtë.


Në përgjithësi, institucionet nuk janë proaktive në përfshirjen e publikut nëpërmjet publikimit të informacionit të plotë dhe të përpunueshëm (open data). Veçanërisht shqetësuese është mungesa e përgjithshme e informacionit për mekanizmat e raportimit të institucioneve të marra në shqyrtim ndaj në institucione të tjera eprorë ose ndaj të cilave u kërkohet të raportojnë sipas detyrimeve kushtetuese.

Ka një ndryshim të qartë midis informacionit të publikuar nga katër ministrinë dhe ai i publikuar nga tre institucionet e tjera: Zyrës së Kryeministrit, Agjencisë e Trajtimit të Pronave, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Ndërsa ministrinë ofrojnë më shumë informacion për strategjitë, raportet dhe buxhetet e tyre (me përjashtim të ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit), tre institucionet e tjera nuk e bëjnë këtë. Informacioni i publikuar në faqet e tyre të internetit prirret të jetë i pakët dhe jo i përditësuar. Agjencia e Trajtimit të Pronave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës publikojnë pak informacion për aktivitetet e tyre dhe janë veçanërisht të vështira për t'u shqyrtuar punën dhe për t'u kërkuar llogari.

Ka një rënie të dukshme në vlerën e treguesit krahasuar me ciklin e fundit të monitorimit. Arsyet e mundshme mund të jenë përzgjedhja e ndryshme e institucioneve (përveç ZKM) dhe mungesa e informacionit buxhetor (raportet financiare për vitin 2019 dhe planet për vitin 2020).

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi LL P2 I2: Informimi proaktiv i publikut nga autoritetet publike



V.4 PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE: LLOGARIDHËNIA

Shqyrtimi i treguesve të llogaridhënies, të cilët përqendrohen pothuajse ekskluzivisht në disponueshmërinë dhe përfundimin e informacionit, është thelbësor për qëmtimin e punës së administratës nga publiku dhe pjesëmarrjen e tij në procesin e vendimmarrjes. Rezultatet nga sondazhi i perceptimit të OSHC-ve tregojnë sfidat kryesore për disponueshmërinë dhe përfundimin e informacionit, që konfirmohen më tej nëpërmjet qëmtimit të faqeve në internet të institucioneve qeveritare të shqyrtuara.

Rezultatet e sondazhit gjithashtu nënvizojnë mungesën e përputhshmërisë midis vendosjes së dispozitave ligjore për të siguruar përfundimin e informacionit pa cenuar sigurinë kombëtare, ose informacione të tjera të ndjeshme, dhe zbatimin e tyre në praktikë nga autoritetet publike. Qasja e autoriteteve publike ndaj dhënies së informacionit është disi e mbyllur. Ato tentojnë të parandalojnë përfundimin e informacionit duke mos i zbatuar plotësisht dispozitat e vendosura ligjore për të drejtën e informimit.

Roli i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes e të Dhënave Personale pranohet se ka një ndikim pozitiv në vendosjen e standardeve për transparencën institucionale, por shumica e OSHC-ve nuk mendojnë se masat e buta apo sanksionet e vendosura nga Komisioneri ndaj institucioneve publike janë të efektshme për nxitjen e një transparence më të madhe institucionale.

Rezultatet e qëmtimit të faqeve në internet të institucioneve tregojnë se ato nuk kërkojnë të japin në mënyrë proaktive informacione të rëndësishme për politikën e tyre, për përdorimin e parave të taksapaguesve dhe për strukturën e tyre të brendshme apo proceset e llogaridhënies. Pavarësisht nga këto mangësi, ka institucione publike që punojnë më mirë se të tjerat sa i përket publikimit të informacionit me interes publik. Të katër ministritë e shqyrtuara për shembull, zakonisht publikojnë më shumë informacion sesa Zyra e Kryeministrit dhe dy agjencitë (Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia për Kompensimin e Tokës).

V.5 REKOMANDIME PËR LLOGARIDHËNIEN

Gjurmimi i rekomandimeve nga Monitorimi RAP 2017/2108

Rekomandimi	Statusi	Komento
Në përputhje me ligjin nr. 119/2014, autoritetet publike duhet të japin informacione brenda afateve të përcaktuara dhe në formatin(et) e kërkuar. Nëse ka pengesa të arsyeshme ose justifikim për ndonjë vonesë ose ndryshim, kërkesit e informacionit duhet të informohen paraprakisht.	Zbatuar pjesërisht	Sipas sondazhit të perceptimit të OSHC-ve, 19 pohojnë se informacioni jepet në formatin e duhur dhe 6% pohojnë që ai nuk jepet në kohë.
Ndryshimet e pritshme të ligjit 119/2014 duhet të sigurojnë kufizime proporcionale në qasje në informacion, sanksione efektive dhe proporcionale në lidhje me mekanizmat e llogaridhënies administrative, dhe hapjen proaktive të informacionit publik.	I pazbatueshëm	Asnjë ndryshim nuk është bërë në këtë ligj.
Lidhur me publikimin proaktiv të informacionit, autoritetet publike duhet të përpiqen të informojnë qytetarët duke përdorur një gjuhë të thjeshtë.	I pazbatuar	Faqet e internetit të autoriteteve publike zakonisht nuk përmbajnë informacione lehtësisht të përftueshme nga qytetarët për veprimtarinë e tyre; dokumente politikash dhe akte ligjore përkatëse; studime politikash dhe analiza të rëndësishme për politikën nën përgjegjësinë e tyre.
Autoritetet publike duhet të publikojnë në faqet e tyre të internetit programe transparence të përditësuara dhe më të lehta për t'u përdorur.	Zbatuar pjesërisht	Edhe pse është miratuar një format i ri për përfundimin e informacionit sipas Programit të Transparencës, institucionet publike nuk e përditësojnë vazhdimisht Informacionin.
Autoritetet publike duhet të vendosin praktikën e publikimit të raporteve vjetore në internet.	Zbatuar pjesërisht	Disa nga faqet e autoriteteve publike të institucioneve të shqyrtuara përmbajnë raporte vjetore të plota dhe të përditësuara.

Autoritetet publike duhet të publikojnë buxhetet e tyre vjetore (planet financiare) dhe të vendosin praktikën e prodhimit dhe publikimit të buxheteve lehtësisht të kuptueshme për qytetarët.	I pazbatuar	Planet financiare dhe buxhetet lehtësisht të kuptueshme për qytetarët nuk mund të gjenden për asnjërën nga institucionet publike të shqyrtuara.
Autoritetet publike duhet të fillojnë të publikojnë të dhëna që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së tyre në përputhje me standardet e të dhënave të përpunueshme (open data).	I pazbatuar	Autoritetet publike nuk ndjekin në mënyrë proaktive politikën e publikimit të dhënave të përpunueshme (open data).
Zyrtarëve publikë duhet t'u ofrohet trajnim i duhur se si të veprojnë në përputhje me publikimin proaktiv të informacionit.	Zbatuar pjesërisht	KDIMDP ofron trajnim për koordinatorët për të drejtën e informimit.

■ Rekomandimet e Monitorimit të RAP 2019/2020

Rekomandimet e mëposhtme përfshijnë ato të ciklit të mëparshëm të monitorimit, të cilat janë ende për tu zbatuar. Disa prej tyre janë detajuar më tej për të nxjerrë në pah praktikatat shtesë që mund të përmirësojnë transparencën institucionale.

1. Autoritetet publike duhet të publikojnë në programin e tyre të transparencës të gjitha informacionet e kërkuara nga Ligji për të Drejtën e Informimit dhe të sigurojnë që ato të përditësohen. KDIMDP duhet të gjobisë autoritetet publike kur ato nuk respektojnë detyrimet ligjore.
2. Autoritetet publike duhet të japin informacion brenda afateve të përcaktuara dhe në formatin e kërkuar.
3. Kur informacioni i kërkuar është i klasifikuar, autoritetet publike duhet të fillojnë procedurat e deklasifikimit të pjesshëm ose të plotë në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit. KDIMDP duhet ta monitorojë këtë proces dhe të sigurojë që autoritetet publike i zbatojnë këto kërkesa ligjore.
4. Lidhur me publikimin proaktiv të informacionit, autoritetet publike duhet të përpiqen të informojnë qytetarët duke përdorur një gjuhë të thjeshtë e të përqendruar në lehtësimin e përfuturit të informacionit.
5. Autoritetet publike duhet të publikojnë raportet vjetore në internet.
6. Autoritetet publike duhet të publikojnë plane dhe raporte financiare lehtësisht të kuptueshme nga qytetarët.
7. Përveç detyrimeve të përhershme ligjore, autoritetet publike duhet të publikojnë në mënyrë proaktive të dhënat e buxhetit dhe të prokurimit në një format të dhënash të përpunueshme (open data).

VI. OFRIMI I SHËRBIMEVE

VI.1 TREGUESIT WEBER TË PËRDORUR NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE DHE VLERAT PËR SHQIPËRINË

P1 I1: Perceptimi publik mbi orientimin ndaj qytetarit të administratës shtetërore					
0	1	2	3	4	5
P3 I1: Perceptimi i publikut dhe disponueshmëria e informacionit për reagimet e qytetarëve në lidhje me cilësinë e shërbimeve administrative					
0	1	2	3	4	5
P4 I1: Perceptimi i OSHC-ve për përfitim të shërbimeve administrative					
0	1	2	3	4	5
P4 I2: Disponueshmëria e informacionit në lidhje me përfitim të shërbimeve të administratës nëpërmjet faqeve të internetit të ofruesve të shërbimeve					
0	1	2	3	4	5

■ Gjendja për ofrimin e shërbimeve

Politikat e ofrimit të shërbimeve rregullohen nëpërmjet Dokumentit të Politikave Afatgjata për Ofrimin e Shërbimeve me në Qendër Qytetarin nga Administrata Shtetërore në Shqipëri 2016-2025 dhe legjislacioni për ofrimin e shërbimeve.¹⁵⁷ Për arsye të zhvillimit dhe koordinimit të saj, politikat e ofrimit të shërbimeve ndahet në dy përbërës: (i) shërbimet publike (duke përfshirë kujdesin shëndetësor dhe arsimin) dhe (ii) e-qeverisja dhe digjitalizimi.¹⁵⁸ Zhvillimi dhe koordinimi i shërbimeve publike udhëhiqet nga drejtori i kabinetit të zëvendës kryeministrit, ndërsa ADISA shërben si sekretariati i tij teknik; ndërkohë, shërbimet elektronike të qeverisë dhe digjitalizimi koordinohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Reforma e politikës së ofrimit të shërbimeve në Shqipëri është bazuar në digjitalizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës të ofrimit të shërbimeve duke ofruar shërbimet e qeverisë qendrore nëpërmjet portalit e-Albania, qendrave e integruara të ofrimit të shërbimeve të administruara nga ADISA, si dhe në përmirësimin e mënyrave ekzistuese të ofrimit të shërbimeve. Deri në dhjetor 2020, numri i qendrave të ofrimit të shërbimeve të integruara nën administrimin e ADISA-s arritën 20¹⁵⁹, ndërsa – deri në dhjetor 2019 – numri i shërbimeve nëpërmjet portalit e-Albania arritën 601.¹⁶⁰

ADISA është gjithashtu institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve nëpërmjet standardizimit të proceseve, mbledhjes së të dhënave për përvojën e qytetarëve, si dhe monitorimin e vlerësimit të proceseve të ofrimit të shërbimeve. Këto detyra janë përcaktuar që prej vitit 2019 nëpërmjet dy vendimeve të Këshillit të Ministrave.¹⁶¹ Manualit për Standardizimin e Ngritjes dhe Funksionimit të Sportelit Publik – i cili është miratuar nëpërmjet njërit prej dy vendimeve të KM – përfshin gjithashtu udhëzime për regjistrimin e ankesave nga qytetarët, por është e paqartë se si ato përpunohen. Manuali përfshin gjithashtu dispozita për përfitim të shërbimeve nga qytetarët me aftësi të kufizuara dhe përcakton tregues për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve. Vlerësimet e cilësisë bazohen në sondazhet e qytetarëve, numrin e kërkesave për shërbime, si dhe në numrin e ankesave të paraqitura dhe kohën e nevojshme për përpunimin e tyre.

157 Këto përfshijnë Ligjin nr. 13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve në sportel në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet e tjera nënligjore që rregullojnë politikën e ofrimit të shërbimeve, <http://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2016/05/Ligj-Nr-13-2016-Per-menyren-e-ofrimit-te-sherbimeve-publike-ne-sportel-ne-RSH.pdf>.

158 Shih Shtojcën 2 të Urdhrit të Kryeministrit 157, datë 20.10.2018 "Për masat e marra për të zbatuar qasjen e gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar".

159 ADISA, Raporti i Monitorimit të Strategjisë Janar-Dhjetor 2020 (Tiranë: ADISA, 2021), 16, <https://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Raport-i-Monitorimit-te-Strategjise-ADISA-2020-v7.pdf>.

160 Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, "Raport Vjetor Përmbledhës 2019", 76, <https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2020/11/Raporti-Permbledhes-AKSHI-2019.pdf>.

161 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 640, datë 02.10.2019 "Për autoritetin përgjegjës për sigurimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit dhe të rezultateve në punë", <http://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/14-VKM-nr-640-date-2.10.2019-P%C3%ABr-autoriteti-pergjegj%C3%ABs-p%C3%ABr-vler%C3%ABsimin-e-cil%C3%ABsise.pdf>; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 624, datë 26.10.2018 "Për miratimin e manualit për standardizimin e ngritjes dhe të funksionimit të sportelit publik", <http://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/8-VKM-Nr-624-date-26.10.2018-Manuali-Standarteve.pdf>.

Sipas raportit janar-qershor 2020 të ADISA-s, qendrat e integruara të ofrimit të shërbimeve u janë përgjigjur me sukses nevojave të qytetarëve me aftësi të kufizuara.¹⁶² Raporti i monitorimit të strategjisë së ofrimit të shërbimeve janar-dhjetor 2020 jep të dhëna mbi përvojën e qytetarëve në marrjen e shërbimeve, llojet e shërbimeve që kërkojnë dhe të ankesave të paraqitura. Megjithatë, këto të dhëna janë vetëm për qendrat e integruara të ofrimit të shërbimeve dhe nuk përfshijnë të dhëna nga përdorimi i portalit e-Albania ose të shërbimeve të tjera të ofruara nëpërmjet zyrave të institucioneve të qeverisë qendrore. Raporti përfshin informacione për përfshirjen (validimin) e shërbimeve të reja nëpërmjet ADISA-s.

Lidhur me cilësinë e shërbimeve që merren nëpërmjet ofruesve të posaçëm të shërbimeve – jo nëpërmjet e-Albania-s ose qendrave të integruara të ofrimit të shërbimeve – ofrohen pak të dhëna dhe informacione. Të dhënat për performancën e tyre i referohen vetëm sasisë së dokumenteve, hapave administrative dhe kohës e nevojshme për të marrë shërbimet. Këto të dhëna tregojnë përmirësime të dukshme në ofrimin e shërbimeve, por ato nuk përfshijnë të gjithë gamën e ofruesve të shërbimeve publike të qeverisjes qendrore dhe nuk përfshijnë as reagimet e qytetarëve për ofruesit e shërbimeve të institucioneve që janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të përzgjedhura në raportin e monitorimit të ADISA-s.¹⁶³

VI.2 ÇFARË MONITORON WEBER-I DHE SI?

Nën fushën e Ofritit të Shërbimeve, monitorohen tre Parime SIGMA.

- Parimi 1:** Politika për administratën shtetërore të orientuara drejt qytetarëve janë të vendosura dhe zbatohen në praktikë;
- Parimi 3:** Janë vendosur mekanizma për të siguruar cilësinë e shërbimeve publike;
- Parimi 4:** Përftimi i shërbimeve publike është i siguruar.

Nga këndvështrimi i shoqërisë civile dhe publikut të gjerë, këto parime mbartin rëndësinë më të madhe duke qenë se kanë të bëjnë me aspektet e jashtme (të drejtuara nga publiku) të administratës, të cilat janë thelbësore për sigurimin e përditshëm të shërbimeve administrative dhe kontaktit me administratën. Në këtë kuptim, këto janë parimet më të rëndësishme për cilësinë e jetës së përditshme të qytetarëve.

Qasja metodologjike për të monitoruar këto parime mbështetet, së pari, në perceptimin e publikut për politikën e ofritit të shërbimeve, duke përfshirë edhe prirjen e administratave për të përmirësuar shërbimet administrative bazuar në përshtypjet e qytetarëve. Kjo plotësohet me perceptimin e shoqërisë civile rreth aspekteve të veçanta të ofritit të shërbimeve. Për më tepër, qasja ndaj parimeve të zgjedhura shkon përtej thjesht perceptimeve, duke shqyrtuar aspekte të disponueshmërisë në internet dhe përfitimit të informacionit që administratat publikojnë në lidhje me shërbimet që ofrojnë.

Janë përdorur katër tregues, dy të matur plotësisht me të dhëna perceptimi (perceptime nga shoqëria civile dhe nga publiku) dhe dy duke përdorur ndërthurjen e perceptimit dhe të dhënave publike të disa institucioneve që ofrojnë shërbime të caktuara. Sondazhi i perceptimit publik përdori një kampionim me tri faza probabiliteti. Ai u përqendrua në ofrimin e shërbimeve të orientuara drejt qytetarëve në praktikë, duke mbuluar aspekte të ndryshme të ndërgjegjësismit, efikasitetit, digjitalizimit dhe mekanizmave që i mundësojnë publikut të japë përshtypje mbi shërbimet e marra.¹⁶⁴ Meqenëse sondazhi i perceptimit publik u krye gjatë pandemisë COVID-19, qytetarëve gjithashtu iu shtruan disa pyetje shtesë, të cilat kishin për qëllim të shqyrtonin interesin

¹⁶² ADISA, Raporti i Monitorimit të Strategjisë Janar-Qershor 2020 (Tiranë: ADISA, 2020), 5, <https://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2021/01/Raporti-i-Monitorimit-te-Strategjise-per-grupin-temati-kte-sherbimeve-publike-ADISA-2020.pdf>.

¹⁶³ Ofruesit e shërbimeve specifike të përfshira në raportin e ADISA-s janë: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Drejtoria e Përgjithshme e Regjistrat Civil, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor. ADISA, Raporti i Monitorimit të Strategjisë Janar-Dhjetor 2020, 23.

¹⁶⁴ Perceptimet janë hulumtuar duke përdorur një sondazh që synon publikun (të moshës 18 vjeç e lart) e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sondazhi i perceptimit të publikut përdori një kampionim të probabilitetit në shumë faza dhe u administrua duke ndërthurur intervistimin në internet dhe telefon të ndihmuar nga kompjuteri (CAWI dhe CATI), duke përdorur një pyetësor të standardizuar nëpërmjet sondazheve të omnibusit në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi dhe Serbi gjatë periudhës 5-30 maj 2020. Për Shqipërinë, kufiri i gabimit për kampionin prej 1007 qytetarëve është $\pm 3.14\%$, në nivelin e besimit prej 95%.

dhe përdorimin e shërbimeve elektronike të publikut që nga shfaqja pandemisë. Megjithatë, të dhënat e perceptimit nga këto pyetje nuk u përdorën për matjen e vlerave të treguesit.

Në matjen e përfuturit të shërbimeve administrative për grupe të nevojë dhe në zona të largëta, u përdorën të dhëna nga sondazhi i shoqërisë civile dhe nga fokus-grupet me OSHC-të e zgjedhura.¹⁶⁵ Fokus-grupet u kryen për plotësimin e të dhënave të sondazhit me gjetje cilësore. Gjendja dhe funksionimi i mekanizmave të dhënies së përshtypjeve të publikut mbi shërbimet e marra u shqyrtua duke ndërthurur të dhëna të perceptimit të publikut dhe të dhëna të publikuara faqet e internetit të pesë institucioneve ofruese të shërbimeve të përzgjedhura për t'u vlerësuar.¹⁶⁶ Gjithashtu, faqet e internetit të këtyre pesë institucioneve u qëmtuan për të vlerësuar lehtësinë e përdorimit të tyre dhe për të parë informacionin që ofronin për çmimet e shërbimeve që ofronin.

VI.3 REZULTATET E MONITORIMIT TË WEBER-IT

PARIMI 1: POLITIKA PËR ADMINISTRATËN SHETËRORE TË ORIENTUARA DREJT QYTETARËVE JANË TË VENDOSURA DHE ZBATOHEN NË PRAKTIKË

Tabela 16. Treguesi WeBER OSH P1 I1: Perceptimi i publikut mbi orientimin ndaj qytetarit të administratës shtetërore

Elementet e treguesit	Rezultatet
Qytetarët janë të vetëdijshëm për nismat ose projektet e thjeshtëzimit të shërbimeve administrative të qeverisë	2/2
Qytetarët konfirmojnë që nismat ose projektet e thjeshtëzimit të shërbimeve administrative të qeverisë kanë përmirësuar ofrimin e shërbimeve	4/4
Qytetarët konfirmojnë që marrëdhënia me administratën është bërë më e lehtë	4/4
Qytetarët konfirmojnë se koha e nevojshme për të marrë shërbime administrative është zvogëluar	4/4
Qytetarët gjykojnë se administrata po shkon drejt qeverisjes digjitale	2/2
Qytetarët janë në dijeni të disponueshmërisë së shërbimeve elektronike	2/2
Qytetarët kanë njohuri për mënyrat se si t'i përdorin shërbimet elektronike	1/2
Qytetarët i përdorin shërbimet elektronike	0/4
Qytetarët i gjykojnë shërbimet elektronike të lehta për t'u përdorur	2/2
Qytetarët konfirmojnë që administrata kërkon prej tyre komente për përmirësimin e mundshëm të shërbimeve administrative	1/2
Qytetarët konfirmojnë që administrata i përdor komentet e tyre për përmirësimin e mundshëm të shërbimeve administrative	2/4
Rezultati i përgjithshëm	24/32
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)¹⁶⁷	4

¹⁶⁵ Sondazhi i OSHC-ve u administrua nëpërmjet një pyetësori anonim në internet. Në Shqipëri, sondazhi u krye në periudhën nga 24 qershor deri më 29 korrik 2020. Metoda e mbledhjes së të dhënave përfshinte CASI (vetë-intervistim i ndihmuar nga kompjuteri). Kampioni i sondazhit ishte N = 81.


¹⁶⁶ Pesë shërbimet e përfshira ishin: 1) regjistrimi i pasurisë, 2) regjistrimi i biznesit 3) regjistrimi i automjetit 4) lëshimi i dokumenteve personale: pasaporta dhe letërnjoftime dhe 5) deklarata e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe pagesa saj. Institucionet përkatëse që janë përgjegjëse për këto shërbime janë: 1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, 2) Qendra Kombëtare e Biznesit, 3) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, 4) ALEAT, 5) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

¹⁶⁷ Shndërrimi i pikëve: 0-5 pikë = 0; 6-11 pikë = 1; 12-17 pikë = 2; 18-22 pikë = 3; 23-27 pikë = 4; 28-32 pikë = 5.

Vlerësimi për këtë tregues bazohet tërësisht në sondazhin e perceptimit të publikut. Kampioni përbëhet nga gjithsej 1007 të anketuar mbi 18 vjeç. Përgjigjet matin nivelin i dakordësisë të të anketuarve me pohime specifike mbi shkallën e njohjes, përdorimit dhe lehtësisë së marrjes së shërbimeve. Marzhi i gabimit për gjithë kampionin është $\pm 3.14\%$, në nivelin e besimit 95%. Baza (numri i të anketuarve që janë përgjigjur) për pyetjet e sondazhit ndryshonte nga 1007 në 338.

Rezultatet e sondazhit tregojnë se afërsisht dy të tretat (66%)¹⁶⁸ e qytetarëve janë në dijeni të nismave dhe projekteve të e thjeshtëzimit të shërbimeve administrative të qeverisë për qytetarët dhe bizneset. 84% e qytetarëve, të cilët janë në dijeni (757 të anketuar), pajtohen që ofrimi i shërbimeve është përmirësuar si rezultat i nismave për thjeshtëzimin e shërbimeve gjatë dy viteve të fundit.¹⁶⁹ Ndërkohë, 63%¹⁷⁰ e qytetarëve konfirmojnë që marrëdhënia me administratën është bërë më e lehtë dhe 61.7%¹⁷¹ e qytetarëve konfirmojnë që marrja e shërbimeve administrative merr më pak kohë. Në tërësi, 70.63% e qytetarëve pajtohen që administrata po shkon drejt digjitalizimit.¹⁷² Të gjithë këta elementë kanë rezultate më të larta se mesatarja rajonale. Ato janë gjithashtu dukshëm më të larta se ato të ciklit të mëparshëm të monitorimit, përveç një rënieje të vogël (3%) të të anketuarve që pohojnë se ofrimi i shërbimeve është përmirësuar si rezultat i nismave të thjeshtëzimit të shërbimeve administrative gjatë dy viteve të fundit..

Grafiku 22. Perceptimet e qytetarëve për lehtësinë e ofrimit të shërbimeve.



Dijenja për shërbimet elektronike është rritur me 20 përqind krahasuar me ciklin e mëparshëm të monitorimit, duke arritur kështu në 74%. Nga ana tjetër, nga ata që janë në dijeni të shërbimeve elektronike (746 të anketuar), pak më shumë se gjysma (57.6%) thonë se janë të informuar se si t'i përdorin ato. Kjo vlerë është më e vogël se mesatarja rajonale (72%). Gjithashtu, më pak se një e treta e qytetarëve që kanë dijeni për shërbimet elektronike i kanë përdorur ato gjatë dy viteve të fundit (29.4%), e cila është gjithashtu nën mesataren rajonale prej 39%. Sidoqoftë, 70.4% e atyre që kishin përdorur shërbimet elektronike (338 të anketuar) në dy vitet e fundit i konsiderojnë ato të lehta për t'u përdorur.

168 Në ciklin e mëparshëm të monitorimit ishte 50.4%.


169 Në ciklin e mëparshëm të monitorimit ishte 88.7%.

170 Në ciklin e mëparshëm të monitorimit ishte 44.5%.

171 Në ciklin e mëparshëm të monitorimit ishte 45.4%.

172 Në ciklin e mëparshëm të monitorimit ishte 55.6%.

Grafiku 23. Dijenja e publikut për shërbimet elektronike




Lidhur me perceptimet për mekanizmat për marrjen e komenteve nga qytetarët dhe përdorimin e tyre nga administrata për të përmirësuar dhënien e shërbimeve, vetëm 35%¹⁷³ e të anketuarve pajtohen që administrata kërkon komente nga qytetarët se si t'i përmirësojë shërbimet. Nga ky grup, 55.5%¹⁷⁴ besojnë se administrata vërtet i ka përdorur propozimet e qytetarëve për të përmirësuar shërbimet administrative gjatë dy viteve të fundit. Të dyja këto rezultate janë më të ulëta se mesatarja rajonale, e cila është 48% për mekanizmat e marrjes së komenteve të qytetarëve për përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe 64% për përdorimin përshtypjeve të qytetarëve për të përmirësuar shërbimet administrative.

173 Në ciklin e mëparshëm të monitorimit ishte 43.2%.

174 Në ciklin e mëparshëm të monitorimit ishte 84.8%.

Grafiku 24. Perceptimet e qytetarëve për përdorimin e përshtypjeve/sugjerimeve të tyre nga administrata




Analiza e përgjithshme tregon një prirje pozitive për ndërgjegjësimin dhe dijeninë për shërbimet e thjeshtuara administrative dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, duke shënuar kështu një rezultat mbi mesataren e rajonit. Megjithatë, lidhur me pyetjen për përdorimin e shërbimeve elektronike, numri i ulët i qytetarëve që janë përgjigjur nënkupton që përdorimi i tyre efektiv është mjaft i ulët. Arsye të mundshme për nivelin e ulët të përdorimit të tyre mund të jetë vështirësia e lidhjes me rrjetin ose mungesa e njohurive të mjaftueshme teknike për marrjen e shërbimeve nëpërmjet internetit, pasi shumica e qytetarëve që i përdorin ato raportojnë se janë të kënaqur prej tyre.

Nga ana tjetër, përgjigjet që nënkuptojnë një zvogëlim të përpjekjeve të administratës publike për të përmirësuar politikën e ofrimit të shërbimeve të saj nëpërmjet marrjes së përshtypjeve të qytetarëve duhet të shqyrtohet më tej, por ato tregojnë se politika e ofrimit të shërbimeve nuk është e orientuar sa duhet drejt nevojave të qytetarëve.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi OSH P1 I1: Perceptimi publik i orientimit të administratës shtetërore drejt qytetarit




PARIMI 3: JANË VENDOSUR MEKANIZMA PËR TË SIGURUAR CILËSINË E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Tabela 17. Treguesi WeBER OSH P3 I1: Perceptimi i publikut dhe disponueshmëria e informacionit për reagimet e qytetarëve në lidhje me cilësinë e shërbimeve administrative

Elementet e treguesit	Rezultatet
Qytetarët konsiderojnë se kanë mundësinë të japin sugjerime për cilësinë e shërbimeve administrative	1/2
Qytetarët i perceptojnë mekanizmat e dhënies së përshtypjeve/sugjerimeve si të lehta për t'u përdorur	2/4
Qytetarët e perceptojnë veten ose shoqërinë civile si të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve administrative	0/4
Qytetarët mendojnë që shërbimet administrative janë përmirësuar si rezultat i monitorimit dhe vlerësimit të qytetarëve	2/4
Informacioni bazë në lidhje me përshtypjet e qytetarëve për shërbimet administrative është i disponueshëm publikisht	0/4
Informacioni i avancuar në lidhje me përshtypjet e qytetarëve për shërbimet administrative është i disponueshëm publikisht	0/2
Rezultati i përgjithshëm	5/20
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)¹⁷⁵	1

Vlerësimi për këtë tregues bazohet në rezultatet e sondazhit të perceptimit të publikut dhe qëmtimit të faqeve në rrjet të institucioneve kryesore të cilat ofrojnë shërbime administrative. Baza për pyetjet e sondazhit shkon nga 1007 në 278 e të anketuarve. Bazuar në rezultatet e sondazhit, afërsisht një e treta e qytetarëve (32%) thonë se e kanë mundësinë për të dhënë përshtypje/sugjerime për cilësinë e shërbimeve administrative.¹⁷⁶ 36% e qytetarëve që kanë dhënë komente (319 të anketuar) për përdorimin e shërbimeve administrative i konsiderojnë mekanizmat për të dhënë mendimin e tyre si të lehta për t'u përdorur.¹⁷⁷

Grafiku 25. Perceptimet e qytetarëve për mekanizmat e dhënies së përshtypjeve/sugjerimeve



Kur u pyetën nëse ata perceptojnë që vetë qytetarët ose shoqëria civile janë të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve administrative, 29.5% e qytetarëve pajtohen me këtë pohim.¹⁷⁸ 60% e atyre që u përgjigjën pozitivisht (278 të anketuar) mendojnë që shërbimet administrative janë përmirësuar si rezultat i monitorimit dhe vlerësimit nga qytetarët, krahasuar me 84.4% në ciklin e mëparshëm të monitorimit.


¹⁷⁵ Konvertimi i pikëve: 0-4 pikë = 0; 5-8 pikë = 1; 9-11 pikë = 2; 12-14 pikë = 3; 15-17 pikë = 4; 18-20 pikë = 5..

¹⁷⁶ Në ciklin mëparshëm të monitorimit ishte 35.2%.

¹⁷⁷ Në ciklin e mëparshëm të monitorimit ishte 86.6%.

¹⁷⁸ Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 35%.

Grafiku 26. Perceptimet e qytetarëve për monitorimin e shoqërisë civile




Analiza e faqeve të internetit përfshiu: (1) Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (regjistrimi i pronës/lëshimi i certifikatave të pronës); (2) Qendra Kombëtare e Biznesit (regjistrimi i biznesit); (3) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (regjistrimi i automjeteve); (4) ALEAT (lëshimi i pasaportave/letërnjoftimeve; dhe (5) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (deklarata dhe pagesa e TVSH-së). Me përjashtim të regjistrimit të automjeteve, ofruesit e tjerë të përzgjedhur të shërbimeve nuk ofrojnë informacion në internet për përshtypjet e qytetarëve për cilësinë e shërbimeve të dhëna.

Krahasuar me monitorimin e reformës gjatë 2017/2018, ka një rënie të dukshme të perceptimit të publikut për efektshmërinë e mekanizmave të vendosura për të siguruar që sugjerimet e tyre të merren parasysh. Ka një rënie mjaft të pjerrët (nga 86.6% në 36%) të numrit të qytetarëve që gjykojnë se mekanizmat për dhënie e përshtypjeve të tyre për shërbimet që marrin janë të lehta për t'u përdorur. Perceptimet se OSHC-të janë të angazhuara në monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve administrative gjithashtu kanë rënë (nga 35% në 29.5%). Ka gjithashtu një rënie të ndjeshme të qytetarëve që perceptojnë se puna e monitorimit dhe vlerësimit të OSHC-ve ka përmirësuar shërbimet administrative (nga 85% në 60%). Për më tepër, rezultatet e sondazhit të perceptimit publik për cilësinë e shërbimeve tregojnë një shkallë kënaqësie më të ulët sesa mesatarja rajonale.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi OSH P3 I1: Perceptimi i publikut dhe disponueshmëria e informacionit për reagimet e qytetarëve lidhur me cilësinë e shërbimeve administrative




PARIMI 4: PËRFTIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE ËSHTË I SIGURUAR

Tabela 18. Treguesi WeBER OSH P4 I1: Perceptimi i OSHC-ve për përfitim të shërbimeve administrative

Elementet e treguesit	Rezultatet
OSHC-të konfirmojnë se rrjeti territorial për dhënien e shërbimeve administrative është i përshtatshëm	0/4
OSHC-të konfirmojnë që qendrat me një ndalesë mund të përdoren nga të gjithë	0/4
OSHC-të gjykojnë që shërbimet administrative ofrohen në një mënyrë që plotëson nevojat individuale të grupeve në nevojë	0/4
OSHC-të konfirmojnë që ofruesit e shërbimeve administrative janë trajnuar si të trajtojnë grupet në nevojë	0/2
OSHC-të konfirmojnë që administrata ofron mënyra të ndryshme përzgjedhjeje për marrjen e shërbimeve administrative	1/2
OSHC-të konfirmojnë që shërbimet elektronike janë lehtësisht të përfutueshme për personat me aftësi të kufizuara	0/2
Rezultati i përgjithshëm	1/18
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)¹⁷⁹	0

Vlerësimi për këtë tregues bazohet në rezultatet e sondazhit të OSHC-ve dhe diskutimet me fokus-grupe të OSHC-ve kombëtare dhe lokale veprimtaria e të cilave përqendrohet në mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara ose të grupeve shoqërore në nevojë e të mënjanuar. Fokus-grupet u mbledhën në tetor 2020, ndërsa kampioni i OSHC-ve të anketuara përbëhej nga 81 organizata, ndërsa baza (të anketuarit që u përgjigjën) për pyetjet e këtij treguesi ishte 69. Vetëm 17.4% e OSHC-ve të anketuara pajtohen me pohimin se shërbimet administrative janë shpërndarë në mënyrë të përshtatshme për t'u arritur lehtësisht nga qytetarët.¹⁸⁰ Përshtypjet mbi funksionimin e zyrave me një ndalesë (one-stop-shop) paraqiten më mirë, pasi 23.2% i konsiderojnë ato lehtësisht të arritshme¹⁸¹ dhe 40.6% e të anketuarve pajtohen¹⁸² që mënyrat e marrjes së shërbimeve administrative janë të larmishme.

Grafiku 27. Përfitimi i shërbimeve



Sa i përket përfitimit të shërbimeve elektronike nga grupet në nevojë, vetëm 8.7% i konsiderojnë ato si lehtësisht të arritshme¹⁸³, ndërsa pothuajse dy të tretat (65.2%) nuk pajtohet me këtë pohim. Për më tepër, vetëm 10.2%

179 Konvertimi i pikëve: 0-3 pikë = 0; 4-6 pikë = 1; 7-9 pikë = 2; 10-12 pikë = 3; 13-15 pikë = 4; 16-18 pikë = 5.

180 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 22.9%.


181 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 33.3%.

182 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 35.6%.

183 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 11.4%.

e të anketuarve pohojnë se nevojat e grupeve në nevojë janë marrë në konsideratë për ofrimin e shërbimeve administrative¹⁸⁴, ndërsa shumica (59.4%) nuk janë dakord. Lidhur me trajnimin e personelit për ofrimin e shërbimeve për t'iu përgjigjur nevojave të grupeve në nevojë, 17.4% e të anketuarve i konsiderojnë ata si të trajnuar¹⁸⁵, ndërkohë që sërish shumica nuk pajtohet me këtë pohim (50.7%).

Grafiku 28. Përfitimi i shërbimeve për grupet në nevojë



Sfidat e përfitimit të shërbimeve u risollën në diskutimet në fokus-grupe. Sipas OSHC-ve lokale dhe kombëtare, shërbimet publike shpërndahen në mënyrë të pabarabartë midis zonave rurale dhe urbane, si dhe midis zonave qendrore dhe periferike të qyteteve. Mundësia e përdorimit të shërbimeve është problematike për qytetarët që jetojnë në zonat rurale dhe për ata që jetojnë në periferitë gjeografike dhe sociale, për shkak të mungesës së arsimit ose për shkak të infrastrukturës së dobët.

Krahasuar me rezultatet e monitorimit të reformës gjatë 2017/2018, të dhënat tregojnë se ekziston një perceptim pozitiv në rritje (+ 5%) për diversifikimin e mënyrave të ofrimit të shërbimeve administrative në Shqipëri, për përshtatjen e tyre ndaj nevojave të grupeve në nevojë (+ 3.4%), si dhe për trajnimin e stafit për t'iu shërbyer siç duhet këtyre grupeve (+ 7.1%). Sidoqoftë, perceptimi për përfitimin e shërbimeve elektronike të grupeve në nevojë ka rënë paksa (-2.7%), ashtu si perceptimi mbi shpërndarjen e duhur territoriale të shërbimeve administrative (-5.5%). Në të njëjtën vazhde me këto rënie është rënia prej 10% e perceptimit pozitiv për mundësitë e përfitimit të shërbimeve nëpërmjet zyrave me një ndalesë (qendrat e integruara të ofrimit të shërbimeve).

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi OSH P4 I1: Perceptimi i OSHC-ve për përfitimin e shërbimeve administrative



184 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 6.8%.

185 Në ciklin e fundit të monitorimit, rezultati ishte 10.3%.

Tabela 19. Treguesi WeBER OSH P4 I2: Disponueshmëria e informacionit në lidhje me përfitim të shërbimeve të administratës nëpërmjet faqeve të internetit të ofruesve të shërbimeve

Elementet e treguesit	Rezultatet
Faqet e internetit të ofruesve të shërbimeve administrative përfshijnë kontaktet për ofrimin e shërbimeve	4/4
Faqet e internetit të ofruesve të shërbimeve administrative përfshijnë informacion bazë procedurale për përfitim të shërbimeve administrative	2/4
Faqet e internetit të ofruesve të shërbimeve administrative përfshijnë udhëzime miqësore ndaj qytetarët për përdorimin e shërbimeve administrative	1/2
Faqet e internetit të ofruesve të shërbimeve administrative përfshijnë informacion për të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve	2/2
Secili institucion që ofron shërbime administrative në nivel qendror publikon informacion për çmimin e shërbimeve të ofruara	4/4
Informacioni për çmimet e shërbimeve administrative shpreh qartë dallimin midis shërbimeve elektronike dhe atyre fizike	1/2
Informacioni për shërbimet administrative është i disponueshëm në formate të të dhënave përpunueshme (open data)	0/2
Rezultati i përgjithshëm	14/20
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)¹⁸⁶	3

Vlerësimi për këtë tregues bazohet ekskluzivisht në informacionin e publikuar të institucioneve përkatëse të cilat ofrojnë shërbime administrative për: regjistrimin e pronës, regjistrimin e automjeteve, regjistrimin e biznesit, pajisjen me letërnjoftim/pasaportë, pagesën e TVSH-së. Kontaktet për secilin nga këto ofruesit e këtyre shërbimeve mund të gjendet në faqet e tyre të internetit. Me përjashtim të regjistrimit të pasurisë dhe regjistrimit të automjetit, informacioni bazë për mënyrën e përdorimit të shërbimeve administrative që ofrohen është i publikuar.


Gjithashtu, përshkrimet e llojeve të shërbimeve (përveç regjistrimit të pasurisë) zakonisht jepen, por formularët origjinalë për marrjen e shërbimeve mund të shkarkohen vetëm për regjistrimin e biznesit dhe për pagesën e TVSH-së. Po ashtu, udhëzime të thjeshtëzuara për përdoruesit (video ose grafika informuese) mund të gjenden vetëm për regjistrimin e biznesit dhe automjeteve, si dhe për shërbimet e administratës tatimore. Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve – përsa i përket dokumentacionit dhe informacionit që përdoruesit duhet të paraqesin – dhe çmimet e shërbimeve publikohen për të gjitha shërbimet, përveç për regjistrimin e pronës. Dallimet e çmimeve midis shërbimit fizik dhe atij elektronik janë të përfshira për ato shërbime që mund të përftohen në mënyrë elektronike, që përfshijnë regjistrimin e biznesit, lëshimin e pasaportës/letërnjoftimit dhe për pagesën e TVSH-së. Informacioni që është i disponueshëm publikisht nuk jepet nëpërmjet një formati të të dhënave të përpunueshme (open data).

Është shqetësuese që pak informacion jepet për shërbimin e regjistrimit të pronave, duke qenë se kjo është një çështje akute në Shqipëri. Vlerësimi për shërbimin e regjistrimit të pronave ishte më i lartë në ciklin e mëparshëm të monitorimit, në katër nga shtatë elementët që maten. Problemet e tanishme të mungesës së informacionit të publikuar në rrjet prej Agjencisë Shtetërore të Kadastrës mund të lidhen me procesin e ngritjes së një institucioni të ri pas shkrirjes së Zyrë së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale.

¹⁸⁶ Konvertimi i pikëve: 0-4 pikë = 0; 5-8 pikë = 1; 9-11 pikë = 2; 12-14 pikë = 3; 15-17 pikë = 4; 18-20 pikë = 5.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi OSH P4 I2: Disponueshmëria e informacionit në lidhje me përfitim të shërbimeve të administratës nëpërmjet faqeve të internetit të ofruesve të shërbimeve



VI.4 PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE: OFRIMI I SHËRBIMEVE

Edhe raportet e qeverisë edhe rezultatet e sondazhit të perceptimit publik konfirmojnë përpjekjet e qeverisë drejt digjitalizimit të shërbimeve. Portali e-Albania dhe qendrat e integruara të ofrimit të shërbimeve kanë përmirësuar disponueshmërinë publike të shërbimeve dhe është bërë përparim i konsiderueshëm në sigurimin e tyre. Rezultatet e sondazhit të perceptimit publik gjithashtu konfirmojnë që marrja e shërbimeve është bërë më e lehtë dhe është zvogëluar koha për marrjen e tyre në dy vitet e fundit, ndërkohë që dijenia për disponueshmërinë e shërbimeve elektronike është dukshëm më e lartë se në ciklin e mëparshëm të monitorimit. Sidoqoftë, mbeten ende probleme në lidhje me përfitim të shërbimeve dhe qasjen e qeverisë ndaj një politike të ofrimit të shërbimeve me në qendër qytetarët.

Rezultatet e sondazhit të perceptimit publik tregojnë një përdorim të pakët të shërbimeve elektronike, i cili është nën mesataren e rajonit. Perceptimet pozitive për shkallën e interesit të qeverisë për të kërkuar përshtypjet dhe sugjerimet e qytetarëve për shërbimet e marra gjithashtu kanë rënë ndjeshëm në krahasim me ciklin e mëparshëm të monitorimit. Përqindja e perceptimeve pozitive për këtë çështje është më e ulët sesa mesatarja rajonale. Vetëdija e lartë e publikut për shërbimet elektronike përkundër përdorimit të pakët dhe mungesës së kërkesës, mbledhjes dhe përdorimit të mjaftueshëm të përshtypjeve të qytetarëve nga qeveria tregojnë se politika e ofrimit të shërbimeve nuk është e orientuar sa duhet drejt lehtësisë së përfuturit dhe përdorimit të tyre. Mungesa e informacionit për përvojën e qytetarëve për përdorimin e shërbimeve që ofrohen nga pesë institucionet e marra në shqyrtim për këtë kapitull të RAP-it tregojnë se politikat e tyre të ofrimit të shërbimeve kanë nevojë të jenë më të orientuara drejt qytetarëve.

Pavarësisht këtyre sfidave, disa ofrues shërbimesh kanë rezultate më të mira se të tjerët. Kështu, institucionet përgjegjëse për regjistrimin e biznesit (Qendra Kombëtare e Biznesit) dhe të automjeteve (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) dhe – deri në një farë mase – institucioni përgjegjës për shërbimet për tatimin e vlerës së shtuar (TVSH) (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) publikojnë informacion të mjaftueshëm për shërbimet që ata ofrojnë, mënyrat për t'i marrë ato dhe të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve. Nga ana tjetër, institucioni përgjegjës për shërbimet e dokumenteve të identifikimit personal (ALEAT) dhe ai për regjistrimin e pasurisë së patundshme (Agjencia Shtetërore e Kadastrës) duhet të përmirësojnë informacionin që ofrojnë dhe të kenë qasje të efektshme për të marrë përshtypjet e qytetarëve për cilësinë e shërbimeve që ofrojnë.

VI.5 REKOMANDIME PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT

Gjurmimi i rekomandimeve nga Monitorimi i RAP 2017/2108

Rekomandimi	Statusi	Koment
Qeveria duhet ta zgjerojë punën e saj për thjeshtimin e proceseve administrative në mënyrë që të shkurtojë burokracinë dhe të përmirësojë ofrimin e shërbimeve.	I zbatuar	Sipas sondazhit të perceptimit publik dhe raportit të DAP-it për vitin 2020, sportelet me një ndalesë dhe shërbimet elektronike janë zgjeruar dhe marrëdhënia me administratën është bërë më e lehtë.
Qeveria duhet të angazhohet në aktivitete që synojnë posaçërisht rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e shërbimeve elektronike dhe rritjen e vetëdijësimit të publikut për portalin e-Albania.	I zbatuar	Sipas sondazhit të perceptimit të publikut, 74% e publikut është në dijeni të shërbimeve elektronike.
Qeveria duhet të identifikojë boshllëqet në ofrimin e shërbimeve elektronike dhe t'u kushtojë vëmendje ndryshimeve dhe dallimeve në përdorim ndërmjet grupeve të ndryshme socio-ekonomikë të popullsisë, veçanërisht të moshuarit, më pak të arsimuar dhe ata që jetojnë në zonat rurale.	I pazbatuar	Sondazhi i OSHC-ve dhe diskutimet në fokus-grupe konfirmojnë papërshtatshmërinë e mbulimit territorial të shërbimeve administrative dhe mundësisë së qasjes për grupe të cënueshme.
Qeveria duhet t'i japë përparësi zhvillimit të një kornize të gjerë politike për modelet e sigurimit të cilësisë në administratën publike.	I pazbatuar	Pesë institucionet ofruese të shërbimeve të marra në shqyrtim nuk publikojnë raporte për përdorimin e komenteve të qytetarëve për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve.
Ofruesit e shërbimeve duhet të mundësojnë dhe promovojnë në faqet e tyre të internetit mekanizma për dhënien e komenteve, që synojnë përmirësimin e shërbimeve administrative.	Zbatuar pjesërisht	Shërbimet e regjistrimit të biznesit dhe automjeteve përfshijnë dhe promovojnë mekanizmat për dhënien e komenteve.
Ofruesit e shërbimeve duhet të publikojnë në mënyrë aktive të dhëna informuese mbi përshtypjet e marra nga qytetarët për shërbimet administrative.	I pazbatuar	Pesë institucionet ofruese të shërbimeve të marra në shqyrtim nuk ofrojnë informacion bazë dhe të përparuar për përshtypjet e qytetarëve për shërbimet administrative.
Qeveria duhet të promovojë monitorimin gjithëpërfshirës të ofrimit të shërbimeve nga shoqëria civile dhe qytetarët.	I pazbatuar	Sipas diskutimeve të fokus-grupeve të OSHC-ve, ofruesit e shërbimeve dhe qeveria nuk kërkojnë pjesëmarrje të shoqërisë civile në hartimin dhe monitorimin e politikave të ofrimit të shërbimeve.
Qeveria duhet të trajtojë sfidat e përfuturit të shërbimeve nga shtetasit me aftësi të kufizuara dhe të rishikojë politikat dhe shërbimet specifike për këto grupe për të identifikuar boshllëqe dhe pengesa dhe për të planifikuar veprimet e nevojshme për t'i kapërcyer ato.	I pazbatuar	Diskutimet e fokus-grupeve të OSHC-ve konfirmojnë se mënyrat e përfuturit të shërbimeve për grupet në nevojë janë të papërshtatshme.
Ofruesit e shërbimeve duhet të sigurojnë që stafi i tyre është trajnuar për të komunikuar dhe ndihmuar personat me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera në nevojë.	I pazbatuar	Sipas sondazhit të OSHC-ve, shumica e tyre nuk i konsiderojnë ofruesit e shërbimeve administrative si të trajnuar si duhet për mënyrën e trajtimit të grupeve në nevojë.
ADISA duhet të vërë në dispozicion informacionin për shërbimet administrative në formate të hapura të dhënash.	I pazbatuar	Informacioni për shërbimet administrative nuk është i disponueshëm në formate të dhënave të përpunueshme (open data).

Rekomandimet e Monitorimit të RAP 2019/2020

Më poshtë përfshihen rekomandime të trajtuara nga cikli i mëparshëm i monitorimit, por ato janë zgjeruar për të ofruar këshilla shtesë për institucionet dhe proceset përkatëse për ofrimin e shërbimeve administrative.

- ADISA duhet të vlerësojë cilësinë e zbatimit të politikës së ofrimit të shërbimeve: jo vetëm të qendrave të integruara të shërbimeve që ajo drejton, por gjithashtu edhe të shërbimeve kryesore administrative (regjistrimi i pronës, regjistrimi i automjeteve, shërbimet për pagesën e taksave, regjistrimi i biznesit dhe shërbimet për dokumentet identifikuese).
- ADISA duhet të identifikojë boshllëqet në zbatimin e politikës së ofrimit të shërbimeve, veçanërisht në lidhje me dallimet midis: (a) zonave rurale dhe atyre urbane; (b) qendrës dhe periferisë; (c) qytetarëve

të arsimuar dhe atyre më pak të arsimuar; (d) grupeve shoqërore që nuk kanë nevojë të posaçme dhe atyre të përjashtuara dhe në nevojë. Për këtë qëllim, ADISA duhet të angazhojë intensivisht OSHC-të që punojnë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe të grupeve të përjashtuara nga shoqëria për të përmirësuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve për këto grupe.

3. ADISA duhet t'i japë përparësi zhvillimit të një kornize tërësore të politikave për sigurimin e cilësisë së shërbimeve administrative. Për këtë qëllim, mbledhja e të dhënave dhe raportimi për përvojën e qytetarëve gjatë marrjes së shërbimeve është thelbësore.
4. Institucionet ofruese të shërbimeve administrative duhet të mundësojnë dhe promovojnë në faqet e tyre të internetit mundësitë për të dhënë komente për përmirësimin e shërbimeve administrative.
5. Institucionet ofruese të shërbimeve administrative duhet të publikojnë në mënyrë aktive të dhëna bazë në lidhje me përshtypjet e qytetarëve për shërbimet administrative që ata marrin.
6. Qeveria duhet të promovojë monitorimin gjithëpërfshirës të ofrimit të shërbimeve nga shoqëria civile dhe qytetarët.
7. Institucionet ofruese të shërbimeve administrative duhet të sigurojnë që personeli i tyre të jetë i trajnuar për të komunikuar në mënyrë profesionale dhe për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera në nevojë.
8. ADISA dhe institucionet e tjera ofruese të shërbimeve administrative duhet të bëjnë të disponueshëm informacionin mbi shërbimet administrative në formate të dhënave të përpunueshme (open data).

VII. MIRADMINISTRIMI I FINANCEVE PUBLIKE

VII.1 TREGUESIT WEBER TË PËRDORUR NË MIRADMINISTRIMIN E FINANCIVE PUBLIKE DHE VLERAT PËR SHQIPËRINË

P5 I1: Transparenca dhe mundësia e përfuturit të dokumenteve buxhetore					
0	1	2	3	4	5
P6 & 8 I1: Disponueshmëria publike e informacionit për kontrollin e brendshëm financiar publik dhe të mbikëqyrjes parlamentare					
0	1	2	3	4	5
P11 & 13 I1: Disponueshmëria publike e informacionit në lidhje me prokurimin publik					
0	1	2	3	4	5
P16 I1: Komunikimi dhe bashkëpunimi i autoritetit kombëtar të auditimit me publikun në lidhje me punën e institucionit					
0	1	2	3	4	5

Gjendja për miradministrimin e financave publike (MFP)

Tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia COVID-19 shkaktuan dëme të konsiderueshme në ekonominë shqiptare. Në vitin 2020, produkti i brendshëm bruto (PBB) i vendit u ul me 7.5% ndërsa borxhi i qeverisë arriti në 81.9% të PBB-së – një rritje prej 14.1% nga 2019.¹⁸⁷

Shqipëria miratoi kornizën e re strategjike të miradministrit të financave publike në vitin 2019 nëpërmjet Strategjisë së Miradministrit të Financave Publike 2019-2022.¹⁸⁸ Strategjia e re bazohet në atë të mëparshmen, e cila do të zgjaste deri në vitin 2020. Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë së MFP-së është të mundësojë një buxhet më të mirëbalancuar dhe të qendrueshëm me një raport të ulur të borxhit nëpërmjet kontrollit dhe miradministrit më të fortë financiar, auditimeve, si dhe duke u kujdesur që zbatimi i buxhetit është në përputhje me politikat e qeverisë. Strategjia ka gjashtë objektiva specifike: (i) një kuadër fiskal i qendrueshëm dhe i kujdesshëm, (ii) planifikim i mirintegruar dhe efikas, (iii) rritje e kapaciteteve për mbledhjen e të ardhurave, (iv) zbatim efikas i buxhetit, (v) transparencë e financave publike, (vi) kontroll të brendshëm të efektshëm dhe (vii) mbikëqyrje të efektshme të jashtme të financave publike.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka vërejtur disa rreziqe fiskale dhe mangësi në administrimin e financave publike. FMN-ja paralajmëron që përjashtimet tatimore të posaçme të kryera në vitin 2019 do të dobësojnë bazën fiskale dhe se fondet e rindërtimit të tërmetit duhet t'i nënshtrohen kontrolleve të nevojshme të MFP-së, duke përfshirë planifikimin nëpërmjet procesit të buxhetimit.¹⁸⁹ Në veçanti theksohen shqetësimet në lidhje me strukturat institucionale dhe kuadrin rregullator për prokurimin publik dhe partneritetin publik-privat (PPP) për shkak të rreziqeve të tyre fiskale. Duhet të vendosen mekanizma të forta të mbikëqyrjes, monitorimit, raportimit dhe auditimit.¹⁹⁰ Pavarësia e Komisionit të Prokurimit Publik – i cili merret me ankesat për proceset e tenderimit publik – është forcuar nëpërmjet zgjedhjes së komisionerëve nga Kuvendi. Megjithatë, administrimi i investimeve publike duhet të forcohet duke ndërtuar një proces të integruar për përgatitjen, vendosjen e përparësive dhe vlerësimin e të gjitha projekteve të investimeve publike, përfshirë PPP-të, ndërsa përdorimi i PPP-ve të pakërkua duhet të parandalohet.¹⁹¹

Rekomandimet e SIGMA-s, Bankës Botërore dhe FMN-së janë përdorur si referencë për Strategjinë e MFP-së. Ligji për PPP-të është ndryshuar për t'i dhënë ministrisë së Financave dhe Ekonomisë autoritet të qartë për të vlerësuar dhe miratuar projektet e partneritetit publik-privat, por kjo nuk e ka parandaluar zgjerimin e PPP-ve,

187 Fondi Monetar Ndërkombëtar, "Albania: Selected Economic Indicators, 2016–21" në IMF Country Report No. 20/309 (Washington, DC: IMF Publishing Services, 2020), <https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2020/11/30/Albania-First-Post-Program-Monitoring-Press-Release-Staff-Raport-and-Statement-by-the-49923>.

188 Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Strategjia Sektoriale e Miradministrit të Financave Publike 2019-2022 (Dhjetor 2019), <https://new.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/06/PFM-Strategy-2019-2022-ENG.pdf>.

189 Fondi Monetar Ndërkombëtar, IMF Country Report No. 20/309, 10.

190 Fondi Monetar Ndërkombëtar, 10.

191 Fondi Monetar Ndërkombëtar, 11.

e për rrjedhojë edhe të rreziqeve financiare që lindin prej tyre. Ligji i buxhetit të vitit 2021 përcaktoi kufirin e vlerës për PPP-të në 49.8% të PBB-së.¹⁹²

Strategjia e MFP-së vëren se nevojiten kapacitete më të forta analitike në agjencitë qeveritare dhe në ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) për të vlerësuar siç duhet raportin midis kostos dhe përfitim të PPP-ve dhe për të përmirësuar hartimin dhe mbikëqyrjen e këtyre projekteve, ndërsa kapaciteti i MFE-së për të vlerësuar dhe monitoruar investimet publike – përfshirë PPP-të – është i fragmentuar.¹⁹³ Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se një çështje kyçe e lidhur me kontrollin e PPP-ve – përkatësisht, propozimet e pakërkua – vazhdon të jetë një praktikë e ligjshme pavarësisht ndryshimeve të fundit në ligjin për PPP-të. Ky ndryshim i lejon ato vetëm për projekte që lidhen me prodhimin dhe infrastrukturën e energjisë dhe në ndërtimin dhe sigurimin e shërbimeve për portet dhe aeroportet.

MFE-ja ka miratuar një dokument politikash për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP) në Shqipëri për vitet 2021-2022 dhe ka aprovuar metodologjinë për rishikimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm për të analizuar dhe vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm të njësive qeverisëse të përgjithshme dhe për të nxjerrë rekomandime për të trajtuar mangësitë.¹⁹⁴ Ndërkohë, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ka hartuar udhëzuesin e auditimit për zbatimin e buxhetit të qeverisë dhe është krijuar një sekretari e përbashkët midis MFE-së dhe KLSH-së për të përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.¹⁹⁵ KLSH-ja është në proces të rishikimit të manualit të auditimit financiar në përputhje me rekomandimet e SIGMA-s.¹⁹⁶

VII.2 ÇFARË MONITORON WEBER-I DHE SI?

Monitorimi i fushës së MFP-së kryhet nëpërmjet gjashtë Parimeve SIGMA.

- Parimi 5:** Është siguruar raportimi dhe kontrolli transparent i buxhetit.
- Parimi 6:** Sistemi i funksionimit të kontrollit të brendshëm përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat, ndërsa zbatimi i tij nga institucionet buxhetore është në përputhje me legjislacionin që rregullon miradministrimin e financave publike dhe administratën publike në përgjithësi.
- Parimi 8:** Sistemi i funksionimit të auditit të brendshëm pasqyron standardet ndërkombëtare dhe zbatimi i tij nga institucionet buxhetore është në përputhje me legjislacionin që rregullon administratën publike dhe miradministrimin e financave publike në përgjithësi.
- Parimi 11:** Gjenden kapacitete institucionale dhe administrative qendrore për të hartuar, zbatuar dhe monitoruar politikën e prokurimit në mënyrë të efektshme dhe efikase.
- Parimi 13:** Proceset e prokurimit publik përputhen me parimet themelore të trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe transparencës, ndërsa sigurojnë përdorimin më efikas të mundshëm të fondeve publike dhe përdorimin më të mirë të teknikave dhe metodave moderne të prokurimit.
- Parimi 16:** Autoritetit kombëtar i auditimit (Kontrolli i Lartë i Shtetit) zbaton standardet në mënyrë të paanshme dhe objektive për të siguruar auditime me cilësi të lartë, të cilat ndikojnë pozitivisht në funksionimin e sektorit publik.

Ndërsa këto parime vlerësohen hollësisht nga SIGMA, WeBER-i përqendrohet dhe përforcon elementet e transparencës dhe përfutimit të informacionit, komunikimit me publikun, si dhe të qasjes proaktive dhe miqësore ndaj qytetarëve për informimin e tyre.

Si zhvillim shtesë prej monitorimit të parë, u përpilua një tregues i ri për të mbuluar nën-fushën e prokurimit publik të MFP (Parimet SIGMA 11 dhe 13), i cili nuk qe i monitoruar në ciklin e parë. Kështu, në këtë cikël monitorimi u

¹⁹² Neni 18, Ligji nr. 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/11/16/137>.

¹⁹³ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Strategjia Sektoriale e Miradministrit të Financave Publike 2019-2022 (Tiranë: MFE, 2020), 27.

¹⁹⁴ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Raporti Vjetor i Monitorimit 2019: Strategjia e PFM 2019-2022, 28, <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/09/2019-PFM-Annual-Monitoring-Report.pdf>.

¹⁹⁵ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Raporti Vjetor i Monitorimit 2019: Strategjia e MFP 2019-2022, 32.

¹⁹⁶ Kontrolli i Lartë i Shtetit, Raporti i Monitorimit të Strategjisë së Zhvillimit 2018-2022 dhe i Planit të Veprimit për vitin 2019, 17, http://www.klsh.org.al/web/raport_monitorimi_sdp_klsh_22_4_2019_5681.pdf.

matën katër tregues. Me këtë shtesë, studiuesit e WeBER-it monitoruan politikën e prokurimit publik për herë të parë, së bashku me politikën e buxhetit vjetor, KBFP-në dhe auditimet e jashtme. Meqenëse u mat për herë të parë, treguesi për prokurimin publik në këtë cikël monitorimi përcakton vlerat fillestare në këtë fushë.

Treguesi i parë vlerëson transparencën dhe disponueshmërinë e dokumenteve buxhetore, duke matur sa të përfutshme janë për qytetarët dokumentet kryesore buxhetore (të tilla si buxheti vjetor dhe raportet për zbatimin e tij), si dhe në ç'masë paraqiten dhe përshtaten me nevojat e qytetarëve dhe shoqërisë civile. Për këtë qëllim, burimet kryesore të përdorura janë të dhënat e disponueshme në faqet e internetit të ministrisë përgjegjëse për financat, si edhe portalet zyrtare qeveritare dhe portalet e të dhënave të përpunueshme (open data).

Treguesi i dytë mat disponueshmërinë dhe komunikimin e informacionit thelbësor për KBFP-në për publikun dhe palët e tjera të interesuara (duke përfshirë raporte tërësore, rishikime të cilësisë së auditit të brendshëm (AB) dhe informacione procedurale të miradministrimi dhe kontrolli financiar (MKF). Analiza merr në konsideratë faqet zyrtare të internetit dhe dokumentet e mundësuar nga institucionet qeveritare të ngarkuara me politikat për KBFP-së. Janë analizuar faqet e internetit të gjitha ministrive për disponueshmërinë e informacionit specifik në lidhje me MKF-në, ndërsa dokumentacioni zyrtar parlamentar shërben për matjen e shpeshtisë së kontrollit parlamentar të KBFP-së.

Në fushën e auditimit të jashtëm, qasja e treguesit merr parasysh praktikën e komunikimit dhe bashkëpunimit të KLSH-së me publikun. Kjo fushë shqyrton çështjet në vijim: (1) nëse ka strategji komunikimi; (2) mjetet e komunikimit të përdorura; (3) lehtësinë e të kuptuarit të raporteve të auditimit; (4) mënyrën e raportimit të çështjeve të identifikuar nga grupet e jashtme të interesit; (5) konsultimet me shoqërinë civile. Për këtë qëllim, u ndërthur analiza e dokumenteve dhe e faqes së internetit të KLSH-së me intervista gjysmë të strukturuar me personelin e KLSH-së për të mbledhur informacione shtesë ose që mungonin.

Së fundmi, në fushën e prokurimit publik, treguesi mat disponueshmërinë për publikun të informacionit për prokurimin publik. Ai shqyrton nëse autoritetet qendrore të prokurimit dhe autoritetet kryesore kontraktuese publikojnë plane dhe raporte vjetore, si dhe vlerëson se sa informuese dhe miqësore ndaj qytetarëve janë portalet qendrore të prokurimit publik për publikun e interesuar. Gjithashtu, ky tregues shqyrton disponueshmërinë e të dhënave të përpunueshme (open data) për prokurimin, si dhe përqindjen e proceseve të prokurimit publik të bëra me procedura të hapura. Ky tregues bazohet tërësisht në shqyrtimin e dokumentacionit zyrtar për politikën e prokurimit publik.

VII.3 REZULTATET E MONITORIMIT TË WEBER

PARIMI 5: ËSHTË SIGURUAR RAPORTIMI DHE SHQYRTIMI TRANSPARENT I BUXHETIT

Tabela 20. Treguesi WeBER MFP P5I1: Transparenca dhe mundësia e përfutimit të dokumenteve buxhetore

Elementet e treguesit	Rezultate
Buxheti vjetor i miratuar mund të përftohet lehtësisht në internet	0/4
Raportet mujore të zbatimit të buxhetit vjetor mund të përftohen lehtësisht në internet	4/4
Raportet gjashtëmujore të zbatimit të buxhetit vjetor mund të përftohen lehtësisht në internet	0/4
Raportet e zbatimit të buxhetit (mujore, 6-mujore, të fundvitit) përmbajnë të dhëna për shpenzimet e buxhetit të ndara sipas klasifikimit funksional, organizativ dhe ekonomik	4/4
Raporti vjetor i fundvitit përmban informacione jo-financiare në lidhje me performancën e qeverisë	2/2
Prezantimi zyrtar i buxhetit vjetor miqësor për lexuesit (Buxheti i Qytetarëve) publikohet rregullisht në internet	4/4
Të dhënat buxhetore publikohen në formatin e të dhënave të përpunueshme (open data)	2/2
Rezultati i përgjithshëm	16/24
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)¹⁹⁷	3

¹⁹⁷ Konvertimi i pikëve: 0-4 pikë = 0; 5-8 pikë = 1; 9-12 pikë = 2; 13-16 pikë = 3; 17-20 pikë = 4; 21-24 pikë = 5

Ky tregues mat transparencën e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit duke shqyrtuar dokumentet e publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që është institucioni përgjegjës për miradiministrimin e financave publike. Ministria publikon rregullisht raporte buxhetore mujore (gjatë vitit), gjashtëmujore dhe të fundvitit.

Shpenzimet në raportet buxhetore gjatë vitit¹⁹⁸ klasifikohen bazuar në fushat ekonomike dhe funksionale. Shpenzimet ekonomike përfshijnë pagat, investimet kapitale, transferata buxhetore për qeverinë vendore, pagesat e interesit, mbrojtjen sociale dhe subvencionet; shpenzimet funksionale përfshijnë arsimin e lartë dhe energjinë. Këto raporte përfshijnë statistikën përkatëse për të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara dhe ato të kryera.


Shpenzimet në raportin gjashtëmujor kategorizohen bazuar në fushat ekonomike, organizative dhe funksionale. Shpenzimet ekonomike përfshijnë pagat, mbrojtjen sociale, subvencionet, transferimet e qeverisë vendore dhe pagesat e interesit. Shpenzimet organizative përfshijnë të gjitha ministritë, prokurorinë, gjykatat, institucionet e verifikimit, Presidentin dhe Kuvendin. Shpenzimet funksionale mbulojnë energjinë, strehimin, arsimin, bujqësinë dhe zhvillimin rural, kujdesin shëndetësor, transportin, turizmin dhe mjedisin; megjithatë, shpenzimet funksionale kanë përgjithësisht raportohen nën shpenzimet e ministrive përkatëse. Raportet përfshijnë një rishikim të treguesve makroekonomikë, përshkruajnë pritshmëritë e ardhshme dhe japin të dhëna dhe informacione të përgjithshme për të ardhurat dhe shpenzimet.¹⁹⁹

Raporti vjetor për vitin 2019 përmban tri klasifikime të shpenzimeve. Raporti ndjek një strukturë që është e ngjashme me raportin gjashtëmujor, por jep të dhëna më tërësore për shpenzimet funksionale që nuk janë të kufizuara vetëm te energjia dhe strehimi, por përfshijnë mjedisin, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen, sigurinë publike dhe arsimin.

Raporti i zbatimit të buxhetit për vitin 2019 përfshin gjithashtu tregues jo-financiarë që vlerësojnë performancën e qeverisë sipas kapitullit 4.4 "Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës" Kjo pjesë përshkruan objektivat e politikës që janë përmbyshur për secilën nga ministritë. Për shembull, rritja e numrit të nxënësve të arsimit të mesëm, ose numri i fermerëve që kanë përfituar nga skema të ndryshme financimi të hartuara për të nxitur prodhimin dhe punësimin. Përveç kësaj praktike të mirë – pra përfshirja e treguesve të performancës – ministria ka publikuar "Buxhetin e qytetarit" me buxhetet vjetore të qytetarëve që nga viti 2016²⁰⁰, të cilat ofrojnë një pasqyrë të përgjithshme të përparësive dhe shpenzimeve të qeverisë. Të dhënat buxhetore gjithashtu publikohen në formatin e të dhënave të hapura (xls).²⁰¹

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi MFP P511: Transparenca dhe mundësia e përftimit të dokumenteve buxhetore



198 Ministria e Financave dhe Ekonomisë, "Statistika fiskale mujore", <https://www.financa.gov.al/statistika-fiskale-mujore/>.

199 Shih për shembull, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, "Buxheti 2020", <https://www.financa.gov.al/buxheti-2020/>.

200 Ministria e Financave dhe Ekonomisë, "Buxheti i qytetarit", <https://www.financa.gov.al/buxheti-i-qytetarit-2/>.

201 Ministria e Financave dhe Ekonomisë, "Statistika fiskale mujore".

PARIMI 6: SISTEMI I FUNKSIONIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM PËRCAKTON PËRGJEGJËSITË DHE KOMPETENCAT, NDËRSA ZBATIMI I TIJ NGA INSTITUCIONET BUXHETORE ËSHTË NË PËRPTHJE ME LEGJSLACIONIN QË RREGULLON MIRADMINISTRIMIN E FINANCEVE PUBLIKE DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE NË PËRGJITHËSI.

PARIMI 8: SISTEMI I FUNKSIONIMIT TË AUDITIT TË BRENDSHËM PASQYRON STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE ZBATIMI I TIJ NGA INSTITUCIONET BUXHETORE ËSHTË NË PËRPTHJE ME LEGJSLACIONIN QË RREGULLON ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE MIRADMINISTRIMIN E FINANCEVE PUBLIKE NË PËRGJITHËSI.

Tabela 21. Treguesi WeBER MFP P6_P8 I1: Disponueshmëria publike e informacionit për kontrollin e brendshëm financiar publik dhe të mbikëqyrjes parlamentare

Elementet e treguesit	Rezultatet
Raporti vjetor i konsoliduar i KBFP-së hartohet dhe publikohet rregullisht në internet.	4/4
Rishikimet e cilësisë së raporteve të auditimit të brendshëm hartohen dhe botohen rregullisht në internet.	0/2
Ministritë publikojnë informacione në lidhje me miradministrimin dhe kontrollin financiar	2/2
Njësia Qendrore e Harmonizimit (NJQH) angazhohet në mënyrë proaktive me publikun	0/2
Parlamenti shqyrton/rishikon rregullisht raportin e konsoliduar për KBFP-në	0/2
Rezultati i përgjithshëm	6/12
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)²⁰²	2

Ky tregues mat disponueshmërinë dhe diskutimin në parlament të raporteve të kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP). MFE publikon rregullisht raportet e KBFP-së.²⁰³ Ato përfshijnë (1) vlerësimin e performancës së njësive të qeverisjes së përgjithshme, (2) miradministrimin dhe kontrollin financiar, (3) vlerësimin e zbatimit të parimeve të kontrollit të brendshëm, (4) mbështetjen nga MFE për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, dhe (5) zhvillimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Raportet e KBFP përfshijnë 18 tregues të performancës, tre prej të cilëve trajtojnë masat për kontrollin e brendshëm financiar. Ata matin efektshmërinë e mekanizmave të kontrollit financiar, cilësinë e raporteve të brendshme financiare të paraqitura pranë MFE nga institucionet buxhetore dhe nëse plani i veprimit për vendosjen e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar është i kënaqshëm.²⁰⁴ Këto matje kryhen kryesisht nëpërmjet një pyetësi vetëvlerësimi të plotësuar nga institucionet publike.

Përkundër raporteve gjithëpërfshirëse të KBFP-së dhe përfshirjes së vlerësimit të raporteve të auditimit të brendshëm të institucioneve të zgjedhura publike, nuk ka pasur asnjë rishikim të raporteve të auditimit të brendshëm të botuara veçmas sipas metodologjisë. Sidoqoftë, disa nga mangësitë e theksuara në raportet e KBFP-së për auditin e brendshëm përfshijnë:

1. mungesën e të drejtave, detyrimeve dhe kufizimeve të auditorëve të brendshëm;
2. struktura e raportit të auditimit të brendshëm nuk ndjek standardet profesionale dhe rekomandimet janë të paqarta;
3. monitorimi i zbatimit të rekomandimeve është joefektiv, ndërsa shkalla e zbatimit është e ulët.²⁰⁵

²⁰² Konvertimi i pikëve: 0-2 pikë = 0; 3-4 pikë = 1; 5-6 pikë = 2; 7-8 pikë = 3; 9-10 pikë = 4; 11-12 pikë = 5.

²⁰³ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, "Raportet vjetore", <https://www.financa.gov.al/raportet-vjetore/>.

²⁰⁴ Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Raport për Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Përgjithshme të Qeverisë për vitin 2019 (Tiranë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2020), 19-20, <https://www.financa.gov.al/raportet-vjetore/>.

²⁰⁵ Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Raport për Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Përgjithshme të Qeverisë për vitin 2019, 64.


Ministritë kanë të përcaktuar specifiktë zyrtarin përgjegjës për miradministrimin e kontrollit të brendshëm financiar, por japin pak informacion për planet dhe aktivitetet e tyre për të përmirësuar KBFP, si p.sh., publikimin e regjistrit të risqeve ose të rregullores së procedurave. Këto mangësi përmenden gjithashtu në raportet e KBFP-së të botuara nga ministria e Financave dhe Ekonomisë. Raportet nënvizojnë se shumica e institucioneve publike nuk kanë krijuar grupe të parandalimit të riskut financiar, ndërsa jo të gjitha njësitet e brendshme brenda një institucioni janë të përfshira në hartimin e regjistrit të konsoliduar të risqeve.²⁰⁶ Një problem tjetër i evidentuar është se delegimi i detyrave zyrtare bazohet në Kodin e Procedurave Administrative, jo në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin dhe kontrollin financiar" (i ndryshuar) siç duhet të jetë.

Gjetjet e raporteve të KBFP-së nuk janë diskutuar në Kuvend. Sipas Ligjit për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar, ministri i Financave i paraqet Këshillit të Ministrave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit raportin e konsoliduar të KBFP brenda muajit maj. Meqenëse MFE ka publikuar raportet e KBFP 2018 dhe 2019 në maj, ne shqyrtuam raportet në Kuvend²⁰⁷ dhe procesverbalet²⁰⁸ e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave për periudhat maj-gusht 2019 dhe maj-gusht 2020. Nuk ka asnjë dokumentacion të publikuar nga ku mund të nxirret përfundimi se raportet e KBFP-së janë diskutuar në Kuvendin e Shqipërisë – as në një seancë plenare, as në seancat e komisionit përkatës.

Mungesa e debateve parlamentare për raportet e KBFP është veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh që asnjë nga ministritë nuk kishte publikuar regjistrin e risqeve dhe rregullat e procedurave për miradministrimin dhe kontrollin financiar. Përveç debateve parlamentare, angazhimi publik për miradministrimin e kontrollit të brendshëm është gjithashtu i rëndësishëm. Edhe pse në shtator 2019 MFE organizoi një konferencë kombëtare për sistemet e kontrollit të brendshëm financiar në njësitet e qeverisjes së përgjithshme²⁰⁹, Njësia Qendrore e Harmonizimit (Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik) mund të ndërmarrë një qasje më proaktive ndaj angazhimit të publikut nëpërmjet pranisë në mediat sociale, njoftimeve për shtyp për raportet dhe gjetjet e tyre, si dhe nëpërmjet publikimit të përmbledhjeve të shkurtra për aktivitetet e tyre kryesore që do të ishin me interes për publikun.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi MFP P6_P8 I1: Disponueshmëria publike e informacionit për kontrollin e brendshëm financiar publik dhe të mbikëqyrjes parlamentare



206 Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, 5.

207 Kuvendi, "Raportime", <http://parlament.al/Kerkese?page=1&tipId=3>.

208 Kuvendi, "Procesverbale", <http://parlament.al/Procesverbale>.

209 Ministria e Financave dhe Ekonomisë, "Denaj: Vlerësimi i performancës së institucionit për kontrollin e brendshëm financiar publik", <https://www.financa.gov.al/denaj-vleresim-performances-se-institucioneve-per-kontrollin-e-brendshem-financiar-publik/>.

PARIMI 11: EKZISTOJNË KAPACITETE INSTITUCIONALE DHE ADMINISTRATIVE QENDRORE PËR TË HARTUAR, ZBATUAR DHE MONITORUAR POLITIKËN E PROKURIMIT NË MËNYRË EFEKTIVE DHE EFIKASE.

PARIMI 13: PROCESET E PROKURIMIT PUBLIK PËRPUTHEN ME PARIMET THEMELORE TË TRAJTIMIT TË BARABARTË, MOSDISKRIMINIMIT, PROPORCIONALITETIT DHE TRANSPARENÇËS, NDËRSA SIGUROJNË PËRDORIMIN MË EFIKAS TË MUNDSHËM TË FONDEVE PUBLIKE DHE PËRDORIMIN MË TË MIRË TË TEKNIKAVE DHE METODAVE MODERNE TË PROKURIMIT.

Tabela 22. Treguesi WeBER MFP P11_13 I1: Disponueshmëria publike e informacionit në lidhje me prokurimin publik

Elementet e treguesit	Rezultatet
Autoriteti qendror i prokurimit raporton rregullisht tek publiku për zbatimin e politikës së përgjithshme të prokurimit publik	4/4
Organi qendror i shqyrtimit të ankesave raporton rregullisht tek publiku për procedurat për mbrojtjen e të drejtave të operatorëve ekonomikë gjatë procesit të prokurimit publik	4/4
Raportimi për prokurimin publik që bëhet nga autoriteti qendror i prokurimit është miqësor ndaj qytetarëve dhe i disponueshëm për ta	2/2
Portali i prokurimit publik është i lehtë për t'u përdorur	2/2
Autoritetet kontraktuese të nivelit qendror publikojnë rregullisht planet vjetore të prokurimit	0/4
Autoritetet kontraktuese të nivelit qendror publikojnë rregullisht raporte vjetore të prokurimit	0/4
Autoriteti qendror i prokurimit publikon të dhëna të përpunueshme (open data) të prokurimit	0/2
Procedurat e hapura dhe konkurruese janë metoda kryesore e prokurimit publik	4/4
Rezultati i përgjithshëm	16/26
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)²¹⁰	3

Politika e prokurimit publik rregullohet nga Agjencia e Prokurimit Publik. Agjencia publikon rregullisht raporte vjetore për zbatimin e politikës së prokurimit publik.²¹¹ Raportet përfshijnë të dhëna për: (1) proceset e prokurimit; (2) nismat legjislative; (3) veprimet konsultative (kërkesa për opinion të paraqitura nga institucionet qeveritare); (4) mekanizmat e verifikimit dhe zbatimit të kontratave; (5) publikimin e vendimeve; (6) çështjet gjyqësore; (7) bashkëpunimin ndërkombëtar të Agjencisë; (8) koordinimin dhe ndihmën për zbatimin e kontratave; (9) miradministrimin dhe publikimin e të dhënave; (10) miradministrimin e burimeve njerëzore dhe financiare. Raportet e Agjencisë janë burimi kryesor i informacionit për prokurimin publik, pasi ministritë e linjës zakonisht nuk publikojnë plane prokurimi dhe raporte të zbatimit të tyre. Raportet e prodhuara nga Agjencia ofrojnë të dhëna të bollshme, por ato nuk ofrohen në një format të dhënash të përpunueshme (open data) që do t'u mundësonte studiuesve dhe akademikëve t'i analizojnë ato. Për më tepër, raportet vjetore nuk përfshijnë vlerësime për performancën e politikës së prokurimit. Sidoqoftë, ato përfshijnë statistika për konkurrencën e procesit dhe sasinë e parave të tatimpaguesve të kursyera për secilën procedurë prokurimi të përdorur.

Komisioni i Prokurimit Publik është organi qendror i shqyrtimit të ankesave të prokurimit. Komisioni publikon raporte vjetore për punën e tij, që përfshijnë një pjesë për organizimin, funksionimin dhe performancën financiare të tij, si dhe një pjesë për administrimin e ankesave.²¹²

210 Konvertimi i pikëve: 0-5 pikë = 0; 6-9 pikë = 1; 10-13 pikë = 2; 14-17 pikë = 3; 18-21 pikë = 4; 22-26 pikë = 5

211 Agjencia e Prokurimit Publik, "Analiza vjetore", <http://www.app.gov.al/rreth-nesh/analizat-vjetore/>.

212 Komisioni i Prokurimit Publik, "Raportet ndër vite", <http://www.kpp.gov.al/en/Raporte>.

Prokurimi publik kryhet në mënyrë të qendëruar nëpërmjet prokurimit elektronik. Thirrjet për prokurime dhe dokumentacioni i tenderit mund të merren falas në portalin e prokurimit elektronik²¹³, ndërsa vendimet e prokurimit publikohen në buletinën e Agjencisë së Prokurimit Publik.²¹⁴


Procedurat e hapura dhe kërkesat për propozime janë procedurat kryesore të përdorura për prokurimin publik. Procedurat e hapura të prokurimit nuk kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, ndërkohë që kërkesat për propozime nuk janë të hapura, por janë konkurruese. Kërkesat për propozim janë propozime të paraqitura nga një operator ekonomik për një shërbim ose punë publike. Më pas qeveria vendos të ketë një thirrje të hapur për të njëjtin shërbim publik ose punë publike të propozuar nga operatori ekonomik. Megjithatë ky proces tenderimi nuk nisat teknikisht nga qeveria, thirrja duhet të jetë e hapur për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë.

Për vitin 2019, përqindja e procedurave të hapura dhe e kërkesave për propozime është 98.7% (60.4% e të cilave janë kërkesa për propozime)²¹⁵; për vitin 2018, përqindja e procedurave të hapura dhe kërkesave për propozime është 97.3% (57.3% e të cilave janë kërkesa për propozime)²¹⁶; për vitin 2017, përqindja e procedurave të hapura dhe konkurruese është 98.0% (62% e të cilave janë kërkesa për propozime)²¹⁷.

Kërkesat për propozim përmbushin kërkesat formale për procedurat e hapura të prokurimit; megjithatë, nga propozimi te procesi i tenderimit dhe dhënia e kontratës, procesi është i ekspozuar ndaj risqeve të konsiderueshme të korrupsionit. Në ligjin e ri të prokurimit publik, Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", miratuar në gusht të vitit 2020, janë shfuqizuar dispozitat që mundësojnë kërkesat për propozim.²¹⁸ Pavarësisht këtij ndryshimi, pjesa më e madhe e procedurave të prokurimit për vitin 2020 përfshijnë kërkesa për propozime (60% e të gjitha procedurave).²¹⁹ Duke qenë se ligji i ri hyri në fuqi në pjesën e dytë të vitit 2020, viti 2021 do të ishte një burim më i mirë për të matur ndikimin e tij në politikën e prokurimit publik.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi MFP P11_13 I1: Disponueshmëria publike e informacionit në lidhje me prokurimin publik



213 Agjencia e Prokurimit Publik, "Njoftim i kontratës së shpallur", <https://bit.ly/3niqt4>.

214 Agjencia e Prokurimit Publik, "Arkivi i Buletinit të Prokurimit Publik", <http://www.app.gov.al/t%C3%AB-tjera/arkiva/arkiva-e-buletinit-t%C3%AB-prokurimit-publik/>.

215 Agjencia e Prokurimit Publik, Raporti Vjetor 2019 (Tiranë: Agjencia e Prokurimit Publik, 2020), 16, <https://bit.ly/3gwfQBh>.

216 Agjencia e Prokurimit Publik, Raporti Vjetor 2018 (Tiranë: Agjencia e Prokurimit Publik, 2019), 15, <https://bit.ly/3vh53Jp>.

217 Agjencia e Prokurimit Publik, Raporti Vjetor 2017 (Tiranë: Agjencia e Prokurimit Publik, 2018), 13, <https://bit.ly/2QP4A8y>.

218 Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", <https://bit.ly/3dL19bL>.

219 Agjencia e Prokurimit Publik, Raporti Vjetor 2020 (Tiranë: Agjencia e Prokurimit Publik, 2021), 18, <https://bit.ly/32EuvCo>.

PARIMI 16: AUTORITETI KOMBËTAR I AUDITIMIT (KONTROLLI I LARTË I SHETIT) ZBATON STANDARDET NË MËNYRË TË PAANSHME DHE OBJEKTIVE PËR TË SIGURUAR AUDITIME ME CILËSI TË LARTË, TË CILAT NDIKOJNË POZITIVISHT NË FUNKSIONIMIN E SEKTORIT PUBLIK.

Tabela 23. Treguesi WeBER PFM P16 I1: Komunikimi dhe bashkëpunimi i autoritetit kombëtar të auditimit me publikun në lidhje me punën e institucionit

Elementet e treguesit ²²⁰	Rezultatet
KLSH zhvillon një strategji komunikimi për të informuar dhe për të pasur kontakt me publikun	2/4
KLSH i ka vendosur të paktën një pozicion pune për komunikim proaktiv dhe për kthimin e përgjigjeve ndaj publikut	4/4
KLSH përdor mënyra të ndryshme për të komunikuar me publikun	2/2
KLSH prodhon përmbledhje të thjeshtëzuara të raporteve të auditimit që janë lehtësisht të lexueshme për qytetarët	0/4
Janë zhvilluar kanale zyrtare për parashtrimin e ankesave ose nismave tek KLSH-ja nga grupet e jashtme të interesit (publiku i gjerë, OShC-të)	2/2
KLSH-ja konsultohet me OShC-të dhe punën e tyre me qëllim identifikimin e rrezeve në sektorin publik	0/2
Rezultati i përgjithshëm	10/18
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5)²²¹	3

Strategjia e komunikimit të KLSH-së mbaroi në vitin 2019. Sidoqoftë, strategjia e saj e zhvillimit zgjat deri në vitin 2022 dhe përfshin objektiva komunikimi që synojnë të sjellin misionin, përgjegjësitë dhe gjetjet e institucionit më pranë publikut nëpërmjet takimeve publike.²²² KLSH-ja kërkon të rrisë komunikimin me publikun nëpërmjet mediave dhe faqes së saj të internetit dhe duke zhvilluar bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile, institucione të arsimit të lartë dhe ekspertë të fushës, por KLSH-ja e ka si pjesë e strategjisë konsultimin me OShC-të për të identifikuar rreziqet financiare në sektori publik.²²³

Misioni i Drejtorisë së Komunikimit, Publikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë është të rrisë kapacitetet e komunikimit dhe botimeve të KLSH-së, duke siguruar transparencë në marrëdhëniet me publikun nëpërmjet bashkëpunimit të gjerë me median dhe partnerë të tjerë. Drejtoria është gjithashtu njësi përgjegjëse për ndjekjen dhe raportimin lidhur me zbatimin e Strategjisë së Komunikimit. KLSH-ja ka një pozicion në stafin e saj përgjegjës për komunikimin me publikun dhe marrjes së përshtypjeve të tij, "Specialisti për komunikimin dhe përpunimin e letrave të publikut", i cili është i ngarkuar me përpunimin e letrave dhe ndjekjen e komenteve, pyetjeve ose ankesave nga publiku.²²⁴

Në raportin e punës së vet, KLSH-ja raporton çdo vit për përpunimin e ankesave dhe kërkesave për informacion. Pjesa për trajtimin e letrave të qytetarëve dhe kërkesave për informacion, ai përshkruan veprimet e kryera pas marrjes së ankesave të tilla.²²⁵ Pas shqyrtimit të ankesave, ato kategorizohen në ankese (ose kërkesa të tjera) për të cilat KLSH-ja është ligjërisht përgjegjëse dhe ankese për të cilat janë përgjegjëse institucione të tjera. Nëse ankesat hyjnë në kategorinë e dytë, ato u përcillen institucioneve përkatëse për t'iu përgjigjur çështjes së parashtruar. Ndërkohë, personi që ka parashtruar ankesën njoftohet për veprimin e ndërmarrë nga KLSH-ja dhe merr një

220 Disa prej lidhjeve elektronike brenda këtij treguesi të cilat i referohen dokumenteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të mos funksionojnë për shkak se KLSH-ja ka ndryshuar adresën e internetit që prej kohës kur u bë shqyrtimi i dokumentacionit të institucionit. Aty ku ka qenë e mundur, lidhja elektronike e vjetër e dokumentit të referuar është zëvendësuar me të rene, por kjo nuk përfshin të gjithë dokumentet e referuar.

221 Konvertimi i pikëve: 0-3 pikë = 0; 4-5 pikë = 1; 6-7 pikë = 2; 8-11 pikë = 3; 12-15 pikë = 4; 16-18 pikë = 5.

222 KLSH, Strategjia e Zhvillimit të Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit 2018-2022, 51-52, <https://panel-klsh.almotech.co/storage/phpKhlYoa.pdf>.

223 Informacioni i siguruar nga KLSH në 07 Janar 2021 në përgjigje të një kërkesë për informacion.

224 KLSH, "Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit", 94, http://www.kslh.org.al/web/rregullore_e_brendshme_e_organizimit_dhe_funksionimit_admisnitrativ_te_kslh_1894.pdf.

225 KLSH, Raporti Vjetor i Performancës 2019 (Tiranë: KLSH, 2020), 88, <https://panel-klsh.almotech.co/storage/phpUZLwu.pdf>.

përgjigje sapo ajo të dorëzohet në pranë KLSH-së nga institucioni përkatës. Në Raportin Vjetor të Performancës të vitit 2019, KLSH-ja tregon shpërndarjen e mëposhtme të ankesave të marra:


1. Privatizimi dhe kthimi i pronës - 37%;
2. Administrimi financiar dhe prokurimi publik - 21%;
3. Taksa, tatime dhe dogana - 4%;
4. Tema të tjera - 38%.²²⁶

Përveç përpunimit të letrave nga publiku, KLSH-ja angazhon publikun në mënyrë periodike nëpërmjet buletineve të punës audituese dhe organizon një aktivitet njëmuor konferencash e leksionesh për të promovuar aktivitetet e saj.

Ndërsa angazhimi publik për të promovuar punën e KLSH-së kontribuon në njohjen e publikut me rolin dhe rëndësinë e këtij institucioni, pjesa qendrore e punës së KLSH-së – pra, raportet e auditimit – nuk janë të lehta për t'u kuptuar nga qytetarët dhe hulumtuesit për shkak të gjuhës teknike dhe anonimizimit të operatorëve ekonomikë dhe zyrtarëve përgjegjës për shkelje. Raportet e auditimit zakonisht shoqërohen nga një përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve. Përmbledhjet janë më të lehta për t'u ndjekur dhe lexuar sesa raporti i auditimit, por ato mund të jenë më të qarta duke theksuar qëllimin e auditimit dhe gjetjet dhe rekomandimet kryesore.

■ Si paraqitet Shqipëria në këndvështrim rajonal?

Treguesi PFM P16 I1: Komunikimi dhe bashkëpunimi i autoritetit kombëtar të auditimit me publikun në lidhje me punën e tij



VII.4 REZULTATET PËRMBLEDHËSE: MIRADMINISTRIMI I FINANCEVE PUBLIKE

Qëllimi i një sistemi transparent të miradministrimit të financave publike është t'i japë publikut informacione për shpenzimet e qeverisë, qëllimet e tyre dhe të mirat dhe shërbimet publike të marra si rrjedhojë e këtyre shpenzimeve. Ky informacion ndihmon drejt formësimit të një procesi gjithëpërfshirës të vendimmarrjes, nëpërmjet të cilit publiku mund të shprehë opinione të informuara mbi shpenzimin e parave të tyre, për rezultatet e investimeve publike dhe për rreziqet financiare që lidhen me shpenzimet publike.

Ndërsa raportimet e buxhetit janë përmirësuar disi, publikimi i raporteve të KBFP-së, raportet e prokurimit publik dhe angazhimi publik i KLSH-së duhet të përmirësohen më tej. Raportimi i buxhetit është përgjithësisht i plotë. Ai i siguron publikut informacionin bazë për të ardhurat dhe shpenzimet. Nga tre format e raportimit (mujore, gjatëmuajore dhe në fund të vitit), raportimi i fundvitit është më i plotë. Megjithatë, në

²²⁶ KLSH, Raporti Vjetor i Performancës 2019, 88.

këto raport nuk përfshihen të dhëna të rëndësishme për performancën e sektorëve strategjikë, si energjia, minierat dhe infrastruktura. Këto raporte japin disa të dhëna për zbatimin e zërave specifike të buxhetit të ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo si pjesë e një vlerësimi të veçantë sektorial.

Për më tepër, publiku do të ishte në gjendje të vlerësonte më mirë performancën e këtyre sektorëve dhe të sektorëve të tjerë nëse edhe raportet e përditësuara të prokurimit publik do të publikoheshin rregullisht nga ministritë e linjës. Gjatë periudhës së matjes (dhjetor 2020) asnjë nga ministritë nuk kishte botuar raporte të përditësuara, ndërsa shumica nuk kishte botuar fare raporte. Gjatë shkrimit të këtij raporti, kemi vërejtur një zhvillim pozitiv krahasuar me periudhën e matjes – përkatësisht, publikimin e raportit të zbatimit të planit të prokurimit për vitin 2020²²⁷ dhe planin e prokurimit për 2021²²⁸ nga ministria e Mbrojtjes. Publikimi i këtyre dokumenteve është gjithashtu kërkesë ligjore sipas Ligjit për të Drejtën e Informimit, i cili përfshin dispozita që autorizojnë Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave të gjobitë autoritetet publike, nëse ato nuk përmbushin detyrimet ligjore sipas Programit të Transparencës.²²⁹

Kontrollet e brendshme dhe të jashtme financiare janë thelbësore për parandalimin e humbjeve, si dhe të mashtrimeve dhe abuzimeve me fondet publike. Edhe pse problemet që lidhen me kontrollin e brendshëm financiar janë identifikuar në raportet e KBFP-së, këto raporte nuk janë diskutuar në Kuvend. Diskutimi parlamentar për problematikën e kontrollit të brendshëm financiar është një funksion kritik i detyrës së Kuvendit për të ushtruar mbikëqyrje të efektshme për shpenzimet qeveritare. Në mënyrë të ngjashme, KLSH-ja ka një funksion të rëndësishëm për t'i kërkuar llogari ekzekutivit duke audituar mënyrën se si e shpenzon paratë publike. Megjithatë raportet e auditimit të KLSH-së mund të gjenden në internet, KLSH-ja mund të përmirësojë më tej komunikimin e gjetjeve kryesore të raportit për publikun duke publikuar përmbledhje më të shkurtra dhe të qarta. Për më tepër, një qasje më proaktive ndaj bashkëpunimit me OSHC-të në diskutimin e rreziqeve financiare në sektorin publik mund të përmirësojë më tej punën e institucionit duke përfutur më shumë të dhëna ndihmuese për të kryer detyrat institucionale.

VII.5 REKOMANDIME PËR MIRADMINISTRIMIN E FINANCIVE PUBLIKT

Gjurmimi i rekomandimeve nga Monitorimi i RAP 2017/2108

Rekomandimi	Statusi	Komento
Raportimi buxhetor gjatë vitit duhet të përmbajë komente që shoqërojnë të dhënat numerike, veçanërisht duke dhënë shpjegime të ndryshimeve të konsiderueshme midis shumave të shpenzuara dhe atyre të parashikuara.	I Pazbatuar	Raportimi buxhetor gjatë vitit përfshin vetëm të dhëna statistikore.
Raportimi i gjashtëmujor dhe ai i fundvitit duhet të jetë më gjithëpërfshirës nëpërmjet klasifikimit të shpenzimeve, përveç kategorisë ekonomike duke përfshirë edhe kategoritë funksionale dhe organizative.	Zbatuar	Raportet gjashtëmujore dhe të fundvitit të zbatimit të buxhetit përfshijnë kategoritë funksionale dhe organizative.
Raporti i fundvitit të buxhetit duhet të pasqyrojë formatin e prezantimit të projekt buxhetit vjetor.	Zbatuar	Raporti i buxhetit të fundvitit 2019 pasqyron seksionet e përshkruara në ligjin e miratuar të buxhetit dhe anekset përkatëse të tij për të ardhurat dhe shpenzimet.
Raporti i fundvitit të buxhetit duhet të japë informacione jo-financiare të performancës së qeverisë krahasuar me objektivat e performancës dhe rezultatet e arritura (duke përfshirë produktet, qëllimet, rezultatet).	Pjesërisht i zbatuar	Raporti vjetor i fundvitit përfshin tregues jo-financiarë (Treguesit e Performancës) të qeverisë.
Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të lehtësojë përfundimin e dokumenteve buxhetore duke krijuar një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse dhe miqësore për përdoruesit e dokumenteve buxhetore në një vend të vetëm në faqen e saj të internetit - me informacion për buxhetin e zbatuar (gjatë vitit, në mes të vitit, në fund të vitit).	I Pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.

227 Ministria e Mbrojtjes, https://www.mod.gov.al/images/te_tjera_nga_mm/prokurime/2021/realizimi-2020.pdf.

228 Ministria e Mbrojtjes, https://www.mod.gov.al/images/te_tjera_nga_mm/prokurime/2021/parashikime-2021.pdf.

229 Programi i Transparencës përshkruan kategoritë e informacionit dhe dokumenteve që duhet të publikohen.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të publikojë të gjitha të dhënat e buxhetit në përputhje me standardet e të dhënave të përpunueshme (open data).	Zbatuar	Të dhënat buxhetore publikohen në formatin e të dhënave të përpunueshme (.xls) nga Ministria e Ekonomisë.
Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të prodhojë dhe publikojë rregullisht në internet rishikime të cilësisë së raporteve të auditimit të brendshëm.	I Pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.
Ministritë duhet të publikojnë informacion të përditësuar dhe gjithëpërfshirës në lidhje me administrimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke përfshirë personat përgjegjës për zbatimin e KBFP, procedurat e brendshme dhe informacionin për administrimin e risqeve.	I Pazbatuar	Ministritë nuk kanë publikuar informacion për mekanizmat e kontrollit të brendshëm të financave publike.
Njësia Qendrore e Harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë duhet gjithashtu të punojnë drejt komunikimit të saj të jashtëm, duke botuar materiale që shpjegojnë KBFP-në për publikun.	I Pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.
KLSH-ja duhet të prezantojë përmbledhje të standardizuara lehtësisht të kuptueshme për qytetarët për secilin raport auditimi të botuar - veçanërisht për raportet e performancës - në mënyrë që të rritet kuptueshmëria e gjetjeve dhe rekomandimeve të KLSH-së.	I Pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.
KLSH-ja duhet të shqyrtojë mundësinë e shtimit të përdorimit të mjeteve miqësore për t'u komunikuar qytetarëve në mënyrë të efektshme punën e vet nëpërmjet grafikave informuese, videove dhe paraqitjen grafike të të dhënave.	I Pazbatuar	Nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga cikli i fundit i monitorimit.
KLSH-ja duhet të monitorojë nga afër zbatimin e Strategjisë së Komunikimit.	Zbatuar	Raporti i performancës së vitit 2019 përfshin informacion për zbatimin e strategjisë së komunikimit.

■ Rekomandimet e Monitorimit të RAP 2019/2020

Më poshtë gjendet një ndërthurje e rekomandimeve të vjetra dhe të reja. Rekomandimet nga cikli i mëparshëm i monitorimit janë detajuar më tej, ndërsa rekomandimet e reja synojnë të trajtojnë çështje të caktuara që nuk kanë qenë të përfshira në ciklin e mëparshëm.

1. Informacioni për buxhetin duhet të organizohet veçmas nga pjesa tjetër e dokumenteve që mund të gjenden nën skedën «Legjislacioni» në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Dokumentet mund të paraqiten në një mënyrë të thjeshtuar për përdoruesit duke përfshirë shpjegime të shkurtra për përmbajtjen që gjendet në dokument.
2. Raportimi buxhetor gjatë vitit duhet të përfshijë komente për të shpjeguar të dhënat buxhetore, veçanërisht mospërputhjet mes shifrave të parashikuara dhe ato faktike.
3. Informacioni buxhetor për shpenzimet ekonomike, organizative dhe funksionale duhet të shpjegohet dhe dallohet më mirë sipas kategorive – veçanërisht dy kategoritë e fundit.
4. Raporti i fundvitit duhet të përfshijë një metodologji për shpjegimin e arsytimit të treguesve të zgjedhur për performancën dhe për të vendosur një lidhje të qartë midis objektivave të politikës dhe rezultateve.
5. Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të publikojë rregullisht në internet rishikime të cilësisë së auditimit të brendshëm, veçmas nga raportet e KBFP-së.
6. Ministritë duhet të publikojnë informacione të përditësuara dhe gjithëpërfshirëse në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin brenda institucionit të tyre, përfshi personat përgjegjës për zbatimin e KBFP, procedurat e brendshme dhe informacionin për parandalimin e riskut financiar.
7. Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të ketë fuqi ligjore për të gjobitur institucionet publike që vazhdimisht nuk arrijnë të përmbushin rekomandimet e detyrimeve ligjore të nxjerra për të përmirësuar sistemin e KBFP-së të institucionit të tyre sipas Ligjit për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar.
8. Njësia Qendrore e Harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë duhet gjithashtu të përmirsojë komunikimin e saj të jashtëm duke botuar materiale që shpjegojnë aktivitetet e KBFP-së dhe gjetjet për publikun.

9. Autoritetet kontraktuese të qeverisë qendrore duhet të publikojnë plane dhe raporte të prokurimit në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit, ndërsa Agjencia e Prokurimit Publik duhet të publikojë të dhënat e prokurimit në një format të të dhënave të përpunueshme (open data).
10. KLSH-ja duhet të prezantojë përmbledhje të standardizuara për çdo raport auditimi të botuar, të cilat janë lehtësisht të kuptueshme nga qytetarët dhe në mënyrë që të kuptohet rëndësia e gjetjeve dhe rekomandimeve.
11. KLSH-ja duhet të konsiderojë shtimin e përdorimit të mjeteve miqësore për t'u komunikuar qytetarëve në mënyrë të efektshme punën e vet, duke përfshirë infografikët, videot dhe paraqitjen grafike të të dhënave.
12. Komisioni Parlamentar i Ekonomisë dhe Financave duhet të ushtrojë në mënyrë të efektshme detyrat e mbikëqyrjes duke i kërkuar llogari Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për sigurimin e një regjimi rregullator efikas të kontrollit të brendshëm financiar publik.

PËRFUNDIM: VENDOSJA E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE NË KRYE TË AGJENDËS SË REFORMAVE

Gjetjet e këtij raporti nxjerrin në pah si nevojën për të arritur standarde të larta të transparencës, llogaridhënies dhe gjithëpërfshirjes në procesin e politikëbërjes, ashtu edhe kompleksitetin teknik dhe koordinimin ndërinstitucional të nevojshëm për t'i arritur ato. Reforma e administratës publike është një përpjekje jashtëzakonisht sfiduese e cila ndikon në çdo aspekt të jetës publike. Kështu që kërkon përfshirje më të madhe shoqërore dhe kërkesa për standarde të larta gjatë gjithë ciklit të politikëbërjes të nismave të ndryshme të reformave: nga përcaktimi i agjendës dhe hartimi i politikave deri te zbatimi i tyre dhe monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve dhe ndikimit të përgjithshëm.

Ky raport u përqendrua vetëm në disa nga funksionet e disa institucioneve të qeverisë qendrore. Megjithatë nuk vlerësoi më gjerësisht dhe në detaje funksionimin e brendshëm dhe sfidat e administratës shtetërore, gjetjet dhe rekomandimet mund të përdoren nga qeveria shqiptare dhe donatorët e huaj për të përmirësuar efektshmërinë e përpjekjeve të tyre. Së bashku me raportet e SIGMA-s mbi reformën e administratës publike, një numër i madh të dhënash janë prodhuar për të skicuar zhvillimin dhe rezultatet e përpjekjeve të reformës, si dhe për të identifikuar praktikatat e mira dhe për të vazhduar të ndërtohet mbi to, duke identifikuar njëkohësisht sfidat që duhet të trajtohen për të përmirësuar ndikimin e reformës.

Ka një angazhim të qartë e të palëkundur drejt digjitalizimit dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve. Për më tepër, praktikatat e raportimit të buxhetit të shtetit janë përmirësuar dhe institucionet e ngritura për të siguruar transparencën e qeverisë (KDIMDP) dhe për të mbikëqyrur shërbimin civil (KMSHC) po prodhojnë raporte të rëndësishme mbi sfidat e administratës publike, si dhe kanë qenë të dobishme për të vendosur standardet themelore të transparencës dhe llogaridhënies. Përpjekja e fundit e qeverisë shqiptare për të modernizuar planifikimin e qeverisë përmes IPSIS tregon angazhimin e saj për reformën. Përkundër këtyre rezultateve pozitive, ka ende sfida të rëndësishme në lidhje me përgjegjshmërinë, transparencën dhe me performancën e shërbimit civil. Procesi i hartimit të politikave duhet të jetë jo vetëm më transparent dhe gjithëpërfshirës, por edhe i bazuar në të dhëna dhe studime. Këto janë parakushte thelbësore për politikëbërje efikase dhe të udhëhequra nga performanca.

Përpjekjet e reformës duhet të përqendrohen në përmirësimin e strukturave të politikëbërjes në fuqi dhe koordinimit dhe në forcimin e performancës së shërbimit civil. Për të përmirësuar strukturat e politikëbërjes dhe koordinimit, duhet të bëhet një vlerësim i plotë i proceseve në fuqi për të identifikuar jo vetëm sfidat ligjore dhe procedurale por edhe institucionale, që pengojnë rritjen e performancës të institucioneve të qeverisë qendrore. Disa nga sfidat që duhet të shqyrtohen më tej përfshijnë marrëdhëniet midis zyrtarëve të zgjedhur dhe nëpunësve civilë, pavarësinë profesionale të nëpunësve civilë, ekspertizën e nevojshme të politikave publike të nëpunësve civilë, bashkëpunimin dhe koordinimin brenda ministrive të linjës (përfshirë Komitetet Drejtuese Sektoriale), efikasitetin e grupeve ndërmministrorë të punës (përfshirë Grupet për Menaxhimin e Integruar të Politikave).

Për më tepër, piketat e rëndësishme që janë vendosur në sistemin e rekrutimit dhe emërimit në shërbimin civil duhet të forcohen më tej përmes një sistemi gjithëpërfshirës të karrierës që integron kritere të qarta të trajnimit, ngritjes në detyrë dhe të pagës për secilën kategori dhe nënkategori të shërbimit civil. Një sistem i tillë do të përmirësonte ndjeshëm performancën e shërbimit civil duke rritur standardet profesionale duke

çuar në politika të mirëhartuara e të bazuara në të dhëna studimore, gjithëpërfshirëse dhe transparente, të cilat i shërbejnë interesit publik.

Në mënyrë të ngjashme, politikat e ofrimit të shërbimeve duhet të përqendrohen në sigurimin e shpërndarjes e drejtë të shërbimeve qeveritare. Kjo është një sfidë themelore që lidhet me pabarazitë gjeografike dhe socio-ekonomike, aftësinë për të marrë shërbime nëpërmjet internetit dhe shpërndarjen e tij, si dhe përfshirjen e nevojave të personave me aftësi të kufizuara në politikat e ofrimit të shërbimeve. Rrjedhimisht, koordinimi ndërinstitutional, konsultimi me publikun dhe mbledhja e të dhënave janë thelbësore për t'i kapërcyer ato vështirësi dhe për të siguruar që politikat e ofrimit të shërbimeve janë të mirëhartuara dhe synojnë shpërndarjen e drejtë të shërbimeve publike.

Së fundmi, përpjekjet e komunitetit të donatorëve të huaj, institucioneve të qeverisë shqiptare dhe të shoqërisë civile për të kryer reformën në administratën publike në Shqipëri duhet të jenë të njëjta me ato të reformës së sundimit të ligjit. Procesi i pranimit në BE dhe kriteret e kushtëzimit janë përqendruar – veçanërisht në pesë vitet e fundit – në përparimin e vendit në Kapitujt 23 dhe 24 të legjislacionit të BE-së. Krahimisht, përparimi në reformën e administratës publike, e cila është gjithashtu një nga kriteret themelore të pranimit, është neglizhuar.

Sidoqoftë, këto dy procese reformash janë ngushtësisht të ndërlidhura, pasi politizimi i administratës publike, vendimmarrja arbitrare duke shmangur transparencën dhe llogaridhënien dhe keqadministrimi i fondeve publike çojnë në mosmarrëveshje civile dhe administrative që mund të mbingarkojnë më tej sistemin gjyqësor përtej kapaciteteve të tij të kufizuara dhe numrit të pallogaritshëm të çështjeve që janë në pritje të gjyqimit. Duke investuar më shumë burime në RAP, jo vetëm që do të përmirësohej performanca e administratës publike, por gjithashtu do të lehtësohej – deri në një farë mase – ngarkesa e sistemit të drejtësisë që ende po formësohet. Ndonëse në vështrim afatshkurtër ky lehtësim do të ishte i papërfillshëm, në vështrim afatgjatë do të siguronte përmirësime thelbësore të cilësisë së jetës përmes një administrate publike më profesionale dhe efikase, si dhe nëpërmjet një sistemi drejtësie që nuk vijon të jetë i mbingarkuar dhe që e ka të vështirë të zgjidhë mosmarrëveshjet civile dhe administrative brenda një kohe të përshtatshme.

SHTOJCË PËR METODOLOGJINË

Metodologjia e monitorimit të RAP-it u zhvillua nga ekipi hulumtues i WeBER-it dhe u konsultua plotësisht midis bashkëpunëtorëve ekspertë të WeBER-it. Në përputhje me ndryshimet metodologjike të përshkruara në këtë raport, metodologjia bazohet në 22 Parime SIGMA (përkundër 21 të tilla në ciklin e mëparshëm të monitorimit) dhe për të monitoruar këto parime brenda gjashtë fushave kryesore të RAP-it përdoren 23 tregues të përbërë.

Dokumenti i metodologjisë së monitorimit të reformës jep detaje mbi qasjen e përgjithshme të monitorimit WeBER, procesin e zhvillimit të metodologjisë, zgjedhjen e parimeve që projekti WeBER monitoron dhe formulimin e treguesve me përshkrimet e qasjeve metodologjike. Informacioni i hollësishëm për matjen e secilit tregues jepet në tabela të veçanta të treguesve. Çdo tabelë përmban sa vijon: formulimin, peshën specifike, burimet e të dhënave, metodologjinë/përshkrimin se çfarë mat një element i caktuar, si dhe rregullat e ndarjes së pikëve. Së fundmi, tabelat e treguesve përmbajnë tabelën për kthimin e pikëve të çdo elementi në vlera përfundimtare të treguesit, në shkallën nga 0 në 5.

Metodologjia e monitorimit dhe tabelat e treguesve janë në dispozicion në lidhjen vijuese: <https://www.par-monitor.org/par-monitor-methodology/>.

Janë përdorur dhe krahasuar të dhëna nga secila prej gjashtë administratave. Këto të dhëna janë mbledhur nëpërmjet metodave të mëposhtme:

- Fokus-grupe
- Intervista me grupet e interesit
- Sondazh të perceptimit publik
- Sondazh të nëpunësve civilë
- Sondazh të organizatave të shoqërisë civile
- Hulumtim i dokumentacionit zyrtar, të dhënave dhe faqeve zyrtare të internetit
- Kërkesa për informacion.

FOKUS-GRUPET

Janë kryer fokus-grupe për mbledhjen e përshtypjeve nga OSHC-të për tregues të caktuar. Të dhënat e fokus-grupeve përdoren më shpesh për të plotësuar ose vërtetuar të dhënat e mbledhura nga metoda të tjera kërkimore. Më konkretisht, metodologjia e monitorimit parashikoi fokus-grupe për:

- Kornizën Strategjike për RAP, me organizatat e shoqërisë civile (për treguesit KSRAP_P1_I1, KSRAP_P2 & 4_I1)
- Zhvillimin dhe Koordinimin e Politikave, me organizatat e shoqërisë civile (që mbulojnë ZHKP_P5_I2, ZHKP_P6_I1, ZHKP_P10_I1, ZHKP_P11_I1)
- Shërbimin Publik dhe Miradministrimin e Burimeve Njerëzore, me ish-kandidatë që më parë kanë aplikuar për një vend pune në organet qendrore të administratës shtetërore (për treguesin SHPMBJ_P3_I1)
- Llogaridhënien, me organizatat e shoqërisë civile (për treguesin LL_P2_I1), dhe
- Ofrimin e Shërbimit, me organizatat e shoqërisë civile që merren posaçërisht me çështje të përfuturit të shërbimeve, grupet shoqërore të mënjanuara dhe personat me aftësi të kufizuara (për treguesin OSH_P4_I1).

Përzgjedhja e pjesëmarrësve synoi OSHC-të ose grupe të tjera me ekspertizë për çështjet në fjalë. U kryen fokus-grupet vijuese:

Tabela 24. Fokus-grupet e kryera:

Fokus-grupi	Vendndodhja e OSHC-ve	Fusha e RAP
Fokus-grupi nr. 1	6 OSHC lokale	Ofrimi i Shërbimit
Fokus-grupi nr. 2	7 OSHC lokale dhe kombëtare (me qendër në Tiranë)	Ofrimi i Shërbimit dhe Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave
Fokus-grupi nr. 3	5 OSHC lokale dhe kombëtare (me qendër në Tiranë)	Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave

INTERVISTAT ME PALËT E INTERESUARA

Intervistat u kryen për të mbledhur përshtypjet nga palët e interesuara për disa prej fushave të monitoruara. Ngjashëm me fokus-grupet, intervistat u përdorën kryesisht për të plotësuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura me metoda të tjera. Për shkak të kufizimeve të paraqitura nga shpërthimi i pandemisë COVID-19, intervistat në disa raste kanë zëvendësuar fokus-grupet si burime të të dhënave.

Intervistat ishin gjysmë të strukturuar, të përbëra nga një grup pyetjesh të hapura, të cilat mundësuan një diskutim me të intervistuarit dhe nën-pyetje aty për aty. Përzgjedhja e të intervistuarve synoi ekspertë të rëndësishëm për një fushë të caktuar tematike.

Në përgjithësi, gjatë periudhës së monitorimit u realizuan gjithsej 9 intervista. Të intervistuarve u është dhënë një anonimitet i plotë në lidhje me çdo informacion personal, në mënyrë që të sigurohej nivel më i lartë përgjigjesh dhe të lehtësohej shkëmbimi i hapur i mendimeve.

Tabela 25. Intervistat e kryera:

I intervistuari (numri i intervistave)	Fusha e RAP
Përfaqësues të DAP (3)	Shërbimi Publik dhe Miradministrimi i Burimeve Njerëzore
Ish kandidatë për shërbimin civil (4)	Shërbimi Publik dhe Miradministrimi i Burimeve Njerëzore
Nëpunës i lartë civil (1)	Shërbimi Publik dhe Miradministrimi i Burimeve Njerëzore
Përfaqësues i KLSH (1)	Miradministrimi i Financave Publike

SONDAZHI I PERCEPTIMIT PUBLIK

Sondazhi i perceptimit të publikut bazohet në një pyetësor që synon publikun e gjerë në Shqipëri (banorë të përhershëm, mbi 18 vjeç). Sondazhi u krye nëpërmjet intervistimit telefonik të asistuar nga kompjuteri (CATI) në kombinim me intervistimin në internet të asistuar nga kompjuteri (CAWI), duke përdorur një përfaqësim të rastësishëm me tre faza kampionimi të shtresëzuar (njësia primare e kampionimit: zonat e qendrave të votimit; njësia e dytë e kampionimit: familjet; njësia e tretë e kampionimit: anëtar i familjes). Sondazhi u krye gjatë periudhës 10 maj - 30 maj 2020. Marzhi i gabimit për një kampion prej 1007 qytetarësh është $\pm 3.14\%$, në nivelin e besimit 95%. Më poshtë janë të dhënat demografike të kampionit:

Tabela 26. Të dhënat e sondazhit të perceptimit publik

Kategoria	Nënkategori	N	Përqindja
Të ardhurat e tanishme të familjes	Jetoj mirë me të ardhurat e tanishme	49	4.87
	la dal me të ardhurat e tanishme	367	36.44
	E shoh të vështirë me të ardhurat e tanishme	340	33.76
	E shoh shumë të vështirë me të ardhurat e tanishme	251	24.93
Zona	Urbane	566	56.21
	Rurale	441	43.79
Rajoni	Verior	179	17.78
	Qendror	508	50.45
	Jugor	320	31.78
Gjinia	Mashkull	500	49.65
	Femër	507	50.35
Mosha	18-29	260	25.82
	30-44	254	25.22
	45-60	303	30.09
	> 60	190	18.87
Arsimi	Fillor ose më pak	487	48.36
	Gjimnaz	363	36.05
	Kolegj ose Universitet	157	15.59
Gjendja e punësimit	Në punë të paguar	461	45.78
	I/e papunë	280	27.81
	Të tjera	266	26.42

SONDAZHI I NËPUNËSVE CIVILË

Sondazhi i nëpunësve civilë u realizua bazuar në një pyetësor të unifikuar për nëpunësit civilë që punojnë në administratën shtetërore qendrore në Shqipëri. Pyetësi përfshiu pesë pjesë kryesore: (i) rekrutimin e nëpunësve civilë, (ii) punësimin e përkohshëm në administratë, (iii) gjendjen e nëpunësve të lartë civil, (iv) pagën/shpërblimin, (v) integritetin dhe antikorrupsionin. Mbledhja e të dhënave u krye duke përdorur një pyetësor të vetadministruar në platformën SurveyMonkey.

975 nëpunës civilë morën pjesë në sondazhin i cili u krye midis 15 korrikut dhe 4 gushtit 2020.

Tabela 27. Të dhënat e kampionit të sondazhit të nëpunësve civilë

Kategoria	N	Përqindja
Pozicioni i shërbimit civil		
Drejtues i lartë i shërbimit civil	22	2.26
Nëpunës civil i nivelit të mesëm	59	6.05
Nëpunës civil i nivelit të ulët	159	16.31
Nëpunës civil i nivelit ekzekutiv	466	47.79
Të tjera	21	2.15
Nuk u përgjigj	248	25.44
Institucioni i administratës shtetërore		
Ministri	239	24.51
Institucione varësie	257	26.36
Zyra e Kryeministrit	8	0.82
Administrata e Prefektit të Qarkut	32	3.28
Të tjera	191	19.59
Nuk u përgjigj	248	25.44
Gjinia		
Mashkull	318	32.62
Femër	364	37.33
Nuk u përgjigj	293	30.05
Kohëzgjatja e punës në administratë		
Mesatarja = 15.3 vjet; Shtrirja = 0-41 vjet		
Spektori ku ka punuar para se të hynte në administratë		
Administrata lokale ose rajonale	95	9.74
Institucione jo pjesë e pushtetit ekzekutiv	19	1.95
Shërbime Publike	114	11.69

Organizata ndërkombëtare	10	1.03
Organizatë joqeveritare	19	1.95
Media	7	0,72
Sektori privat	268	27.49
Kjo ishte puna ime e parë	93	9.54
Të tjera	102	10.46
Nuk u përgjigj	248	25.44

Tabela 28. Marzhi i gabimit (MiG) për pyetje në nivelin e besimit 95%

Pyetje	MiG
Nëpunësit civilë në institucionin tim rekrutohen në bazë të kualifikimeve dhe aftësive	3.62-3.76
Në procedurën e rekrutimit për nëpunësit civilë në institucionin tim, të gjithë kandidatët trajtohen në mënyrë të barabartë (pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike ose ndonjë tipar tjetër personal që mund të jetë bazë për diskriminim të padrejtë)	3.85-3.99
Për të gjetur një punë të shërbimit civil në institucionin tim, duhet të keni lidhje	2.62-2.79
Punësimi i individëve me bazë të përkohshme (me kontratë të caktuar, shërbimi dhe kontrata të tjera të përkohshme) është një përjashtim në institucionin tim	2.99-3.14
Individët të cilët punësohen në mënyrë të përkohshme kryejnë detyra që normalisht duhet të kryhen nga nëpunësit civilë	3.19-3.41
Kontrata të tilla zgjaten për më shumë se një vit	2.18-2.34
Kur njerëzit punësohen në mënyrë të përkohshme, ata zgjidhen bazuar në kualifikimet dhe aftësitë	3.53-3.71
Individët e punësuar në mënyrë të përkohshme, pas angazhimeve të tyre të përkohshme, bëhen nëpunës civilë	2.77-2.92
Rregullat zyrtare për punësimin e njerëzve në mënyrë të përkohshme zbatohen në praktikë	3.65-3.82
Procedurat për emërimin e nëpunësve të lartë civilë sigurojnë që, në institucionin tim, vendet e punës t'i marrin kandidatët më të mirë	3.41-3.57
Në institucionin tim, nëpunësit e lartë civilë do të kryenin veprime të paligjshme nëse eprorët politikë do t'ua kërkonin ta bënin këtë	2.89-3.12
Nëpunësit e lartë civilë mund të refuzojnë një urdhër të paligjshëm nga një ministër ose një epror tjetër politik, pa rrezikuar pozicionin e tyre	3.27-3.42
Pozicionet e larta të shërbimit civil janë subjekt i marrëveshjeve politike dhe "ndarjes së tortës" midis partive politike në pushtet	2.51-2.67
Nëpunësit e lartë civilë emërohen të paktën pjesërisht falë mbështetjes politike	2.74-2.93
Në institucionin tim, nëpunësit e lartë civilë marrin pjesë në fushata elektorale të partive politike gjatë periudhës së zgjedhjeve	2.02-2.21
Në institucionin tim nëpunësit e lartë civilë pushohen nga puna për motive politike	2.20-2.38
Rregullat dhe kriteret zyrtare për shkarkimin e nëpunësve të lartë civilë zbatohen siç duhet në praktikë	3.67-3.84
Në institucionin tim, shpërblimet ose rritja në detyrë përdoren nga drejtuesit vetëm për të nxitur ose shpërblyer performancën	2.57-2.74
Në institucionin tim, lidhjet politike dhe personale i ndihmojnë punonjësit të marrin shpërblime ose rritje në detyrë	1.90-2.08
Masat e integritetit dhe anti-korrupsion që zbatohen në institucionin tim janë efektive në arritjen e qëllimit të tyre	3.68-3.80

Masat e integritetit dhe anti-korrupsion në institucionin tim janë të paanshme (do të thotë, zbatohen për të gjithë nëpunësit civilë në të njëjtën mënyrë)	3.59-3.73
Nëse do të bëhesha sinjalizues, do të ndihesha i mbrojtur	2.67-2.82
Sa e rëndësishme mendoni se është që organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të monitorojnë reformën e administratës publike	2.51-2.67
Sa e rëndësishme mendoni se është që publiku (qytetarët) ta perceptojnë administratën si të depolitizuar	1.30-1.41

SONDAZHI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Rezultatet e sondazhit të OSHC-ve bazohen në një pyetësor të standardizuar që synon përfaqësuesit e OSHC-ve që punojnë në Shqipëri. Pyetësi përfshinte nëntë pjesë që mbulojnë:

1. Përfshirjen e OSHC-ve në hartimin e politikave të bazuara në të dhëna dhe studime;
2. Pjesëmarrjen në politikëbërje dhe vendimmarrje;
3. Ushtrimin e të drejtës për marrjen e lirë të informacionit;
4. Transparencën e proceseve vendimmarrëse;
5. Disponueshmërinë publike të legjislacionit dhe materialeve shpjeguese;
6. Perceptimet e OSHC-ve për planifikimin, monitorimin dhe raportimin e qeverisë mbi punën e saj;
7. Efektshmërinë e mekanizmave për mbrojtjen e së drejtës për administrim të mirë;
8. Integritetin e administratës publike, dhe
9. Marrjen e shërbimeve administrative.

Mbledhja e të dhënave u krye duke përdorur një pyetësor të vetadministruar në platformën SurveyMonkey. 81 OSHC morën pjesë në sondazh, i cili u krye midis 24 qershorit dhe 29 korrikut 2020.

Tabela 29. Të dhënat e kampionit së studimit të OSHC-ve

Kategoria	N	Përqindja
Lloji i organizatës		
Institut kërkimor	20	24.10
Organizatë mbikëqyrëse	15	18.07
Advokim/mbrojtje	37	44.58
Ofrues shërbimi	32	38.55
Organizata komuniteti lokal (grassroots)	28	33.73
Të tjera	15	18.07
Fusha e veprimtarisë		
Qeverisja dhe demokracia	42	50.60
Sundimi i ligjit	18	21.69
Të drejtat e njeriut	41	49.40
Reforma e administratës publike	12	14.46
Integrimi evropian	22	26.51
Çështjet gjinore	25	30.12
Fëmijët dhe të rinjtë	31	37.35

Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	40	48.19
Arsimi	27	32.53
Kultura	18	21.69
Shëndeti	10	12.05
Media	12	14.46
Zhvillimi ekonomik	26	31.33
Zhvillimi i shoqërisë civile	31	37.35
Shërbimet sociale	30	36.14
Të tjera	14	16.87

Viti i regjistrimit të OSHC-ve

Mesatarja = 2005; Shtrirja = 1990-2020

Pozicioni i të anketuarit në organizatë *		
Drejtues i nivelit të lartë	53	63.86
Drejtues i nivelit të mesëm	4	4.82
Zyrtar i lartë (jo drejtues)	4	4.82
Zyrtar i mesëm (jo drejtues)	1	1.20
Të tjera	27	32.53

Vite pune në organizatë

Mesatarja = 10.5 vjet; Shtrirja = 0-28 vjet

ANALIZA E DOKUMENTACIONIT ZYRTAR, TË DHËNAVE DHE FAQEVE ZYRTARE TË INTERNETIT

Monitorimi u mbështet shumë në analizën e dokumenteve zyrtare të disponueshme publikisht në faqet e internetit të organeve të administratës. Dokumentet e analizuar përfshijnë:

- legjislacionin (ligje dhe akte nënligjore)
- dokumente të politikave (strategji, programe, plane, plane veprimi, etj.)
- raporte zyrtare (raportet e zbatimit, raportet e konsultimit publik etj.)
- dokumente analitike (vlerësime të ndikimit, materiale shpjeguese të legjislacionit, koncepteve të politikave, vlerësime të politikave etj.)
- akte individuale juridike (vendimet, konkluzione etj.)
- dokumente të tjera (agjenda, procesverbale dhe raporte të mbledhjeve, njoftime, udhëzime, direktiva, memorandume etj.).

Për më tepër, faqet zyrtare të autoriteteve publike u përdorën si burime të të dhënave dhe dokumenteve për të gjithë treguesit, përveç atyre që bazohen plotësisht në të dhënat e sondazhit. Në raste të caktuara, faqet e internetit të autoriteteve publike u shqyrtuan nga afër, pasi ato ishin burimet kryesore të informacionit dhe njësi të analizës.

KËRKESAT PËR INFORMACION

Metodologjia e monitorimit mbështetet në të dhëna të disponueshme për publikun. Studiuesit dërguan kërkesa për informacion vetëm në rastet kur përcaktohej nga metodologjia e elementeve përkatëse që shqyrtonin praktika të caktuara institucionale, që nuk mund të mbulohen lehtësisht nga të dhënat e disponueshme në internet. Prandaj, kur metodologjia përcaktonte se vlerësimi do të kryhej në bazë të informacionit të disponueshëm në internet, nuk u dërguan kërkesa për informacion.

Studiuesit përdorën gjerësisht kërkesat për informacion si mjet për mbledhjen e të dhënave në tre fushat e mëposhtme:

1. Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave (treguesit ZHKP_P6_I1, ZHKP _P10_I1)
2. Shërbimi Publik dhe Miradministrimi i Burimeve Njerëzore (SHPMBNJ_P3_I1, SHPMBNJ _P2_I1)
3. Llogaridhënia (LL_P2_I2).

Në raste të caktuara, kërkesa shtesë për informacion janë dërguar për të marrë të dhëna dhe informacione të nevojshme në fushat e tjera të reformës për të analizuar treguesit përkatës. Në total, u dërguan 19 kërkesa për informacion.

LISTA E BURIMEVE TË REFERUARA NË RAPORT

STUDIME, RAPORTE, DOKUMENTE POLITIKASH, LIGJE

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara në Shqipëri (ADISA). *Raporti i Monitorimit të Strategjisë, 2020*. <https://bit.ly/3oN1VHt>.

Blerjana Bino, Redion Qirjazi, and Alban Dafa. *Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Procesin e Vendimmarrjes në Shqipëri*. Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2020. <https://bit.ly/3hEOvgu>. (anglisht)

Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike. *Dokumenti i Politikave Afatgjata Për Ofrimin e Shërbimeve me në Qendër Qytetarin nga Administrata Shtetërore në Shqipëri*. Tiranë, Prill 2016. <https://bit.ly/2FF1lub>. (anglisht)

Këshilli i Ministrave. *Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2018-2020*. <https://bit.ly/3xKX4fy>.

Këshilli i Ministrave. *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020*. <https://bit.ly/3xGC3ST>.

Këshilli i Ministrave. *Programi i Qeverisë 2017-2021*. <https://bit.ly/3yUeyG9>.

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë. <https://bit.ly/3sq40uM>.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. <https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. *Veprimtaria e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, 01 Janar – 31 Dhjetor 2019*. Tiranë, Mars 2020. <https://bit.ly/3h2mYpB> (anglisht). Raporti në shqip: <https://bit.ly/3f5ABIV>.

Komisioni Evropian. "Raporti për Shqipërinë 2020". <https://bit.ly/3dylhnp>. Komisioni Parlamentar Ad-hoc për Reformën në Drejtësi. *Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri*. Tiranë: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2015. http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. *Raport për Pjesëmarrjen e Publikut dhe Shoqërisë Civile në Procesin Vendimmarrës të Kuvendit për Vitin 2020*. <https://bit.ly/36GPUg5>.

Ligji nr. 9000, date 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave". <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2003/01/30/9000>.

Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë". <https://bit.ly/2RvEJmb>.

Ligji nr. 9367, date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike". <https://bit.ly/3hVaSNv>.

Ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike". <https://bit.ly/3aPXJmt>.

Ligji nr. 119/2015 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile". [http://www.amshc.gov.al/web/KKSHC/Ligj_Nr.119-2015_KKSHC-\(AL\).pdf](http://www.amshc.gov.al/web/KKSHC/Ligj_Nr.119-2015_KKSHC-(AL).pdf).

Ligji nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve". <http://www.ildkpkj.al/wp-content/uploads/2019/01/ligj-nr-60-dt.-2.6.2016.pdf>.

Ministria e Drejtësisë. *Inter-sectoral Strategy against Corruption 2015-2020*. Available at: <https://bit.ly/2VKHF0F>. (anglisht)

OECD/SIGMA. *Kuadri Metodologjik për Parimet e Administratës Publike*. Paris: OECD Publishing, 2019. <https://bit.ly/3dZa2P5>. (anglisht)

OECD/SIGMA. *Kuadri Metodologjik për Parimet e Administratës Publike 2017*. Paris: OECD Publishing, 2017. <https://bit.ly/2BxiBxv>. (anglisht)

OECD/SIGMA. *Raport Monitorimi: Parimet e Administratës Publike: Shqipëri*. Paris: OECD Publishing, 2019. <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2019-Albania.pdf>. (anglisht) OECD/SIGMA. *Parimet e Administratës Publike 2017*. Paris: OECD Publishing, 2017. <https://bit.ly/2Kvm4iO> (anglisht). Botimi në shqip: <https://bit.ly/3725vY2>.

Urdhër i Kryeministrit nr. 157, datë 20.10.2018 "Për masat e marra për të zbatuar qasjen e gjerë sektoriale/ ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar".

Vendim i Këshillit të Ministrave nr..290, date 11.4.2020 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)". <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/04/11/290>.

PORTALE INSTITUCIONESH WEBSITES

Agjencia e Prokurimit Publik - <http://www.app.gov.al/>.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës - <https://www.ashk.gov.al/>

Agjencia e Trajtimit të Pronave - <http://atp.gov.al/>

Departamenti i Administratës Publike - <http://dap.gov.al/>.

E-Albania - <https://e-albania.al/>.

KDIMDP - <https://www.idp.al/annual-reports/?lang=en>.

Kontrolli i Lartë i Shtetit - <https://bit.ly/3ilF5PS>

Ministria e Drejtësisë - <https://www.drejtesia.gov.al/>

Ministria e Financave dhe Ekonomisë - <https://bit.ly/3sFr35e>

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - <https://www.infrastruktura.gov.al/en/>

Ministria e Mbrojtjes - <https://www.mod.gov.al/>

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - <https://shendetesia.gov.al/>

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - <https://turizmi.gov.al/>

OSBE/ODIHR - <https://www.osce.org/odihr/elections/albania>.

Portali i konsultimeve publike - <http://www.konsultimipublik.gov.al/>.

Zyra e Kryeministrit - <https://kryeministria.al/>

